

Shpëtim Selmani lindi në Prishtinë më 1986. Është autor i disa librave mes të cilëve edhe "Libërthi i dashurisë", fitues i Çmimit Evropian të Letërsisë për 2020. Në këtë bisedë, trajton çështje që lidhen me letërsinë dhe artin në përgjithësi, të vështruara nga pikëpamja e një artisti të angazhuar "full - time", pasi ai nuk është vetëm shkrimtar por edhe aktor. Selmani ka botuar së fundmi "Balada e Buburrecit" dhe ka nënshkruar kontratat për botimin e letërsisë së tij në disa gjuhë, mes të cilave gjermanisht, frëngjisht dhe italisht.

SHPËTIM SELMANI: LIBRAT TEPËR SERIOZË MË KRIJOJNË NJË GJENDJE TË PADURUESHME

Bisedoi *Andreas Dushi*

SHËNIME MBI LIBRAT

Vëllimi poetik *Spiralja e frikës*, e Biser Mehmetit

POETIKA E MËDYSHJES EKZISTENCIALE

nga *Behar Gjoka*

(fq. 6)

Romani "Jeta e shkurtër e Lukas
Santanës" e Elvira Dones

ATIJ QË RRON E ATIJ QË VDES

nga *Durim Taçi*

(fq. 7)

Romani "Një javë në Manastir, nëntor 2008" i
Mustafa Nanos

SPROVA E RADHËS PËR TË ÇMONTUAR SHTRATIN E PROKRUSTIT

nga *Kosta Nake*

(fq. 8)

ILIRIAN ZHUPA, KY

MAGELAN I SHPIRTIT

NJERËZOR

Nga *Luan Rama*

(fq. 23)

Romani "Hoteli i bardhë" i D. M. Thomas

EKZAMINIMI PSIKANALITIK I INDIVIDIT

nga *Fatlum Mehulli*

(fq. 22)

Mbi romanin *Fluturoi shpejt si harabel*

EMILIOS SOLOMU, SHKRIMTAR I STANDARDEVE EVROPIANE

nga *Petro Çerkezi*

(fq. 8)

Rreth librit "Ku shkon pa dashuri" të Sefedin Çelës

"VUMË NGA NJË TULLË E NUK HOQËM TULLA.."

nga *Josif Papagjoni*

(fq. 14)



TË JESH FANOLIST SOT

Prof. dr. Begzad Balii

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Të jesh fanolist sot do të thotë të jesh krijues, që më parë se sa t'i artikulosh idetë, temat, mendimet a konceptet në veprën fetare, letrare, politike, kulturore a shkencore, duhet të krijosh neologjizmat, fjalët vetjake, termat shkencorë, mbi strukturën fjalëformuese e kuptimore të gjuhës shqipe, aq të munguara në komunikimin shkencor, politik e kulturor sot; të jesh nolian sot do të thotë të jesh i pakompromis në identifikimin e saktë të shqetësimeve ditore dhe t'ia çjerrësh maskën politikanit, deputetit, qeveritarit dhe uzurpatorëve të institucioneve shtetërore...

(fq. 5)

SHTATË MUZIKANTË NË NJË FOTO TË MARGARET HASLUCK

Nga *Qerim Vrioni*

(fq. 4)

Duke vërejtur fushat e shumta të përditshmërisë shqiptare të përngjirë në letër fotografike nga Hasluck, mendojmë se ajo, ka përjetësuar mirë një pjesë të historisë së tyre.

dy tregime të reja nga

MEHMET KRAJA



(fq. 16)

BIBLIOTEKË

Meri Dishnica

(fq. 12)

Shënime minimale

Ylli Pango

(fq. 15)

Lumturia

Odise Kote

(fq. 18)

Hija e fshehur e burrit

Jonas Hassen Khemiri

(fq. 20)

Pafundësisht e pandryshueshme

Robert Bly

(fq. 21)

Duke ecur mbrapsht

VARIANTE NË KËRKIM TË INVARIANTIT: "BEU" TË NOLI, KUTELI DHE XOXA

nga *Eldon Gjika*

(fq. 9)

DHIMITËR S. SHUTERIOI: PORTRETE NË VITE

Nga *Feride Papeleka*

(fq. 13)

IBRAHIM KODRA, PIKTORI QË EDHE FIRMA I MBETET VEPËR ARTI

Nga *Jurgis Çyrbja*

(fq. 19)

SHPËTIM SELMANI: LIBRAT TEPËR SERIOZË MË KRIJOJNË NJË GJENDJE TË PADURUESHME

Bisedoi Andreas Dushi

A.D.: Thuhet se letërsia është mjete i përdorur për të krijuar një realitet paralel, për aq kohë sa realiteti konkret nuk e përmbush autorin, krijuesin. Ka teori që këtë qëllim ia mvëshin gjithë artit në përgjithësi. Librat tuaj të fundit, të tre, kanë tiparet e një letërsie *non-fiction*, pak a shumë si kronika të një jete tejet të zakonshme, ndonëse patjetër jam i prirur të besoj praninë e elementëve të trilluar në të. Po qe se dakordësohemi në moskrijimin e një realiteti tjetër nëpërmjet letërsisë, çfarë synoni të krijoni kur shkruani?

Sh.S.: Do të ishte jo fort e këndshme ta kanalizojmë letërsinë në variacione teorike. Njerëzit e sidomos kritikët me çdo kusht mundohen të përkuftizojnë gjërat. Nuk them se kjo që thoni ju është e pavërtetë përderisa realiteti kudo del të jetë diçka që ka të bëjë me barbarinë por do të ishte fatale për letërsinë ta kishte vetëm një barrë mbi supe. Rruga e secilit që merret me këtë gjë kaq fëmijërore dhe shpesh kaq rraskapitëse e të çuditshme është unike. Dhe prirem të besoj se secili duhet të gjej rrugën e vetë. Duhet të jetë kokëfortë dhe i egër. Kronikat ashtu siç i referoheni ju mund të mos kenë fare trillim por kjo nuk do të thotë që nuk kërkon dhe atë me ngulm një rend të ri njerëzor. Kjo është një mënyrë e imja. Para së gjithash synoj të pastrohem nga mijëra budallallëqe të trashëguara, synoj të pastrohem nga ligësitë e sistemeve të jetesës e të të menduarit që më kanë rënë në supe. Me një fjalë mundohem ta riparoj para së gjithash veten dhe t'ia dal me të. Dhe nëse arrij tek të tjerët synoj të jem i pranueshëm dhe i vërtetë.

A.D.: A është e *lëngshme*, sikurse propozon Bauman, shoqëria e treguar në letërsinë tuaj?

Sh.S.: Më vjen keq dhe shpresoj që të mos jetë dëshpëruese për ju por nuk e di për çfarë teorie po flisni. Nuk mund të jap përgjigje ngase nuk jam duke e kuptuar pyetjen dhe as nuk do të doja të hulumtoja përkitazi me këtë teori në mënyrë që të jepja një përgjigje të kënaqshme dhe të shitesha si një autoritet dijeje lidhur me këtë çështje.

A.D.: Si mendoni, nga cili front, nga cili tipar duhet treguar sot lufta e Kosovës, nga ana heroike e çlirimit të vendit apo nga ajo emocionale e ndrydhjes së brishtësisë, fragilitetit njerëzor gjatë luftës?

Sh.S.: Natyrisht nga perceptimi i brishtësisë njerëzore. Kurrë nuk kam menduar se do të flisja për luftën dhe e kam larguar gjithmonë larg temave të mia ngase

kam besuar se po flitej e shkruhej shumë lidhur me të. Mirëpo sa më shumë ndihesh përgjegjës për brezat që vijnë dhe sa më shumë që merr pjesë në proceset shoqërore, aq më shumë do të ndihesh përgjegjës për të qenë zë i drejtë i kujtesës. Lufta tek ne ka lënë gjurmë shumë të pashlyeshme por në të njëjtën kohë ka forcuar nevojën tonë të përbrendësuar për paqe. Habitem se si ende sot mund të përmendet lufta si një mundësi e re gjë që e vërejmë tek retorika e politikave ballkanike. Ne nuk mësojmë fare nga mësimet e ashpra historike. Epshi i sëmurë për dominancë dhe nevoja për heronj është diçka për të cilën duhet të ndryshojmë qasje.

A.D.: Më duket se Kadare thotë diku që i është borxhli Servantesit për ndonjë buzëqeshje tek lexuesit e veprës së tij. Po ju, kujt ia keni borxh praninë e fortë të komikes në letërsinë tuaj, sidomos te libri i fundit “Balada e Buburrecit”?

Sh.S.: Kam lexuar shumë libra. Dhe gjithmonë librat që më janë dukur tepër seriozë më kanë dhënë një gjendje të padurueshme. Mendoj se librat duhet ta kenë një dozë të madhe të komikes dhe ajo duhet të jetë nëse mundemi poashtu dozë e mençurisë. Ngase komikja përveç tjerash kërkon mençurinë. Jo ndonjë buzëqeshje por shumë buzëqeshje e të qeshura gjithnjë në sfondin e së cilës na kërcënon terrori i

jetës dhe një Marcel Proust tejet serioz.

A.D.: Për letërsi të shkruara në gjuhë si kjo e jona, e folur dhe e lexueshme prej pakujt, sa të rëndësishme janë përkthimet?


Sh.S.: Natyrisht që përkthimet janë të rëndësishme. Tregu ynë përveç se është i vogël është i mbushur edhe me inatçinj. Me përbuzës dhe me luftëtarë dinakë. Gjë që e vështirësojnë jetën dhe frymëmarrjen e librave tanë që i shkruajmë shtyrë nga impulse të çuditshme që as vetë nuk arrijmë t'i shpjegojmë. Prandaj kur një libër i yni përkthehet dhe gjen lexues tjerë libri rritet dhe masa e argëtimit të tij shtrihet në një fushë të re e të panjohur sepse nuk ka asgjë më eksituese e më joshëse se e panjohura. Në këtë mënyrë autorët gjejnë forca të reja për të vazhduar dhe kënaqen për ca ditë që ka kaluar kufijtë e gjuhës së vetë.

Ata që janë të mirë dhe që nuk janë mashtrues, do të arrijnë tek të gjithë lexuesit kudo në botë. Dhe në këtë mënyrë ai do të jetë i të gjithëve dhe jo vetëm i një kombi apo i një gjuhe për të cilin kanë vendosur fatet. Me brutalitetin si normë.

A.D.: Është e vështirë të jetosh si artist në Kosovë, Shpëtim? Si shkrimtar dhe si aktor, si njeri i angazhuar me çështje të artit dhe kaq? Mendoni se arti, përveçse pasion mund të funksionojë edhe si profesion?

Sh.S.: Natyrisht se është shumë e vështirë. Duhesh të bësh kompromise të paimagjinueshme. Jeta në shoqëritë shqiptare kërkon që të jesh idiot në këmbim të mirëqenies sociale. Do të jesh i përlyer në të gjitha rastet. Qoftë si një idealist i pashoq. Një murg i vetmuar mes absurditeteve. Qoftë si një konformist kryelartë që arsyeton veprimet e tua duke u thirrur në emër të ndryshimeve të mëdha. Për ata që kanë të zhvilluar sensin e ndjeshmërisë është jashtëzakonisht e vështirë. Por mbijetesa shpesh kërkon ato që i ke më të vlefshme. Dhe nuk ka asgjë më kërcënuese se ajo. Përndryshe arti para së gjithash duhet të jetë pasion. Ai i vërteti. Natyrisht një pasion që paguhet mbase edhe mund të dëmtohet. Ngase pasioni përjashton çdo shpërblim material. Por sot ne jetojmë në një shumësi kompleksesh dhe gjithë çfarë na mbetet është që ta zbusim masën e vetë lëndimit dhe ta ruajmë në mënyrë fanatike atë që është njerëzore brenda nesh. Por edhe ta çmojmë njerëzoren që është brenda të tjerëve.

A.D.: Murakami ia huzaon *Beatles* titullin e romanit të tij, “Norwegian Wood”. Edhe Ishiguro po ashtu, një tregim e titullon



“Come rain or come Shine”, titull i një kënge të Ray Charles. Referenca muzikore gjenden shpesh edhe në krijimtarinë tuaj. A ekziston një marrëdhënie mes formave të ndryshme të artit, si parim them, apo është zgjedhje individuale, ngjizur nga rrethana të veçanta të vetë autorit?

Sh.S.: Unë dëgjoj muzikë shumë dhe muzika është shumë e rëndësishme për mua. Kohëve të fundit kam pasur disa performanca me Alban Nimanin e Asgjë Sikur Diellit ku kemi gërshtëuar poezinë dhe muzikën. Format e ndryshme të artit mund të gërshetohen dhe kjo e bën më të pasur dhe më të durueshme. Por për ta bërë këtë duhet të ekzistojë një kimi. Një dëshirë. Një qëllim. Dhe një dije për atë që bën. Mjafton ta dimë. Të tjerat do të jenë aty. Isha në kërkim të një titulli për librin derisa dëgjova Lindjën, një bend i viteve tetëdhjetë. Kënga quhej “Balada e Buburrecit”. Kishte vargje të forta.

Thoshte në zemrën time kam një shpatë, të gjithë e dinë se sa jam i pafat. Jam buburrec por jam krenar. Jam i vogël por jam krenar. Sigurisht interpretimi im kalonte atë personal dhe më lidhej me fatin e vendit tim në kuadër të një shumësie fatesh, kombesh e konfliktesh. Prandaj thashë libri le të titullohet kështu. Në fund të fundit ne jemi robër të riprodhimeve dhe akomodimeve të ndryshme përgjatë shekujve. Qofshin ato edhe artistike.

A.D.: Kujtoj një poezi tuajën (që për hir të së vërtetës e kërkova prapë dhe e gjeta për të marrë vargjet në vijim), fryma e së cilës më mbeti gjatë në mendje.

Po haja/ Akullore dhe shihja/ Libra të vjetër në një rrëzë/ Nga rrugët e Tiranës[...] Marr Majakovskin në duar/ Dhe e pyes shitësin/ Sa kushton/ Thotë pesëqind lekë/ Dhe duke e ditur se/ Ma ngulin i them shtrenjtë/ Po pra se ti e ke mendjen/ Te Stoma/ A e di çfarë do të thotë/ Stoma nga greqishtja/ Do të thotë gojë/ Aty e ke mendjen/ E ndërrojnë Majakovskin/ Për një akullore/ Mos më fajso mua/ Fajso kapitalizmin [...]

Më pëlqen shumë rimarrja e flladit të rëndë urban te kjo poezi, konkretja, rrëfimi pa epizëm të dalë boje dhe pa lirizëm të shtirur. Pak a shumë të tilla janë dhe prozat e shkurtra që keni botuar. Në rastin tuaj, kemi të bëjmë me një *letërsi të qytetit*, apo më tepër me një *qytet që sjell, kërkon* ndoshta edhe *imponon këtë letërsi*? Çfarë ju shkruani është nxitje nga brenda-jashtë apo e anasjelltja, ajo çka është jashtë vjen brenda jush për t’u kthyer prap si letërsi? Pak a shumë si ai procesi i bimëve që marrin dioksidin e karbonit dhe e kthejnë në oksigjen... Shumë patetike, t’i mvëshesh të tillë mision shkrimtarit ë...?

Sh.S.: Atë e kam shkruar gjatë kohës sa shkruaja një shfaqje që kishte premierën te Shtëpia e Gjethëve në Tiranë. Nën regjinë e Zana Hoxhës. Ishte një temë që ne të dy e kishim diskutuar më herët, një ide shumë interesante e Zanës që kishte të bënte me kohën e një Shqipërie komuniste dhe idealizimin që shqiptarët e Kosovës e kishin për të. Këtu më lejo ta përmend dashurinë e babait tim për Radio Tiranën e atëherëshme kur të gjithë vuanin nga magjia e Beatles. Kur nuk arrija të bëja as gëk e as mëk për ndërtimin e tekstit të shfaqjes, dilja nëpër Tiranë dhe shkruaja vjersha. Bëra një cikël lidhur me Tiranën. Vjersha që në qendër kishin atë që shihja dhe atë që krijohej pas asaj që shihja. Ishin poashtu të rrezikshme. Disa lexues të panjohur diku kishin bërë shaka. Kishin shkruar një vjershë dhe kishin vënë autorësinë time. Përshkrimi i detajuar dhe kaq direkt që po bëja kishte rrezik të rrëshqiste në diçka që duhej qeshur e tallur. Por sidoqoftë cikli prej disa vjershash ekziston dhe disa prej tyre do të



botohen në librin e radhës me vjersha. Më vjen mirë që e keni pëlqyer.

A.D.: Mendoni se bimët kanë jetë, janë gjallesa e për sa kohë janë të tilla, ne njerëzit duhet t’u japim të drejta, për shembull mos t’i këpusim, mos t’i hamë, madje as mos t’i ofendojmë duke bërë shaka me to? Thua të arrijnë gjer’ këtu agjendat e sotme *progjithçkasë*?

Sh.S.: Para disa vitesh isha në një kështjellë si shkrimtar resident në një fshat paraqsor të Zvicrës. Dhe një shkrimtar më të cilin qëndronim aty shante një kositës të barit. Që mbase ishte detyra dhe për këtë gjë paguhej. Ai shante e shfrynte në drejtim të tij për shkak se vriste insektet dhe prishte rendin e tyre të jetesës por pakëz më vonë mund ta shihje teksa i lumtur hante mishin. Njeriu është një betejë e kontradiktave.

A.D.: Ju frikëson rritja e inteligjencës artificiale? Po konkurrenca që mund të krijojë?

Sh.S.: Ende nuk arrij mirë ta kuptoj se si po funksionon inteligjenca artificiale por çdo gjë që është artificiale ka diçka të pabesueshme brenda saj. Nuk e kam idenë se çfarë konkurrence mund të kemi me diçka të tillë. Por gjithsesi nuk jam fare i informuar me apetitetet e miliarderëve të sëmurë nga ambiciet që për çdo ditë të lume zhyten në projektet e

tyre të çuditshme dhe bizarre. Dhe as që më interesojnë por ka momente kur dëgjoj ndonjë gjë të re nga dhe më kap një panik i pashpjegueshëm. Më duket sikur filmat fantastiko-shkencor kanë parathënë çdo gjë. Dhe natyrisht nuk ka asgjë idilike brenda kësaj. Frika është prezente dhe e ardhmja diçka që ka të bëjë me robotët. Prandaj as që e çoj mendjen aty fare, dua të mendoj për atë që më bën të ndihem mirë.

A.D.: Shpëtim, sipas jush, si mendon një njeri që nuk ka lexuar kurrë, asnjëherë në jetë një libër? Le të themi një analfabet?

Sh.S.: Është shumë e vështirë të përgjigjem këtu. E mbaj mend stërgjyshin. Mbase nuk kishte lexuar asnjë libër por jeta e kishte mësuar shumë. Kishte një prani të madhe kudo që shkonte. Një plak i mençur me peshën e fjalës. Në anën tjetër njoh të tjerë që nuk kanë lexuar libër mbushur me paragjykime, dogmatik, zemërngushtë dhe pa asnjë dije mbi lirinë e tjetrit. Mos të harrojmë ka edhe tjerë që lexojnë dhe si njerëz janë budallenj, snob dhe të papërtypshëm. Nuk ka diçka definitive që mund ta përkufizojë pyetjen tuaj.

A.D.: A ju bezdis heshtja e zakonshme që shoqëron letërsinë? Keni, apo a keni pasur ndonjëherë entuziazëm para se ta botonit një libër, keni menduar promovime madhështore, radhë të stërgjata për autografe, por kur kjo nuk ka ndodhur, keni ndjerë zhgënjim? Apo përherë keni qenë i vetëdijshëm për situatën kur dhe ku shkruani e botoni?

Sh.S.: Mbase kjo është intervista më e gjatë që kam dhënë. Dhe shpresoj të mos jem bezdisës për lexuesit e saj. Kurrë nuk kam shkruar për famën, për promovime. Libri im i fundit në Kosovë nuk është promovuar fare. Kishte vetëm një promovim me rastin e përkthimit në italisht. Shoh shumë shkrimtarë që krenohen dhe promovojnë librat e tyre me një siguri kaq të madhe saqë më vjen turp. Natyrisht të mos bëhem krejt i pafytyrë entuziazmohem edhe unë por entuziazmi im kalon shpejt dhe fashitet krejt lehtësisht. Në panairin e librit në Tiranë qëndrova dy orë dhe dhashë tre pesë gjashtë autografe dhe disa prej tyre të njohur ndërkohë biznesmenë, këngëtarë, politikanë të gjithë që aspirojnë botën e shëmtuar rozë në Shqipëri rrethoheshin nga dhjetëra adhurues. Jepnin autografe dhe fotografoheshin. Që të jem i sinqertë gjithnjë e ëndërroj një shtëpi dikund në një mal ku mund të kaloj kohë aty tërësisht i patrazuar nga të tjerët. Por se sa do të ndodhë nuk e di.

A.D.: Mendoni se gjithçka çfarë keni për të thënë, e thoni me letërsinë tuaj? (Nëse po, pse jepni intervista apo bëni promovime? Nëse jo, injoroheni këtë shtesën brenda kllapave)

Sh.S.: Edhe intervistat shpesh ngjajnë në libra. Kam lexuar intervista të mahnitshme nga shkrimtarë e këngëtarë që ishin më të fuqishme se disa libra. Gjithçka që kam për të thënë e them kurdo dhe kudo që më jepet rasti. Letërsia është një mundësi. Ka shumë që mund të më kundërshtojnë dhe ka shumë që mund të më japin të drejtë. Sa i përket promovimeve nuk jam i tharë por ndonjëherë ndihem sikur nuk po e vlerësoj punën time në mes një vetëbesimi kaq të madh që sundon kudo në rrethet letrare shqiptare e mbase edhe më gjerë. Nuk dua të jem tërësisht i padëgjuar. Dhe ende nuk e kam guximin e shokut tim Arben Idrizit i cili nuk i jep pesë pare për gjëra të tilla.



Midis të huajve, të cilët gjatë qëndrimit në Shqipëri kanë lënë gjurmë me vlera, është edhe studiuesja skoceze, Margaret Hasluck. Ajo është lindur në Skoci (Aberdeen, 1886) dhe ndarë nga jeta në Irlandë (Dublin, 1948). Pas mbarimit të studimeve e larta në vendlindje, Hasluck udhëtoi në disa vende të Gadishullit të Ballkanit, dhe aty nga vitet 1925-'26 erdhi në Shqipëri. Këtu, gjatë viteve '20-'30, ajo ka jetuar, kryesisht në Elbasan, vijimisht për rreth 13 vite. Madje, edhe në sajë të miqësisë dhe bashkëpunimit me eruditin e atdhetarin e njohur elbasanas Lef Nosi, ajo mësoi të fliste dhe të lexonte mirë në gjuhën shqipe. Hasluck ka lëvizur mjaft edhe në disa krahina të tjera të vendit duke grumbulluar materiale të rëndësishme studimore etnografike dhe gjuhësore. Nga shtegtimet dhe studimet e saj Hasluck, si mike e dashur e shqiptarëve, ka botuar edhe disa libra të vlefshëm (anglisht dhe shqip) me karakter etnografik, historik dhe gjuhësor. Këtu ia vlen të shënohet edhe se, në vizitat nëpër krahina dhe qytete shqiptare, ajo ka realizuar mbi 400 foto të cilat ndodhen në "Institutin Antropologjik Mbretëror të Britanisë së Madhe dhe Irlandës" ("Royal Anthropological Institute of Great Britain and Ireland") në Londër. Pra, kështu ajo ka kryer kësisoj edhe punën e fotografit profesionist dhe pasionant.

Në opusin e madh fotografik të Margaret Hasluck, përfshihen imazhe me qytetarë në përditshmërinë e tyre, baresha me bagëti, nxënës shkollash, burra dhe gra fshatare në punët e ditës, pamje qytetesh dhe katundesh, kulte dhe rite fetare dhe shoqërore, mjedise mjeksore, personalitete të kohës, shqiptarë duke votuar, po ashtu edhe...muzikantë. Krijimtaria e saj përfshinë disa gjini të fotografisë si p.sh. atë antropologjike, dokumentare, historike, urbane, madje edhe atë të artit.

Fotoja që po shqyrtojmë paraqet një grup muzikantësh të një orkestrine popullore duke ekzekutuar me instrumentat e tyre para disa njerëzve, të rritur e të rinjë, të cilët i dëgjojnë me vëmendje. Në gjuhën e përditëshme të atyre kohëve (madje edhe më vonë), këto grupe muzikore quheshin, *saze ose saze popullore* çka përfshihej edhe në programacionin e hershëm të Radio Tiranës. Kështu, këto mernin shpesh edhe emrin e qytetit, p.sh. *sazet e Përmetit, sazet e Kolonjës* etj. Pjesëtarët e sazeve rëndomë

SHTATË MUZIKANTË NË NJË FOTO TË MARGARET HASLUCK

Nga Qerim Vrioni

edhe këndonin njëkohësisht duke luajtur në instrumentat e tyre.

Nga ndriçimi i mjedisit nga veshjet e personazheve si dhe hijet, kuptohet se shkrepja është realizuar afër mesditës. Nuk ka ndonjë kumt pamor të shpërfaqur nga fotoja apo të dhënë shtesë deri tani që të tregojë se për çfarë rasti *po bëjnë* muzikë instrumentistët tanë. Natyrisht repertori i tyre përmbanë melodi popullore të zonës por edhe të krahinave fqinje. Ata janë ulur mbi rrogos dhe kanë një fiasko (shishe) raki në mes dhe gotat e saj përpara. Në foto dallohen mirë vetëm tri të tilla, dy të zakonshme dhe të tretën të gjatë, ndërsa pas shishes duket cepi i një pjate, me shumë gjasë me pak meze, ndoshta djath, qepë e ndonjë turshi. Madje, nga këto imagjinohet edhe rrëkëllisja e gotës së rakisë pas mbarimit të ndonjë pjese, ose *avazi*, siç quhej atëherë një melodi e ekzekutuar nga një grup muzikor, shoqëruar me fjalë urimi të rastit. Fotos tonë i njihet viti i saktë i realizimit, 1930, pra më se 90 vjet përpara, veçse jo vendi dhe rasti. Spektatorët janë banorë të fshatit, që mendojmë se nuk do të ketë qënë i vogël, ose ndonjë qytet. Nga lloji i qelesheve të bardha të tre fëmijëve dhe të dy-tre muzikantëve, mendohet se bëhet fjalë për Shqipërinë e Mesme ose për zona kufitare me të.

Shtatë muzikantët luajnë në instrumentat e tyre dhe që janë, duke filluar

nga e djathta e shikuesit: llaudë, violinë, llaudë, gërnëtë, darabuk, llaudë dhe fyell (sipas z.Behar Arllati). Nga veshjet e tyre ka të ngjarë që të jenë edhe prej ndonjë krahine me popullsi të përzierë me etni të tjera. Veçse nga ngjyra disi e zeshkët e fytyrave të shumicës së tyre, mund të mendohet se bëhet fjalë për një grup të komunitetit rom, aq të përmendur për grupet (sazet) e tyre që luanin muzikë nëpër dasma dhe gëzime të tjera familjare të shqiptarëve. Kështu, pesë nga muzikantët mbajnë mbi kokë feste të zeza, ndërsa dy, qeleshe të bardha. Atë kohë në vend ende nuk kishte dalë ligji i Mbretërisë Shqiptare që ndalonte shtetasit e saj të mbanin në kokë feste turke, por vetëm qeleshe shqiptare.

Sidoqoftë ata janë të përqëndruar në ekzekutimin e tyre, kështu dora e përngjirë turbull në foto e muzikanit të parë djathtas shikuesit (me llaudë), tregon se në çastin e fotografimit ajo po lëvizte (koha e zgjatur e mbajtjes hapur të obturatorit). Më ndryshe janë dy duartë e gërnëtaxhiut (klarinetisit) që gjatë shkrepjes së aparatit nuk kanë lëvizur fare dhe paraqiten në imazh shumë pastër. Ndoshta përqëndrimi i këtij të fundit tregon se ai është kryesori ndërmjet atyre që po luajnë (përveçse ndodhet edhe në qëndrën optike të fotos). Pra fotografia jonë ndoshta ka kaluar aty pari dhe do të jetë tërhequr nga melodia popullore që



dëgjohej. E ajo, pa ndërhyrë fare, qetësisht është afruar dhe ka shkrepur aparatit për të realizuar një foto-çasti.

Duke vërejtur fytyrat e muzikantëve dallohet se ata nuk po shpërfaqin gëzim, hare jo e jo, madje duket edhe sikur melodia është nga ato që luheshin me nota të ulta, ose *higeshin zvarrë*, të cilat quheshin *kaba*. Këto pjesë vokalo-instrumentale, lëvroheshin kryesisht në Shqipërinë e Jugut. Në më të shumtën e rasteve *kabatë* shpërfaqnin gjendje të pikëlluara, çka vërehet disi edhe te fytyrat e sazexhinjëve të fotos tonë, ku nuk dallohet asgjë gazmore. Njiheh, ndër të tjera *kaba me violinë* dhe *kaba me klarinetë*.

Ka të ngjarë që mjedisi i fotos të jetë edhe ndonjë obor shkolle, për këtë nisemi edhe nga një djalë, i cili duket në foto me një libër a fletore para duarve. Mund të jetë edhe ndryshe, djali është duke u kthyer nga shkolla dhe rrugës ka hasur sazet popullore e me kureshtje është ndaluar për të dëgjuar pak muzikë.

Sidoqoftë, duket se klarinetisti në ball të imazhit, e ndjen më shumë nga të gjithë interpretimin, të paktën sa kumtohet nga fotoja. Natyrisht edhe grupi i këtyre instrumentistëve të Hasluck-ut, ndonëse pa arsimim profesional, ka lëvruar muzikën burimore popullore shqiptare e bashkë me shumë të tjerë dhe me vegla të ndryshme tradicionale në të gjithë Shqipërinë. Kështu, të gjithë ata, kush më shumë e kush më pak, krijuan bazën, ose si quhet ndryshe *tabanin popullor*, mbi të cilin vite më pas, u mbështetën muzikantë të shkolluar që krijuan me sukses muzikën e kultivuar vokale dhe instrumentale të vendit, në të gjitha gjinitë e saj, që nga kënga e lehtë e deri tek opera shqiptare.

Imazhe me muzikë dhe muzikantë janë nëpërkalluar në objektivat e aparateve të fotografëve shqiptarë qysh herët. Shënojmë kështu p.sh. foton e njohur të Pjetër Marubit, të quajtur "*Osoja i falltores*", që botohet thuhet në të gjitha albumet e Marubëve dhe daton nga fundi i shekullit XIX. Ajo është shkrepur brenda në studion "Marubi". Pak ndryshe qëndron puna me këtë foto të Hasluck, ku grupi i muzikantëve ndodhet në një mjedis të hapur dhe është i përqëndruar në ekzekutim, pavarësisht se 3-4 prej tyre kanë drejtuar shikimin e tyre kah aparati.

Duke vërejtur fushat e shumta të përditshmërisë shqiptare të përngjirë në letrën fotografike nga Hasluck, mendojmë se ajo, ka përjetësuar mirë një pjesë të historisë së tyre. Kësisoj, ndoshta është koha për botimin në Shqipëri të një albumi përmbledhës të krijimtarisë së saj fotografike. Madje, pse jo edhe ngritjen a themelimin e një "Galeria Fotografike Hasluck" ose "Muzeu Hasluck i Fotografisë" në Elbasan, qyteti ku ajo, për rreth 13 vjet e ndjeu veten si vendase dhe ku në vitin 2010, është vlerësuar (pas vdekjes) me titullin e lartë "Qytetare Nderi".



Fan Noli është shkrimtari, intelektual, krijuesi, përkthyesi, politikani e politologu, rreth të cilit shqiptarët janë bashkuar shumë herë, shumë kohë dhe shumë breza, sepse prej veprës së tij kemi pasur çka të vjelim e të bisedojmë për të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen e popullit shqiptarë.

A është e rastit që Fan Noli i ka pasur jo vetëm bashkëkohësit e tij, po edhe fanolisët e brezave të mëvonshëm. E pra, historianët e popullit shqiptar, na kanë folur shumë për fanolistët e viteve '20 e '30, madje jo vetëm shkrimtarë, të cilët janë përpjekur ta emitojnë me krijimtarinë letrare dhe përkthimet e tyre, jo vetëm me pikëpamjet politike e ideologjike po edhe me heroizmat e me vdekjen për atdhe; historianët e popullit shqiptarë na kanë folur edhe për fanolistët e antifanolistët e gjysmës së dytë të shekullit XX, e kjo do të thotë për fanolistët e përkushtuar ndaj veprës së tij dhe prirjet artistike e politike të studimit të saj; për prirjen shkencore të studimit të gjuhës dhe vlerave estetike të saj, si dhe për prirjet politike të ngjyrosjes ideologjike të saj; historianët, kulturologët dhe sociologët sigurisht një ditë do të flasin edhe për fanolistët e kohës sonë.

Në historinë e popullit shqiptar e të kulturës së tij, janë disa personalitet, biografia jetësore, biografia intelektuale dhe vepra e të cilëve e ka pasuruar përmbajtjen shpirtërore të popullit shqiptar në paqe, e ka ndihmuar popullin shqiptar në kohë luftërash dhe ka ndihmuar madje në kapërcyell të kalimit nga një periudhë në tjetrën. Në këtë rrjedhë, i kemi bërë luftërat për liri me këngët për Skënderbeun dhe skëndebejanët e të gjitha kohëve, kemi shtegtuar në periudhat e mëdha të Përlindjes Kombëtare me veprat e apostullit të saj Naim Frashërit e të bashkëkohësve të tij; kemi kapërcyer shtegun më të vështirë të historisë së këtij mijëvjeçari në fillim të shekullit XX, me bëmat e babait të shtetit kombëtar Ismail Qemali dhe ridimensionimin kulturor, intelektual e politik të diskursit të komunikimit tonë me Europën dhe Amerikën, të cilën e kanë bërë Fan Noli, Faik Konica e bashkëkohësit e tyre; jemi përballur me shtypjen e re sllave në ish-Jugosllavi duke u mbajtur, duke nderuar, duke u identifikuar e duke pasur në mendje sakrificën personale të Adem Demaçit etj.

Për mësuesit tanë në Kosovë e ish-Jugosllavi, për edukatorët tanë, atëistë të periudhës së komunizmit, të cilët ligjëronin Fan Nolin në shkollë a në Universitet, nuk ishte e mjaftueshme të ishte besimtar që i faleshe zotit. T'i besojë Perëndisë, ligjëronin ata, do të thotë, të punojë për gjuhën dhe atdheun, që Zoti pastaj ta shpërblente si vlerë të nderimit dhe besimit për të; për mësuesit tanë, të besojë Perëndinë do të thoshte t'i shërbeje kombit dhe institucionit fetar autoqefal të themeluar prej tij, prej Fan Nolit.

A është e rastit që edukatorët, mësuesit tanë atëistë të periudhës komuniste, të cilët nuk e shquanin shumë institucionit fetar të formimit të Konstantin Kristoforidhit; të cilët kalonin nën zë emrin e institucionit fetar të formimit fillestar të Naim Frashërit; të cilët e heshtnin institucionin fetar të formimit e besimit të Ndre Mjedës; në rastin e Nolit, e shquanin largvajtshëm dhe madje gjenin strehë në institucionin fetar autoqefalist të Kishës Ortodokse Shqiptare, të themeluar prej tij.

Të ishte fanolist në fund të shekullit të kaluar dmth të kishe guximin qytetar dhe intelektual që t'ia grisje maskën e së keqes, pushtetit, politikanit, akademikut, shkrimtarit e klerikut serb, maqedonas e malazez, ashtu sikur bënë Profesor



Rexhep Qosja në Kosovë, Profesor Agim Vinca në Maqedoni dhe Profesor Nail Draga në Mal të Zi.

Të jesh fanolist sot

Të jesh fanolist sot do të thotë të jesh krijues, që më parë se sa t'i artikulozh idetë, temat, mendimet a konceptet në veprën fetare, letrare, politike, kulturore a shkencore, duhet të krijosh neologjizmat, fjalët vetjake, termat shkencorë, mbi strukturën fjalëformuese e kuptimore të gjuhës shqipe, aq të munguara në komunikimin shkencor, politik e kulturor sot; të jesh nolian sot do të thotë të jesh i pakompromis në identifikimin e saktë të shqetësimeve ditore dhe t'ia çjerrësh maskën politikanit, deputetit, qeveritarit dhe uzurpatorëve të institucioneve shtetërore, arsimore, shkencore e kulturore, aq të pranishme në jetën tonë kombëtare sot; të jesh fanolist sot do të thotë të jesh i vendosur në përzgjedhjen dhe sjelljen e vlerave universale për kulturën e popullit tënd, aq të munguara në institucionet shkencore e akademike sot; të jesh fanolist sot, do të thotë të jesh i vendosur deri në shenjtëri për të thënë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën në jetën tonë, pra, të besosh dhe të jesh i bindur deri në idealizëm se e vërteta dhe vetëm e vërteta e sjell fundin e lumtur të çdo gjëje; madje, të jetës dhe të vdekjes!

Të jesh fanolist sot, do të thotë të

respektosh qytetërimin, trashëgiminë, besimet fetare, Lindore e Perëndimore në jetën e popullit shqiptar, e kjo do të thotë të mos e shohësh fqinjin si mysliman, katolik a ortodoks, po si shqiptar të një përkatësie, të cilën ai e ka zgjedhur brenda zemrës së tij. Të jesh nolian, në të vërtetë, do të thotë t'i japësh kuptimin kombëtar institucionit fetar në të cilin i lutesh Perëndisë, pa ndërre nevojën që të kalosh në tjetrin për të ridimensionuar imazhin kombëtar, intelektual e kulturor vetjak.

Të jesh fanolist sot, do të thotë të mos ndalesh një jetë të tërë, së hulumtuari e studiuar veprën e Fan Nolit, sikur bëri Nash Jorgaqi dhe të vazhdosh atë rrugë sikur bën sot studiuesi Sevdai Kastrati në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe botuesi e studiuesi Mehmet Gëzhilli në Shqipëri.

Të nderosh Nolin sot, do të thotë të botosh veprën e plotë, sa më të plotë të tij, ashtu sikur vepron fanolisti nga Tirana, Z. Mehmet Gëzhilli, duke botuar jo vetëm krijimtarinë letrare, mendimin shkencor, publicistikën, përkthimet etj., po edhe literaturën kishtare, në një kohë që edhe botuesit shumë herë më të mëdhenj se ai, kujdesen të botojnë prej tij vetëm një pjesë të *Albumit*, *Historinë e Skënderbeut* dhe shumë shumë ndonjë përkthim të Shekspirit për nevoja të lekturës shkollore.

Të jesh sot fryma e Fan Nolit do të thotë të mbrosh me dije dhe me kulturë



shkencore e intelektuale Autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare, duke botuar liturgjinë noline kishtare dhe ta vesh në funksion të secilës Kishë dhe lutësve të saj, ashtu sikur vepron editori Mehmet Gëzhilli në Tiranë.

Të nderosh dhe të risjellësh sot mendimin politik, shkencor e letrar të Fan Nolit në gjithë hapësirën shqiptare, do të thotë të punosh me dekada për të përgatitur *Bibliografinë* shteruese të tij, duke e vendosur deri edhe në Bibliotekën e Harvardit, ashtu sikur punoi e punon studiuesi e editori nga Tirana, Mehmet Gëzhilli.

Të jesh bartës i Frymës fanoliste sot, sot do të thotë të nderosh e respektosh demokracinë planetare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, do të thotë ta mbash në tavolinën e punës e ta nderosh Kushtetutën Amerikane dhe ta mbash në tavolinën e punës e ta respektosh Kushtetutën e shtetit tënd. E kjo do të thotë, ta mbash në një rrëzë dorë *Biblën* a *Kuranin* dhe në dorën tjetër Kushtetutën dhe shpatën. Besoj, të tillë ishin fanolistët e Luftës së Kosovës në vitin 1999, luftëtarët e Batalionit “Atlantiku”, për të cilët vite më parë pata shkruar: Nëse moshatarët e tyre në trojet etnike ishin rritur dhe përgatitur për luftë duke lexuar *Biblën a Kuranin* dhe duke u vetëdijësuar për lirinë si mision njerëzor para varrit të Çerçiz Topullit e Adem Jasharit, luftëtarët e batalionit “Atlantiku” ishin rritur duke mbajtur në dorë edhe *Deklaratën e të Drejtave Universale* dhe duke u frymëzuar nga *Shtatorja e Lirisë*, e cila bashkonte konceptin për lirinë kolektive, krenarinë kombëtare dhe botën humane të tyre. E kjo do të thotë se luftëtarët shqiptarë që erdhën nga Amerika në Luftën e Kosovës ishin pasardhës edhe të frymës së Fan Nolit dhe vargjeve të tij paradigmatiche “Mbahu, Nëno, mos kij frikë / Se kë djemtë n’Amerikë”.

A mjafton kjo që ta përmbyllim fjalën tonë me konstatimin se, Fan Noli me bëmat e tij në fillim të shekullit XX dhe me veprën e tij në fund të shekullit XX, e ka kryer misionin e tij kombëtar, politik, krijues, klerikal dhe human në jetën e popullit shqiptar.

Duke shkruar për Balzakun, Viktor Hygo, pati thënë: “Njerëzit e mëdhenj e bëjnë vet piedestalin e tyre, e ardhmja ngarkohet të vendosë statujën”. Fan Noli ishte i tillë. Krijoi piedestalin e tij mbi në kontinente, por statujën e kemi borxh ta vendosim edhe ne, brezi ynë.

Le të jetë kjo fryma e tij, vepra e tij dhe lavdia e tij, e cila na ka bashkuar edhe sonte!

Prishtinë, 3 qershor 2023

* Në “10-vjetori i Degës së Federatës VATRA Queens NY”, SHBA



Shfletimi i përmbledhjes poetike *Spiralja e frikës*, të autorit Biser Mehmeti, varësisht materies së vargjeve, më krijoi ndjesinë e një bote poetike ndryshe. Tekstet, në secilin prej tyre, si njësi të mëvetësishme, apo në tërësinë e materies letrare, pikësëpari sugjeron mëdyshjen, dyshimin, mosbesimin, në botën që shohim, në botën që duket, mbase duhet thënë në fasadën e përngjyrosur gjer në shpifje.

Biser Mehmeti deri tani ka botuar romanet: “Nata pa mëngjes”, “Jetë e mohuar”, “Fjala e ngrirë”, “Dielli i ftohtë”, “Shpirtshitësit e Simonidës”, “Një tragjedi kosovare”, “Lulja e hidhur”, vëllimet me tregime: “Katër kalorësit e apokalipsit”, “Takimi me vrasësin tim”, “Heroi i mohuar” si dhe vëllimin me poezi “Zhgjëndërr e vrarë”, pra mbizotëron prozatori, por “thyen” rregullat e pushpallura, duke u kthyer te poezia. Dhe, prandaj materia letrare e librit, si rastësisht sugjeron se nuk kemi të bëjmë me një mëdyshje rastësore, me gjasë një mëdyshje dosido, por është një thirrje dhe klithmë ekzistenciale, e qenies që vjen e përplotësuar me zërin e poetit. Një thirrje ekzistenciale, ku bota zhvishet nga mashtrimi, fjala e poetit, të shpie në realitetin që nuk fshehim dot, jo se nuk mundemi, po se prishet, shkërmoqet magjia e fjalës si poezi. Mëdyshja ekzistencialiste e shpallur në hapësirën tekstologjike të librit *Spiralja e frikës*, si një nivel tjetër i ekzistencës së qenies, zëshmohet në poezinë që paraprin ciklet e vëllimit poetik. Vargjet: *Na thanë/ Ecni përpara/ Dhe ne ecëm/ Edhe pse/ Nuk deshëm të ecnim/ Kur ecëm/ Na dënuan/ Pse ecëm* (2023: 5), një situim letrar i cili qysh në krye e zbulon këtë mëdyshje, të natyrës së pastër ekzistenciale, të qenies dhe unit poetik.

Poezi e mendimit si antimendim

Dialogu poetik, me veten dhe botën, i shpalosur në faqet e libri më të ri poetik, *Spiralja e frikës*, gati e ka zhveshur qenien nga gjërat e tepërta. Në qendër të shprehësisë letrare, ka vënë formën më të lartë, mbase edhe më përfaqësuese, ka vënë mendimin, e përthyer në stilemat letrare. Largimi i tepërcave, mbase i “bëzhdileve”, kinse letrare, të përkohshme dhe kalimtare, ka endur në hapësirën e teksteve një poezi, ku përplasen meditimi vetmitar dhe mendimi, për të mbetur gjithsesi në fushën e betejës mendimi, që gjithherë shqiptohet poetikisht. Mendimi, derdhet në vargjet e poezisë “Kam frikë”: *Nuk guxoj/ Të dal për gjah/ Kam frikë/ Në vend të ujkut/ E vras veten/ Kam frikë/ Kur të kthehem/ Në shtëpi/ Më prët ujku/ Kam frikë/ Kur të vdes/ Ujku më nxjerr nga varri* (2023: 11), që dukshëm shpalos pasigurinë e jetës, ku të gjithë e shohim, e ndeshim në rrugë, e megjithatë kemi drojë ta themi, madje bëjmë sikur as nuk e mendojmë, si gjendje absurde. Poezia, liria sublime e shprehjes, e thotë qartë, pa grimën e vrasjes së ndërgjegjes, atëherë kur bota ishte prishur, e vargjet vetëm sa vizatojnë të vërtetën e hidhur, të shkatërrimit të saj. Poezia e tillë, e zhveshur nga lulkat dhe ornamentet ulëritëse, që e shkallmojnë shkrimin e poezisë, shkon gjer në thelb, në palcën e shkatërrimit, si poezi mendimi, me shumë gjasë që shpaloset si antimendim, me ata që të kredhur në mashtri, konformizëm, limonti, hipokrizi, edhe kënetat u fanitet si qiell i pastër. Poezia e mendimit si antimendim, si grisje e botës hipokrite, shfaqet edhe në vargjet e poezive: *Lulet e kalbura, Kjo stinë, Gëzohemi si të marrë, Përrallë moderne, Dielli shfaqet natën...* Vargjet e poezisë *E putha djallin: E putha djallin/ Që kishte veshur/ Lëkurën e engjëllit/ ...Një ditë më lidhi/ Me shtatë palë zinxhirë/ Të mos marr malin/ Kot klithja/ Kot përgjërshesha/ Kot mallkoja...* (2023: 115), një gjendje letrare unike, që shenjtëron

Shënime për vëllimin poetik *Spiralja e frikës*, të Biser Mehmetit, botuar nga shtëpia botuese Buzuku, Prishtinë, 2023

POETIKA E MËDYSHJES EKZISTENCIALE

nga Behar Gjoka

antimendimin si mendim, si vlerë e arsyes, që e zbulon botën e trazuar, të kohës dhe qenies, më qartë se gjithçka tjetër, në këtë rrokulli ku kemi rrëshqitur, pa vënë re humnerën që afrohet më pranë nesh.

Metamorfoza e kohës dhe kundërtisë

Vënia e gishtit në plagët e kohës dhe qenies është guxim krijues, është po ashtu gjetje letrare, por më tepër është dëshmi e tjetërsimit të qenies, në një kohë gati të zbërë, të shprishur nga vlerat humane. Njeriu, në këto mote, ka ndryshuar shumë, aq shumë sa tani nuk njeh as veten. Vështirimi i kësaj të vërtete, në beben e syrit, i kësaj të vërtete, të hidhur farmak, e sidomos dalja nga moçalishtja hipokrite e tjetërsimit, e konformizmit me shëmtinë, pra pastrimi shpirtëror, gjithsesi edhe në këtë univers terri të fjalësuar, përkon me rëndësinë dhe vlerën e mendimit, për të lëshuar dritë në errësirën shpërfytyruese, që

ka lëshuar kjo kohë mbi qenien njerëzore. Gjendja e një transformimi të pazakontë, shpërfaqet në kaq shumë dimensione, në disa nga poezitë e përmbledhjes, si në vargjet e poezisë “Gëzohemi si të marrë”: *Gëzohemi si të marrë/ Kur e vrasim zogun në degë/ Kur anija na përmbysët në det/ Kur e humbin rrugën në oborr/ Kur qiriu na fiket në errësirë/ Kur flasim gjuhën e huaj/ Kur na i ha ujku delet/ Kur vdes bilbili/ Kur na verbohen sytë/ Kur lumi shteron/ Kur nuk bie shi/ Kur dimri i ngrinë lulet/ Kur na braktis shpresa/ Kur na mund armiku* (2023: 16), si një shprehësi e plotë e çmendurisë së marrëzisë, që për çudi po lulëzon në këtë periudhë. Po ky ton polemizues, ndonëse i përcjellë me heshturimën e tekstit, që vetëm nuk ulërin, shfaqet edhe në disa poezi të tjera, si në *Përrallë moderne, E mbolla lulen, Lëkura e ujkut, Unë dhe vetvetja, Në mes të bishave* etj., por shenjëzimi më i plotë shprehet në vargjet e poezisë “Metamorfozë”: *Zemra m'u bë gur/ E guri m'u bë zemër/ Nata m'u bë ditë/ E dita m'u bë natë/ Era m'u bë lis/ E lisi*




m'u bë erë/ Shpirti m'u bë borë/ E bora m'u bë shpirt/ Koha m'u bë ujk/ E ujku m'u bë kohë/ Jeta m'u bë vdekje/ E vdekja m'u bë jetë (2023: 100), ku formësohet gjithë përmasa e metamorfozës që ka ndodhur me kohën dhe me qenien njerëzore. Vargjet e poezisë paraprirëse të librit, të organizuar me cikle më vete, konturojnë tipologjinë e metaforës së kundërtisë, të endur si një befasi estetike në poezinë e larmisë lakonike. *Lulet e kalbura*, që emërtion ciklin e parë, si dhe vargjet e poezisë me këtë titull, sugjeron metaforën e brishtësisë së unit poetik, si një kundërvënie ndaj shëmtisë së kohës. Cikli i dytë, *Mjegull në shpirt*, dhe sidomos poezia me këtë titull, shpalos metaforën e grisë totale, ku gjithçkaja është ngjyrosur në grinë e pa ngjyrë. Cikli *E putha djallin*, si dhe vargjet e poezisë me këtë titull, të cilat janë realizuar me disa tercina dhe një katrenë, duke shpalosur metaforën e tjetërsimit. Për të vijuar me ciklin *Kënga e sëmurë*, dhe vetë poezia e realizuar me tercinë, shqipton një metaforë të përmbysur. Për ta mbyllur me ciklin *Zemra e vdekur*, si dhe vargjet e poezisë me këtë titull, është shenjë e metaforës së trishtimit të ndritshëm. Megjithatë, metafora e kundërtisë, vjen e shprehur me të gjithë dimensionet e veta, në vargjet e poezisë *Kundërthënie*, në gjithë materien që kulmon me fillimin: *Flas/ Edhe kur nuk kam/ Çka të flas* (2023: 132).

Struktura e përmbledhjes

Një element përveçës i përmbledhjes me poezi *Spiralja e frikës*, një metaforë e pazakontë, ku shenjohehet makthi dhe tmerr i qenies, individuale apo komunitare, përballë shkatërrimit total, është ndarja me cikle e kësaj përmbledhjeje. Hallkat përbërëse të strukturës së vëllimit poetik, janë:

- Poezia paraprirëse *Na thanë*
- Cikli poetik, *Lulet e kalbura*, një metaforë e përmbysur, që përbëhet nga njëzet e nëntë poezi të shkurtra.
- Cikli i dytë, *Mjegull në shpirt*, një metaforë e pazakontë, që portretizon rrëzimin e qenies, i cili përbëhet nga njëzet e nëntë poezi, po ashtu tepër koncize si model shkrimi.
- Cikli i tretë, *Takim me Ana Kareninën*, ku metaforikisht kemi një arratisje nga konkretja, diku për në botën librore, që ka të përfshira pesëmbëdhjetë poezi.
- Cikli i katërt, *E putha djallin*, ku kemi sërish një metaforë të përmbysur, në një gjendje të pazakontë, ku janë përfshirë nëntëmbëdhjetë poezi, tepër të shkurtra.
- Cikli i pestë, *Kënga e sëmurë*, një metaforë totalisht e përmbysur, që përbëhet nga njëzet e katër poezi.
- Cikli i gjashtë, *Zemra e vdekur*, ku vetëm sa thellohet përmbysja metaforike, në të cilin janë përfshirë njëzet e dy poezi.
- Pra, kemi të bëjmë me njëqind e tridhjetë e tetë poezi, të ndara në gjashtë cikle, të cilët qëndrojnë edhe më vete, por në këtë bashkëlidhni semantike dhe stilistike, endin një univers letrar vetjak. Elementi stilistik, i ndarjes me cikle, shpërfaq edhe një tipar tjetër, të poezive lakonike, të stilit konciz të shkrimit poetik.



Ridimensionim i vargëzimit të matur

Përmbledhja *Spiralja e frikës*, shpërfaq disa fibratura vargëzimi, brenda natyrës së vjershërimit të matur, por duke e dinamizuar pentagramin shprehës. Në mesin e tyre, do të veçoja:

A – Shkrimi me anë të distikut apo dyvargëshit, që ka realizuar me dhjetëra poezi, dhe për të krijuar idenë po sjellim vargjet e poezisë *Antitezë: Sa shumë njerëz të vdekur/Ecin mbi dhe//Sa shumë njerëz të gjallë/Kalben nën dhe* (2023: 180).

B – Poezi të shkruara me anë të terci nës, trevargëshi, janë realizuar disa poezi, dhe po veçoj poezinë “Miqtlë: Në errësirë/I njoh më mirë/Se në dritë//Më mirë i kuptoj/Kur heshtin/Sesa kur flasin” (2023: 59).

C – Kombinimi i strofave të ndryshme, brenda një poezie, vjen i realizuar në disa forma:

– Distiku i kombinuar me terci nënë në shumë poezi, dhe për të krijuar një ide fillestare, po shkëpus disa vargje të poezisë “Zbres në tokë”: *Pa shkallë/Zbres nga qielli/Në tokë//Në ëndërr/verë/Në zhgëndërr/Dimër* (2023: 150).

– Tercina e kombinuar me katrenë, pra me strofën katërshe, që përbëjnë formën më të gjerë dhe më të shtrirë në poezitë të kësaj përmbledhjeje. Për të dhënë një ide të përdorimit të gjerësishëm të këtij modeli, por paraqes të plotë vargjet e poezisë “E mbolla lulen”: *E mbolla lulen/Në vend të saj/Mbi ferra/Në shpirtin tim//Nga gjembat e saj/Ëndrrat pikonin gjak/Në për trupin tim//Nga bebëzat e syve/Nata shtatzënë/Lindte përbindësh/Me shtatë krerë//Një ditë/Koha ime/U mbush me ferra* (2023: 20)

– Të ndryshme, me strofa katërshe, me kombinim të distikut, terci nës, katërshes, me vargje monokolon, duke endur një poezi të vltë, varësisht pranisë së vargëzimit të matur, duke e dinamizuar me anë të gërshetimit të pozicioneve të larmisë.

Praktika e shkrimit me anë të vargjeve të matura, jo si rimarrje, po si një riformulim, si konturim në situatë të pazakonta, e ka tonifikuar vargëzimin e tillë, por ka mundësuar endjen e poetikë së mëdyshjes, të thurur me kurora metaforash, të një laryshie të beftë estetike.



Një ditë pasi kisha marrë në dorë librin e fundit të Elvira Donesit, “Jeta e shkurtër e Lukas Santanës” (La nave di Teseo 2023), ndahej prej nesh i madhi Kormak MkKarti. Një shkrimtar që e kam vlerësuar gjithmonë, prandaj ikja e tij më ‘ngacmonte’ vijimin e leximit. Ecja përpara dhe po e nuhasja se kishte edhe diçka tjetër që më sillte aty ndër rreshta pikërisht MkKartin. Fakti, që romani i ri Donesit i vendos ngjarjet në botën hispaniko-amerikane. Pa ka edhe tjetër, diçka edhe më të rëndësishme: stili minimalist, karakteristik i MkKartit, një mënyrë rrëfimi që ia del të kondensojë e të shprehë njëkohësisht, i cili më bëhej se vinte edhe aty në shkrimësinë e Elvira Donesit.

Po, sipas meje, këtë radhë do të gjeni një Dones në versionin Kormak MkKarti! Edhe pse askush nga shkrimtarët e mirë, thellë-thellë, nuk e ka me qejf të krahasohet me dikë, kam përshtypjen.

Dhe ja ku mbërrin një paragraf që mua më tingëllon gjenial. Më lë të kuptoj se mbetemi sërish tek minimalizmi, por ky përfordhet tani me intensitetin dhe elementë të tjerë të rinj e, për magji, më bën të përshëndetem me fantazmën e MkKarthit e të zhytem përfundimisht në leximin e Donesit. Shtegun ma hapën këto fjalë:

“Ai del nga dhoma, mbyll derën me dy kanate, zbret shkallët e fjetores dhe, fillon të vrapojë nëpër natë pa e vrarë mendjen drejt atij që rron e atij që vdes”. Po ndieja sikur autorja po fliste për dhe me mua.

“Jeta e shkurtër e Lukas Santanës” është përcaktuar si “një roman koral i një intensiteti të lartë, që di të përftojë shpresa e humbje vetiake përtej sferës së ligjeve”. Mendoj se në këtë hulli rrjedh zakonisht edhe letërsia artistike: trilleri, për shembull, ndërtohet “përtej sferës së ligjit”, me personazhe të cilët duan të zgjidhin problemet e tyre në luftë kundër një mjedisi në dukje ligjor, por që është armiqësor dhe absurd.

Mirëpo, që nga faqet e para të lexuara, nuhas menjëherë që këtu duhet ti bëjmë llogaritë me legalitetin e vërtetë, atë të krijuar nga ne njerëzit, e për këtë shkak shkruajues, i cili kur na vihet kundër, dobëson veprimin dhe reagimin tonë. E prandaj, në të tilla raste lypset një tjetër letërsi, pikërisht ajo që kam përpara, me një vulë të fortë gazetarie, tipike e Donesit edhe në librat e saj të mëhershëm, e cila nuk mëton t’i ikë por rri e ushqehet me këtë realitet të ashpër, gjen në intensifikimin motorin që do të çlirojë një reagim shumëfish: ajo atmosfera e tmerrit, ndjesia vetiake si të kesh ngrënë një grusht stomakut, të cilën e kam përjetuar në romane e tjerë të saj, këtu vjen e bëhet një reagim me rreze të gjerë, ku ndjesitë, reagimet, mëtojnë të përjetojnë bashkë me të tjerët. Leximi im copëzohet e më ikën ajo ndjesia e të qenit një lexues i vetmuar. Toni rrëfyes këtu ka timbrin e polifonisë së një kori personazhesh që vijnë nga e gjithë bota dhe, si lexues, ndihem njëri prej tyre, jam i lidhur me ta përdore në një udhëtim të përjetshëm ‘drejt atij që rron e atij që vdes’.

Po çfarë ndodh përreth historisë së Lukas Santanës, që po jeton prej dhjetë vitesh nën sqetullën e vdekjes edhe pse nuk ka vrarë askënd? Po, ka shkëlur Ligjin mbi Bandat dhe për shtetin e Teksasit dënimi i tij është vdekja.

Përreth këtij personazh-bërthamë sillen rrotull të tjerë satelitë. Në rrethin e parë pjesa më e madhe janë gra e vajza të thirrura në apel thjesht për të vuajtur në mënyrën e tyre. Këtu lexuesi mashkull vihen menjëherë në pozitën e një katarsisi. Janë meshkujt, për fat të keq, që e godasin gruan, në fillim me praninë, e pastaj më fort, me braktisjen e tyre. Se paradigma e braktisjes mashkullore godet, gjithmonë e kudo qoftë, atë, gruan.

Beatriz Macedo, vajza që Lukas ka njohur vetëm tre muaj para arrestit, nuk ndjek më ëndrrat që ka thurur për jetën e saj, po i shkon pas atij edhe në mungesë,

Shënime për romanin “Jeta e shkurtër e Lukas Santanës” nga Elvira Dones

ATIJ QË RRON E ATIJ QË VDES

nga Durim Taçi

kur më parë, në fëmijërinë e vet, ka njohur braktisjen nga babai që ka lënë familjen; Mirami, nëna e Lukasit, keqtrajtuar nga burri i parë, tani jeton burgun e të birit si jetë të saj të dytë. Tezja e tij Ines, motra më e vogël e nënës, e cila jeton në Kaliforni, edhe pse për të çuar deri në fund një karrierë intelektuale, përveç dhimbjes për humbjen e vëllait Abel, vuan njësoj edhe për nipin e saj. Falma, mikesha e Inesit, me origjinë shqiptare, duket sateliti më i largët i mbërritur nga vuajtja.

Po ja ku hidhet poshtë e gjitha: se ka edhe një rreth të dytë satelitësh, personazhe mashkullorë që vuajnë përreth Lukasit: Tierri Morel, një student zvicerano-frances që po mbron doktoraturën në Kriminologji, jep e mer me të dënuarin, shkëmben letra të ndiera; Shenjtori, një i dënuar afro-amerikan, që e ka qelinë ngjitur me Lukasit, është mbështetje për të me këshillat e natyrës folozofike.

Këto tipe vuajtjesh nuk janë një përplasje midis mashkullores dhe femërores. Është fjala për nevojën njerëzore për përkrahje. Ndjesia e Lukasit para vdekjes mund të sillet me fjalët e Klarisë Lipektorit, - shkrimtare, gazetarë dhe përkthyes ukrainase e natyralizuar braziliane - e cila edhe citohet nga Dones në roman, që thotë: “Të vdes do



të thotë të ndërmarr rriskun më të madh, pasi nuk do di të kaloj nga vdekja e të bëj atë hapin e parë fill pas humbjes sime – edhe në atë orë të fundit sikurse më parë do ta shpik praninë tënde të panjohur mik, se vetëm në shoqërinë tënde, do të filloj të vdes e derisa sa të mësoj vetë të mos jem më, atëherë do të lë të lirë. (Pasioni i G. H., Feltrinelli 2019). Po, Lukasi ka pasur nevojë të shoqërohet e të ndihmohet për të vdekur.

Po shkruaja në fillim për stilin: minimalist dhe intensiv. I tillë ka qenë edhe udhëtimi im i leximit të këtij teksti dhe kam pasur përshtypjen se isha pjesë e një kortezhi që proteston jo ndaj vdekjes si e tillë, por kundër projektimit të saj të errët mbi jetën.



Emilios Solomu është një emër i njohur për lexuesin shqiptar. Romani “Fluturoi shpejt si harabel” është i katërti i përkthyer dhe botuar në Shqipëri.

E veçanta e këtij libri është fakti se është i pari në rrugën e suksesshme të këtij autori qipriot si prozator, krijimtari e cila do të kulmonte me Çmimin Evropian për Letërsinë në vitin 2013 për romanin “Ditari i një pabesie”, që është ditari i njeriut të sotëm intelektual, i njeriut që shkel mbi ndërgjegjen e vet dhe ajo ngre krye, e rrëmben nga qafa dhe e detyron mes përpëlitjeve t’i bëjë gjyqin vetvetes.

Kjo veçori nuk është vetëm e këtij romani, që kritika evropiane e nënvizoi dhe vlerësoi. Lufta e brendshme psikologjike, konflikti me vetveten, erinitë që e ndjekin dhe e gërryejnë botën e tij si ujërat e rrëmbyeshme tokën, ku më pak e ku më shumë, janë veçori potente në gjithë krijimtarinë e Solomusë, që i bëjnë më të strukturuar subjektet me ngjarjet, personazhet e skalitura dhe arkitekturën solide romaneske.

“Fluturoi shpejt si harabel” është shkruar në moshën 23-vjeçare, kur autori sapo kish mbaruar studimet universitare dhe është një roman për dashurinë dhe dhembjen. Ajo që e shtyn autorin e ri të kapë penën dhe t’i përkushtohet shkrimit të kësaj vepre është një lloj amaneti, një ngjarje e dhimbshme personale dhe familjare, vdekja e papritur e të vëllait, goditur nga rrufeja. Varri i një djaloshi s’mund të jetë në qimitirin e njerëzve të zakonshëm, por mbi pedestal lulësh, kujtese dhe ëndrre. Përveç idesë së ringjalljes së vëllait dhe përjetësismit në një vepër letrare, shkrimtari, nisur nga kjo ngjarje familjare, na shpalos tablonë e një shoqërie të degraduar, të goditur nga rrufe të shumta, që s’mund të ketë fat tjetër. Kjo rrufe i djeg filizat e dhembjes para kohe, nuk u jep asnjë mundësi përfaqësuesve të brezit të ri të kenë ëndrra dhe t’i realizojnë, të shkollohen e të marrin rrugët e jetës nëpër qytete të mëdha. Duket se fati u ka paracaktuar qysh në fillim perspektivën kobzeze dhe mirologe të së ardhmes.

Në galerinë e personazheve përballen dy breza, pasqyrë e njëri-tjetrit, brezi i ri dhe i të rriturve, prindërve të tyre dhe përfaqësuesve të tjerë shoqërorë. Është tabloja bardhezi e një fshati të braktisur në mëshirën e fatit e të harruar të provincës, sunduar nga bota e vogël e paragjykimeve dhe meskinitetit, një vorbull kaosi që e krijon injoranca, varfëria dhe frika për të ardhmen. Në këtë roman, që e ritheksojmë së është i pari, spikatin karakteristikat më të mira të një prozatori që shpejt do të ngjitet si një yll i ri në horizontin e letërsisë evropiane. Ka një lloj realizmi në këtë roman, që të kujton herë-herë realizmin magjik të Markezit, po kështu, mbresëlënëse është edhe vizatimi i gjallë i portreteve të personazheve me detaje simbolike përmes ngjarjeve intensive dhe përshkrimit të mjediseve dhe karaktereve në lidhje perspektive me një fantazi produktive për të na çuar tek e papritura.

Që në frazat e para autori fokuson personazhin kryesor, Vangjelin, në momentin e lindjes dhe sapo hap sytë lëshon një të qarë ankuese se e lëndon atmosfera rrethuese dhe fytyrat që lëvizin në të. Dritarja e parë janë sytë e këtij fëmije që simbolikisht autori na e jep të ketë gjykim e maturi për këtë botë që në çastin e lindjes dhe vazhdon të vështrojë dhe të gjykojë njerëzit dhe botën edhe kur mbyll sytë dhe ikën nga kjo jetë. Në njëfarë mënyre bëhet një transplantim, vëllai njësohet me autorin, bota dhe meditimet

Me rastin e botimit të romanit *Fluturoi shpejt si harabel*
nga Shtëpia Botuese Neraida

EMILIOS SOLOMU, SHKRIMTARI I STANDAR- DEVE EVROPIANE

nga Petro Çerkezi

e tij transplantohen te shkrimtari, i ka hyrë në gjak dhe vazhdon rrëfimin e tij dalldisë. Mënyra më komode për ta shpirtëzuar njeriun e dashur, për ta sjellë në kohën e ëndrrës së tij të humbur dhe është një ngushëllim për autorin.

“Askush nuk më pyeti nëse doja të rroja këtu. Instinkti më thoshte se kisha shumë për të vuajtur në këtë jetë. Më dhembën sytë nga drita e tepërt. Hapa e mbylla qepallat me hezitim. Fillova të qarën ankueshëm. Jo, nuk më pëlqeu këtu. Tundja këmbët, krahët, kokën, shkelmoja, shtyja. Më kot.”

Kjo botë ku lind ky fëmijë bie erë kalbësirë dhe personazhet, secili me dramën dhe historinë e vet, ngjajnë me mbeturina njerëzish, gjysmënjerëz, gjysmëhije, janë viktima të një shoqërie antinjerëzore. Autori nuk e përcakton kohën e ngjarjes, por është e kuptueshme, është periudha e amullt kur vendi sapo ka dalë nga një robëri e gjatë, por ende nuk e sheh kthjellët rrugën që do të marrë.

Personazhet demonizohen dhe rivdesin me veprimet e tyre. Vuajnë nga braktisja, amullia dhe kalbëzimi. Na jepet vetmia lakuriqe e njeriut dhe i vetmi konflikt që pulson dramatikisht është me vetveten dhe fqinjin që herë-herë arrin shkallën e marrëzisë. Kjo i çon njerëzit të gjenden në një atmosferë hipnotike dhe të enden si somnambul. Të vetmet shkëndija të një bote të gjallë janë fëmijët që e thyjnë në njëfarë mënyre guaskën e atmosferës mbytëse të prapambetjes dhe paralizës. Ngjarjet rrokullisen kaq shpejt, si në një shtrëngatë dhe nuk është një, por disa dhe shkojnë paralelisht natyroret me shoqëroret, që lënë viktima pas.

Është një roman për kohën, korrupsionin, kujtesën, dashurinë dhe pabesinë që zhvillohet mes së tashmes dhe së shkuarës.

Pa dyshim, nuk është çmimi që evidentoi vlerat e shkrimtarit, por




çmimi ndihmoi për njohjen e gjerë dhe përkthimin e veprave të tij jashtë atdheut. Kështu, vepra “Ditari i një pabesie” pati 11 përkthime në gjuhë evropiane dhe u prit mirë nga kritika dhe nga lexuesit e vendeve të ndryshme.

Emilios Solomu është një nga forcat e qeta në fushën e romanit. Me vetëm disa romane të mira në krijimtarinë e tij ai ka arritur diçka shumë të vështirë: fitimin e vlerësimeve të mëdha dhe përvijimin e një trajektoreje të vazhdueshme në rritje! Publikimi i dy romaneve *Ditari i një pabesie* dhe *Urrejtja është gjysmë hakmarrje* e ngritën atë në shkallën e një shkrimtari bashkëkohor evropian. Solomu nënvizon si është të shkruash për një histori që lidh të kaluarën me të tashmen, më e theksuar kjo te romani voluminoz *Urrejtja është gjysmë hakmarrje*. “Shkrimi i librit ishte një provë, jo vetëm sepse më duhej të lexoja dhe hulumtoja shumë, por edhe sepse e ndieja se historia ime, ashtu siç u zhvillua nga ditët e sotme deri në vitin 1870 dhe anasjelltas, më rrëshqiste vazhdimisht nëpër duar dhe ikte. Kam punuar shumë me teknikat e rrëfimit, stilin që ndryshonte nga kapitulli në kapitull, marrëdhëniet midis personazheve. Ndjeva se ishte përtej fuqive të mia. Teksti po ndryshonte vazhdimisht si një amebë. Ashtu si libri i mëparshëm *Ditari i një pabesie*, ky ishte shkruar pothuajse në lëvizje... Në Qipro, në Athinë, në Hania. Nën presionin e vazhdueshëm të kohës. Gjithmonë ke ndjesinë se nuk ke kurrë kohë të mjaftueshme për të shkruar. Disi, përballë sfidës së madhe të të shkruarit, kur historia jote vazhdon, ndërsa personazhet e tua kërkojnë të marrin mish e gjak, të kenë zë, nuk ke zgjidhje tjetër veçse t’i shoqërosh, t’i ndjekësh në çdo hap. Të marrin për dore dhe të drejtojnë në një nevojë thuajse metafizike, për të shkruar, shumë herë me një ritëm astmatik, për ndonjë arsye të pashpjegueshme për të kapur hapin, sikur dëgjon në vesh rërën që bie nga klepsidra. Koha mbaroi. Edhe ju duhet të arrini në fund. Do të pushoni vetëm kur të shkruani fjalën tuaj të fundit. Më pas, sigurisht, do të jetë montazhi, lufta disamujore me fjalët, stilin, rrëfimin, personazhet”.

Romanet e Solomusë, me problematikë të theksuar shoqërore, me shqetësimet intelektuale dhe ekzistenciale të njeriut të sotëm, shkruar me art të guximshëm, harmonizuar me përmbajtjen dramatike, me një narracion të shkathët romanesk, humanizëm të standardeve njerëzore evropiane përçojnë ide dhe mesazhe që bëhen të pëlqyeshme e përqafohen më shumë nga lexuesi i sotëm disi i çorientuar nga politikat globale antinjerëzore.

Romani *Fluturoi shpejt si harabel*, botuar nga Shtëpia Botuese Neraida, përcjell skena dhe ngjarje që të kujtojnë fshatin shqiptar në periudha të kaluara historike dhe jo vetëm.



Në një sistem letrar kombëtar, personazhi, i lidhur organikisht me autorin dhe tekstin, sintetizon elemente të tjerë të tij, sidomos në korrelacion me institucionet dhe kontekstin socio-politik në kohë. Kjo qartësohet edhe më shumë në ato prerje sinkronike kur sistemi shtrëngohet të dalë nga zhvillimi natyral, siç është edhe rasti i letërsisë shqipe. Historikisht, skalitja e personazhit në zhanrin e prozës ka shenjuar krejt etapat evolutive të letërsisë europiane e botërore, madje jo rrallë të cilësuar nën emrat e tyre.

Në letërsinë shqipe, proza, konkretisht romani, lëvrohet me vonëse krahasimisht me letërsitë e tjera, por gjithsesi ka një traditë të sajën e cila përmes teksteve më cilësor funksionon si një proces koherent edhe me rimarje temash e motivesh duke synuar evolumin e zhanrit. Pjesë integrale e këtij procesi, me termat e letërsisë së krahasur do të thoshim transmetimi, ndikimi, apo vazhdimësie, është edhe personazhi.

Nga kjo optikë, strukturimi i personazhit të “beut” mbetet një çështje me interes, edhe prej faktit se gjendet të disa prej autorëve qëndror si Kuteli dhe Xoxa. Për më tepër, siç e ka vënë re qysh herët mprehtësisht Vehbi Bala, kur flet për lidhjet mes letërsisë shqipe dhe asaj rumune, nëse do të flisnim për një model rrëfimor në prozën shqipe të themeluar nga Kuteli, ndryshe rrëfimi kutelian, Jakov Xoxa është vëzhduesi më i përpiktë i tij. Afërmendsh që elementi ideologjik sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, mbetet përcaktues në stereotipet mbi të cilat sendërtohet ky personazh. Më herët është Noli i cili në disa nga poezitë e tij, veçanërisht tek ato me shtrat të fortë politiko-satirik e ka të pranishëm figurën e beut, por vetë lirika e brendashkruan kufizimin në selitjen e personazhit krahasimisht me prozën. Gjithësesi “beu”, apo “bejlurçina” është shenjestër e shpeshtë e Nolit publicist.

“Beu” shfaqet si një personazh “ikonik” në rrëfimin *Vjeshta e Xheladin Beut* të Mitrush Kutelit, një nga rrëfimet më të njohura të tij, që jo rastësisht është rrëfimi i parë në vëllimin e parë të veprës letrare të autorit, botuar në pesë vëllime në vitin 1989¹. Fillimisht autori ka botuar një variant të sajën në revistën “Shqipëria e Re” Bukuresht në vitin 1929 për ta ripunuar shumë kohë më pas në vitin 1965. Varianti

VARIANTE NË KËRKIM TË INVARIANTIT: “BEU” TE NOLI, KUTELI DHE XOXA

nga Eldon Gjika

i parë, me titull *Në vjeshtë e jetës*, ka një vëllim shkrimor shumë më të pakët se varianti i dytë. Ndërkohë krahasimi mes tyre ofron mundësi për të dekoduar nivelin semantik të tekstit, apo qëllimin e autorit në raport me lexuesin. Ky rrëfim i Kutelit tradicionalisht është interpretuar si kulminacion i “përgjithësimit shoqëror dhe mishërim ideoartistik i temës antifeudale”², interpretim i përqëndruar në figurën e Xheladin Beut me fundin e tij të hidhur. Në këtë hulli rrëfimi shihet në koherencë me rrëfimet e tjera të Kutelit, “Natë kollozhegu”³ dhe “Natë muaji shëmbitër”⁴, të cilat kanë si personazhe qëndror figura bejlerësh veseli të zvetnuar moralisht që i shkojnë të keqes deri në fund; tek i pari Olloman beun dhe te i dyti Kahreman Beu.

Specifikat semantiko - formale që ofron teksti “Vjeshta e Xheladin beut”, në përplotësim të njëra tjetrës, japin mundësi për një qasje interpretative krejt ndryshe, të cilën e kam trajtuar në një punim të mëhershëm, thelbi i të cilit qëndron te përveçimi i Xheladin beut si personifikim i një individi të zvetënuar deri në palcë në aspektin psiko-social, tashmë në zgrip të jetës, por jo si një figurë përgjithësuese në aspektin klasor.

Personazhi i Suat bej Vërdhomës në romanin “Lumi i vdekur” të Jakov Xoxës në aspektin historiko letrar shqiptar mbetet nga më të interpretuarit jo vetëm sa i përket prozës së autorit, por letërsisë shqipe në përgjithësi. Përveç mjeshtërisë së Xoxës për të gdhendur në aspektin estetikopoetik një personazh të vërtetë, domethënë të besueshëm në rrafshin receptiv, çështje kjo e trajtuar tashmë hollësisht nga tradita kritike, mendoj se përmes këtij personazhi mund të ndriçohet një tjetër

kënd i prozës së Xoxës, që dëshmon fort cilësinë e ideolektit të tij. Referuar termave të formalistëve rus konkretisht Propit, Shklovskit dhe Tomashevskit në romanin “Lumi i vdekur” njësitë narrative bërthamë, që gjenerojnë sekuencat narrative në intervale të ndryshme brenda rrjedhës së narracionit, të qëndëruara dhe zhvilluara prej personazhit Suat bej Vërdhoma, dëshmojnë një koherencë të plotë sipas dialektikës rrëfimore fabulthurje narrative, e cila pa asnjë ekuivok dëshmon jo vetëm punën qelizore të autorit me tekstin, por edhe talentin e tij. Nëse do të bëhej një ndërhyrje mekanike në roman, duke shpëputur dhe bashkëngjitur të gjithë segmentet shkrimore, theksoj kronografikisht dhe jo kronologjikisht, sepse vepra shpesh ka introspektivë, ku personazh është Suat bej Vërdhoma do të përftonim një strukturë tesktore pothuajse krejtësisht të vetmjaftueshme, e cila me ndërhyrje minimale mund të funksiononte si një vepër më vete, e organizuar plotësisht sipas rendit rrëfimor shkak-pasojë, raport ky i qëmtuar hollësisht në fushën e estetikës dhe filozofisë, qysh nga Aristoteli, Hjumi, Kanti, etj.


Një fenomen i tillë veç talentit të autorit është rrjedhojë e drejtpërdrejtë edhe e formimit të tij solid në fushën e teorisë së letërsisë siç na dëshmohet prej kontributit konkret tekstit “Hyrje në shkencën e letërsisë”, të vitit 1969. Bashkëekzistenca e shkrimtarit dhe studiuesit në entitetin krijues Jakov Xoxa, sjell pashmangshëm një nivel të tillë organizimi shkrimor në romanin “Lumi i vdekur”. Shqetësimin e tij për rëndësinë e aspekti formal në tekst ai e paraqet në trajtë eksplicite në një shkrim kritik në revistën “Nëndori”, nr. 2, 1963, “Rreth dy problemeve të prozës sonë”. Xoxa, përtej argumenteve ideologjike, pothuajse

me një qëndrim kontravers, krahasimisht më të tjerë, përqendrohet në rëndësinë e elementeve formale në një tekst letrar: “Këtu unë do të merrem me dy probleme kompozicionale. Me ekspozicionin si element kompozicional dhe përdorimin e tij dhe me marrëdhëniet mes intrigës dhe të kolizionit në disa nga veprat tona në prozë”. Nga kjo premisë shqyrtimi që ai u bën në vijim disa prej romaneve më të njohura të periudhës, është një kritikë e rreptë e ceneve të tyre strukturore, duke u nisur nga parametra teorik dhe jo ideologjik.

Personazhi Suat bej Vërdhoma, ndonëse shfaqet shumë me episodik krahasimisht me personazhet e tjera, funksion si një qendër centripete dhe centrifugë në të gjithë shtjellën narrative të romanit, sepse e tërë thurima rrëfimore buron prej tij dhe thuket tek ai, sidomos në pjesën përmbyllëse të veprës.

Një çështje që nuk mund të shpërfilllet asesi sidomos për tekste të letërsisë shqipe të shkruara në periudhën 1945-1990, konkretisht shqyrtimin e aftësisë së tyre për të zotëruar atë që Jausi në estetikën e receptimit e përkufizon si “receptim në potencë”, ndryshe pasjen e atij universaliteti, që e bën tekstin letrar të përhershëm. Për këto tekste mendoj se duhen patur në qendër të vëmendjes konceptet e njërës prej përfaqësuesve të fundit të formalizmit dhe strukturalizmit Jan Mukarovski vepra e të cilit vlerësohet si një çast kulmor në mendimin europian në fushën e estetikës dhe teorisë së artit reth viteve ‘30-të ‘40-të. Në veprën “Funksioni, norma dhe vlera estetike si fakte sociale” ai shkruan: “Stabilizmi i funksionit estetik është një çështje që i përket kolektivitetit dhe funksioni estetik është një përbërës i raportit mes kolektivitetit dhe botës. Prandaj një disponim i caktuar i funksionit estetik në botën e gjërave është e lidhur me një kompleksitet social të caktuar”.

E pra për këto tekste ky “kompleksitet social i caktuar” mbetet vendimtar për të kuptuar qëllimin, realizimin dhe funksionimin e tyre, si edhe për të shëstuar njëfarësoj cilësinë estetike. “Lumi i vdekur” i Jakov Xoxës mbetet një nga veprat më të rëndësishme të traditës romanore shqiptare, madje një vepër unike, por ndërkohë ky tekst veçanërisht sot e ka domosdoshmërisht të nevojshme një glosar shpjegues, i cili me sa di është hartuar në serinë e veprave, por që ka nevojë të zgjerohet për një lexues më të shumtë.



1 Mitrush Kuteli *Vepra letrare 1-5*, Naim Frashëri, Tiranë 1989

2 Nasho Jorgaqi *Parathënie*, po aty fq.26
3 *Po aty*, fq.105
4 *Po aty*, fq.202

Mustafa Nano është gazetari më sfidant dhe më antikonformist i ditëve tona, me ca fjalë e gjepte që nuk guxon t'i bëjë kushdo: një panel televiziv ku shkon me xhinse gjunjëçjerra, një përballje spektakolare me shikuesit "One man show", dy emisione televizive si vazhdimësi "Provokacija" dhe "Turkmenistan", botimi i librave polemizues "Unë jam gegë" (2013), "Pax Albanica" (2014), "Sandwich, a është mirë me qenë shqiptar?" (2017), etj. Dhe ja ku vjen me romanin "Një javë në Manastir" (2020) për të vazhduar debatet e hapura, por duke ua deleguar qasjet e veta personazheve që shpesh kamuflojnë figura historike të vërteta.

Në rrafshin sipërfaqësor kemi një vepër artistike me heroin Robert Bolton që jo vetëm zbulon se vuan nga një sëmundje vdekjeprurëse, por, më shumë se kaq, vihet në dyshim qenia baba, pasi Besa mund të mos jetë bija e tij, por mund ta ketë lindur nga marrëdhënia jo shumë e qartë e Matildës me Fred Potterin. Kjo shtysë e fortë dhe tronditëse nuk e lë Robertin të lëngojë në shtrat, por me torbën e udhëtimit ku kishte gjasë të mbartte vdekjen e vet, udhëton nga Anglia në Manastir për ta sqaruar enigmën, ndoshta edhe për t'u hakmarrë ndaj Fredit, udhëtim që përkon me mbajtjen e Kongresit të Alfabetit pikërisht në Manastir. Udhëtimi kthehet në zbulimin e mjedisit shqiptar i cili i kishte shkuar paraprakisht i deformuar. Është një dukuri që vazhdon të përsëritet edhe në ditët tona, shqiptarët kanë njerëzillëkun që mund të mungojë ose nuk arrijnë të demonstrohet te popuj të tjerë. Ky njerëzillëk, pavarësisht nga prapashitesa ~llëk, dëshmon vjetërsinë, maturinë, qëndresën, aftësinë për t'u përballuar me të tjerët duke treguar skutat më me dritë të shpirtmadhësisë. Gjithçka tjetër janë detaje artistike që aredojnë strukturën e nevojshme të çdo veprë.

Në një rrafsh paralel me të parin kemi një trajtesë të gjerë që mëton të jetë edhe shkencore, pasi u jep përgjigje fillesave të gjuhës, pengesave dhe akteve asgjësuese ndaj gjuhës shqipe, me një fokusim më të madh te Kongresi i Manastirit dhe vendimet e tij.

Në rrafshin e nëndheshëm, ose "nën rrogë", kemi një leksion të gjatë për shqiptarin dhe shqiptarizmin, për fenë dhe qeverisjen, për kolonializmin dhe sovranitetin, për vendin dhe rolin e gruas në shoqëri dhe aneksin tabu të seksit. Për këto problematika që mbajnë peshën kryesore të kësaj veprë, autori ka thirrur në skenë një numër dëshmitarësh që orientohen dhe përmbushin më së miri porositë e autorit, fshehur diku si sufleri i shfaqjeve dramatike.

Pjesa e parë "Treni mbërrin në "Ters Dünya" dhe pjesa e dytë "Jeta e Grigor Toskës" janë si dy tufa paralele eventesh që nisen njëkohësisht nga stacioni i trenit dhe udhëtojnë drejt Manastirit; tufa e parë vështrohet me sytë e një udhëtari të huaj, tufa e dytë me sytë e një shqiptari, protagonist në çështjen shqiptare. Udhëtari i huaj Robert dhe shqiptari Grigor janë në të njëjtin grup udhëtarësh, prandaj disa prej eventeve përsëriten në të dyja pjesët.

Fillon si roman historik sepse ka një datë historike, një saktësim të ditës, një qytet të njohur të perandorisë, do të pasohet nga identifikimi i shtëpisë së Zavalanëve që shërbeu si sallë e kongresit. Para se të hapet goja e narratorit vëzhgues, ndjehet dora e gazetarit polemizues, toni deklarativ i veprave të mëparshme ia lë vendin qasjes meditative. Vjen zbulimi i parë i udhëtarit të huaj: ato që shikonte me sy nuk përputheshin me ato që kishte dëgjuar.

Romani "Një javë në Manastir, nëntor 2008" i Mustafa Nanos, Tiranë 2020

SPROVA E RADHËS PËR TË ÇMONTUAR SHTRATIN E PROKRUSTIT

nga Kosta Nake

Përplasja e parë shqiptaro-serbe vjen si përballje e moshës së një instrumenti muzikor që shqiptarët e quajnë lahutë dhe serbët gulsë. Nuk jam i sigurt për raportin kohor mes romanit të Nanos dhe njohjes së gulsës si trashëgimi kulturore e UNESCO-s duke lënë pas lahutën, por autori gjen rastin të sjellë dy argumenta: udhëtarët e huaj zbuluan më parë Serbinë, serbët kishin filluar të shkruanin para shqiptarëve. (f.37) Ngarkesa ka zbritur edhe në gjuhë me përdorimet "shiptar" dhe "albanac" nga njëra anë dhe "shkja" e "serb" nga ana tjetër krahasuar me termat përbuzës magjar, nemce, magjyp, arap, çifut, etj. (f.294) Kjo nuk e pengon autorin ta vlerësojë Shën Savën si personazh historik, themelues i Hilandrit dhe kishës autoqefale serbe, nga ana tjetër të argumentojë se ndeshja me serbët e bën Fotin njëqind përqind shqiptar. (f.297, 311) Përplasja shqiptare serbe, edhe pse në këtë roman kalohet tangent, bëhet edhe për Heroin tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotin, sepse ati Gjon dhe vëllai Reposh u serbizuan dhe varret i kanë në Hilander të Athosit. (f.272, f.306)

Si lanë një besë e morë një tjetër? "Ndëjei ata, sepse nukë dinë seç bënëjënë." (f.274) Ky raport i vështirë mbyllet me grotesk, serbët e kanë devijuar lutjen e famshme të të krishterëve: "Kosovën që na takon jepna sot e na çliro nga shiptari, më i ligu i të ligjve." (f.300) Si në një ndeshje sportive, ku dy skuadrat kanë tifozët e tyre, edhe këtu ndodh njëllë: anglezja Matilda Bolton (kujto Edith Durhamin) dhe irlandezja Flora Royan, "njëra është e marrosur pas shqiptarëve, tjetra të hidhet në fyt për serbët." (f.216) Matilda, edhe pse mungon fizikisht në roman, është e pranishme fund e krye veprës. "Shqiptarët iu fanepsën në jetën e vet në një kohë që ajo jetë ishte në pikën më të ulët, e zbrazët, e mjerë, plot zhgënjime. Ata ishin dega ku ajo u kap për të shpëtuar veten." (f.230)

Dashurinë e deklaruar më parë te libri "Unë jam gegë" autori e rikonfirmon edhe këtu duke veçuar format arkaikë të jetës që u ruajtën më mirë në Gegëri dhe i ilustron me shprehjet: 'për këtë dhe', 'për këtë bukë', 'për këtë gur'. (f.38) "Armët janë për gegët. Për toskët janë librat. (f.92-93) Konvertimi



fetar i shqiptarëve në myslimanë u bë për të fituar status, pasuri, jetesë të kollajtë, por ka dhe një konvertim kulturor që lidhet me kulturën që të pëlqen. (f.103-104) Kur flasim për organizimin kombëtar të shqiptarëve duhet të mbajmë parasysh se masa më e madhe e ortodoksëve ishin grekofonë ose grekofilë. Myslimanët ndiheshin turq dhe donin shkronjat arabe se ishte gjuha e Kuranit. Ajka e vendit që shkonin pas qerreve të të huajve (f.128) dhe nuk e kishin për gjë as të shiteshin e të bliheshin, as të kacafyteshin me sho-shoqin për pak ndikim, status a pushtet. (f.129) Nuk kishin ideale, ose i shisnin si xhingla-mingla. Ishin të gjithë të korruptuar ose të korruptueshëm. (f.132) Edhe vetë të krishterët shqiptarë ishin ndarë me dy kisha, katolike dhe ortodokse dhe, kur u zgjuan në mes të shekullit XIX, nuk e dinin çfarë ishin. (f.302-303) Pasi krahason katolikët e Shkodrës me myslimanët dhe ortodoksët e Toskërisë (f.59 – 60), vjen ngritja në pedestal: "Po qe se katolikët nuk do të ekzistonin, as vetë shqiptarët nuk do të kujtoheshin se ishin një komb." Kështu, krejt natyrshëm, vjen mesazhi i parë i veprës: "Duhet të kthehemi në fenë e të parëve. Me pahir." (f.61)


Konstatimi i dytë: shqiptarët kishin admirim bestyt te Perëndimi. (f.68)

Që në pjesën e parë paraqiten dy alfabetet që do jenë thelbi i punës së kongresit: Alfabeti latin i shqipes do të ishte i pari për një komb pjesërisht mysliman, por kishte një pengesë të çuditshme ekonomike: gërmat dyshe të alfabetit latin zinin një të pestën e tekstit çka nënkuptonte që një vepër kërkonte më shumë faqe se sa po të shtypej me alfabetin shqip të Stambollit, domethënë kosto më të lartë botimi. (f.71)

Mesazhi i dytë dhe më i rëndësishme që lidhet me alfabetin, vjen në pjesën e dytë: "Nuk kemi ardhur të fitojmë unë e ti kemi ardhur të fitojmë të gjithë. Nëse nuk fitojmë të gjithë, askush nuk ka fituar." (f.91)

Pjesa e parë mbyllet me një diskutim fetar e filozofik për vdekjen, kurse pjesa e dytë, sikurse u përmend më sipër, rifillon si narrativë nga stacioni i trenit për të hedhur dritë mbi karakterin e dytë – Grigor Toska, që portretizohet si atdhetari i orientuar drejt progresit. Në antitezë me të dhe me popullin, shfaqen etërit tekanjozë të kombit: nga njëra anë Bato Kosina i cili nuk do të vinte në kongres, po të mos zgjidhej kryetar. (f.65) nga ana tjetër Adam Kosturi (nënkupto Faik Konica) që, siç do ta tregoj më poshtë, njoftohet me vonesë që të mos mundë të marrë pjesë, që të mos bëheshin dy gjela majë plehut.

Para se të lexoja romanin, isha njohur me sfidën e Faik Konicës për Kongresin e Manastirit dhe nuk është vështirë të zbulohet qejfmbetje nga që një ftesë e dërguar me vonesë është mënjanim nga diskutimet e atjeshme. "Ku u dëgjua që një kongres letrar të jetë si një kurvëto: Kush të dojë le të vijë! Nuk ka këtu njerë të xgjedhur me arësye dhe të ftuar, s'ka



një progamë pune...” (Vepra 4, Dudaj 2001, f.161) Mohimi i tij shkon në ekstrem kur shkruan: “...përparimi i Shqipërisë është lidhur në mos të njohur të këtij kongresi.” (po aty, f.162) Në vazhden e këtij qëndrimi, në letrën e datës 9 nëntor 1908 ai qëndron i palëkundur në qëndrimin e vet: “Një kongres për abenë do të mblidhet, mos kini frikë. Po “the right Congress, by the right men, in the right ime, at the right place.” (po aty, f.165)

Në kapitullin e veçantë që pason dy pjesët e para përmenden nominalisht edhe ata që s’morën pjesë në Kongresin e Manastirit përveç Konicës: Noli, Asdreni, Koleja, Vruhu, (f.151) por identifikohet onturazhi i Bato Kosinës si për të mbështetur qëndrimin e Adam Kosturit: Mane Polena që më shumë bërtiste se sa fliste, Kukudhi (Rrumaduci), T’ëmën e s’ëmës, ata dy që u mbaron emri me “o” (Shasho e Kajo).

Vlen të veçohet paralajmërimi i falltares Meme për konsullin rus: “Zoti konsull, shqiptari i egër ta ha mutin, por shqiptari i butë ta ha kokën.” (f.97) Vrasja ndodhi dhe më vjen mirë që autori ka identifikuar emrin e shqiptarit, ai ishte Halim Bleta nga Bitincka dhe një studiues nga shqiptarët e Maqedonisë, erdhi posaçërisht nga Turqia për ta konfirmuar ngjarjen, madje gjeti edhe një këngë kushtuar njeriut që nuk e përtypi fyerjen e konsullit.

Autori çel një dritare për të hedhur një sy në kopshtin filozofik ku gjen turmën dhe pafuqinë e njeriut për t’iu kundërvënë asaj, (f.101) nga ana tjetër mohimi nuk është absolut sepse sjell Ibsenin dhe “Armikun i popullit” me idenë e kundërt se edhe një i vetëm mund t’i kundërvijë turmës. (f.103)

Duke treguar interesimin e Foti Ostrecit për gjuhën shqipe, autori hap një trinë në fushën gjuhësisë duke folur për gërmat, kombin dhe Kuranin (f.107) dhe e ilustron me fjalorin që kishte hartuar me fjalë shqipe duke zëvendësuar ato turke: anësi – tarafilëk, lajm – haber, arsye – hak, vleftë – kimet, ngjyrë – bojë, dobi – qar, e metë – kusur, e zbrazët – bosh, theror – kurban. Deklarohet pëlqyeshmëria e tij për një alfabet latin pa shenja diakritike, njëkohësisht të ruheshin dyshkronjëshet gj, nj, rr, ll për të ruajtur traditën e shkrimtarëve katolikë, sepse “gjuha nuk është vetëm thjeshtësi dhe ekonomi, por edhe emocion, histori, traditë.” (f.116-17)

Martesa e parë e Grigorit me një serbe që u sëmur dhe u largua, është ekzemplar i vetëm, por kaq mjafton për të shkruar te deklarimi: “Një arnaut e një shkja nuk mund të rrojnë nën një tra. (f.121-122) Në antitezë me të është Nusha – nusja gege nga Malësia e Madhe, femra mendjhapur që pasohet nga deklarimi i nënës Frosinë: “Vdekjen e dija, po që gega të bëhej toskë kaq shpejt, nuk e dija.” (f.123)

Pjesa e dytë mbyllet me sfidën ndaj tabusë mbi fjalët e seksit. Kënga e Bregut të Lumit (f.141-44), e kënduar nga Mane Polena dhe e shoqëruar nga burrat e çartallosur, i paraprin sfidës tjetër me përmasa më të mëdha te romani “Ngjizja e papërlyeme” e Agron Tufës. Ja vlerësimi befasues: “Mane Polenën e mora zët për shkak se ishte gojëprishur dhe ja tani, po për shkak të fjalëve të pista që nxirrte nga goja, më hyri në zemër.” (f.158)

*

Pas dy pjesëve të para, vjen kapitulli kapriçioz “E shtunë, dita e parë e vjeshtës së tretë” ku sfidanti Muç Nano, shkruan sipas alfabetit të propozuar nga Grigor Toska ku janë bërë zëvendësimet “ë” me “ə”, “gj” me “gh”, “nj” me “nh”, “ç” me “ch”.

Vështirësive të organizimit të kongresit, u shtohet edhe karakterizimi si kongres i qylafëve dhe mustaqeve, (f.146) pastaj vjen shpërthimi kundër Lidhjes Shqiptare të

Prizrenit e cila hapi një shteg ku qëllimet nuk ishin mëmëdhettare, por, fatmirësisht u korrektova me pasojat. Ka ca të dhëna që nuk janë thënë ose sikur janë harruar të thuhën: Nuk pati orthodoksë, nuk pati as toskë, përveç Abdyl Frashërit. (f.147)

Paragrafë plot dritë janë ata që portretizojnë Ado Benën – gruan shqiptare të civilizuar, të parën grua që del zbuluar para burrave, të vetmen grua që dinte të shkruante shqip, të parën grua që merr pjesë në jetën publike. (f.154-55)

Pjesa e tretë “Në ditën e “Shën Fredit” autori rimerr problemet e gjuhësisë: Roberti mban shënim emrat e disa ushqimeve në gjuhën shqipe duke i transkriptuar: sopher, pastirmà, pourshesh, japrack, boureck, petoulla (f.164) dhe krijohet një mjedis pozitiv ku është pikërisht vendi ku zbulon misionin e shkrimtarit si mësues i lexuesve për një përdorim të bukur të gjuhës amëtare, (f.165) që shqiptarët të shpalosen para botës me atë gjatësi vale si folës të shkëqyer të gjuhëve të huaja. (f.167) Pas disa tezave të shtruar për debat, gjuhësia kthehet me rrethanorët e kohës në marrëdhëniet e punës: pastaj, qëparë, më vonë, paradite, padite, nesër. (f.180)

Nëpërmjet portretizimit të murgut Foti Ostreci autori shfrytëzon mundësinë për t’u shprehur pozitivisht për krishtërimin që ka rëndësi si traditë, histori, qytetërim e jo si logos, si një e mirë e pazëvendësueshme për njerëzimin. Prej aty ngrihet në një lartësi të re qiellore, te Zoti si një tërësi ritualesh, rrëfimesh, fabulash, urdhërimesh, rregullash e normash etiko-morale të cilave njeriu duhej t’u bindej, ndryshe njerëzimi do të humbte drejtpeshimin. (f.173) Duke folur për kanakarët e Zotit, si vdekatarë të zakonshëm: Moisiu bari, Jezusi zdrukthëtar, Muhameti bari e karvanar, (f.253) autori duket sikur guxon shumë për t’u futur në ca katakombe nga mund të shpërthejnë blasfemitë. Përflitet edhe profeti që mbante 13 gra, më e vogla 9 vjeç. (f.275) Raporti mes pushtetit dhe fesë te krishtërimi tregohet me shprehjen e Jezu Krishtit: “Paguani dhe ato që janë të Qesaritë, nde Qesari, e ato që janë të Perëndisë, nde Perëndija.” (f.278) Kjo nuk thuhet në Kuran ku pushteti dhe feja shkrihen në një. (f.279) Në islam hyn e s’del dot. (f.281) Shkrimtari autorizon personazhet e tij të gjykojnë për preferencat e Zotit, marrëdhëniet me

njerëz me shpirt e zemër të kristaltë dhe jo me mendjet e mëdha, sepse donte të pushtonte shpirtin, jo mendjet e njerëzve. (f.255) Autori e vuan atë që ndodhi me ne shqiptarët - myslimanë në vendin e gabuar, në mes të të krishterëve. (f.171-72) Kurse serbët, ndryshe nga shqiptarët, me të cilët duket sikur janë të një biçimi, kanë një histori të krishterë pas shpine. f.230)

Murgu Foti i jep mundësi autorit që ta shohë kolonializmin si një gjë të mirë, sepse pas tij zbulon kombet e përparuara që u bëhen krah kombeve të prapambetura. Kombet e vegjël kanë nevojë të vihen nën kontrollin e të mëdhenjve (f.176) dhe kjo gjë, për ko incidencë, duket sikur ilustron me qëndrimin e sotëm të qeverisë Kurti në konfliktin me Serbinë. Po këtu mund të shtohet problemi i qeverisjes. “Doket, ojtinitë, qytetërimi në përgjithësi nuk janë lesh e mëndafsh që eksportohen. Modeli i qeverisjes duhet ta marrë legjitimitetin nga traditat, zakonet e mendësitë lokale.” (f.179) Duke diskutuar për kolonializmin, mund të bëjmë një degëzim pyetës: A rrinë dot shqiptarët pa pushtues mbi kokë? Bato Kosina ka një përgjigje që tingëllon aktuale: “Në vend të osmanëve do kesh një fuqi tjetër mbi kokë.” (f.199)

Vizita e Robertit në shtëpinë e falltares Meme i jep mundësi të tregojë vlerat e veta si piktor dhe të realizojë portretin e saj: “Prej qafës e poshtë ishte e veshur e tëra në të zeza, por në kokë mbante një shami të bardhë. Rrinte pak e përkulur, duke nxjerrë në pah gungën e shpinës, dhe mbështetej mbi një bastun. Mbante një palë syze me xhama të mëdhenj, njëri prej të cilëve kishte marrë një të krisur të lehtë në anën e sipërme. Rrudhat i kishin pushtuar gjithë fytyrën, duke zbritur deri poshtë te mjekra ku i kishin dalë edhe qime. I përngjante, besa, një shtrige.” (f.182)

*

Pjesa e katërt “Prej manastirit në Manastir” është pjesa përmbyllëse e cila duhet të sigurojë gjithë dyert dhe dritaret para se të niset me pushime. Murgu Foti Ostreci është me origjinë arumune nga i ati dhe këtu autori gjen rastin të nënvizojë se rumunët shkonin mirë me të gjithë, por me shqiptarët shkonin shumë më mirë. (f.251) Robertit piktor i takon të deklarohet si profesionist dhe ai bën krahasimin e pikturave europiane që të trazojnë me

bukurinë, dhe atyre bizantine që janë të thjeshta e të japin paqe e qetësi në shpirt. (f.258) Arsyetimi shkon më tej me konstatimin se njerëzit janë zemërgjerë e kanë mirëkuptim për krijimet e së shkuarës, por janë të pafuqishëm për t’u bërë një me të ardhmen e për të kuptuar veprat e saj. Pra nuk ka një shije universale. (f.261)

Leksioni për gjuhësinë vazhdon me traditën e vënies së emrave të njerëzve në Shqipëri dhe merr ngarkesë shkencore kur përpiket të hedhë dritë mbi etnonimin “shqiptar” (f.264), trajta e shkruar e të cilit nga të huajt shfaqet larushore: schipetars, schkipetares, skipatars, shkypetares, shkipetars, skipetars, schipettari. (f.265). Hidhet një vështrim gjuhësor për fjalën rrënjë, momentin zero, modifikimin dhe evoluimin e aparatit të të folurit, shqiptimin e fjalës së parë. (f.285-87) Jepet dhe një segment kohor i zbulimit të etnonimit, vitin 1741, (f.266) flitet për dokumenta të zhdukura (f.268) sepse pas reklamimit të vrasjes së Fred Potterit për çështje nderi, fshihet thelbi politik që Ndre Mjeda, një nga delegatët me emër real, deklaroi se Kongresi ashtu si Rozafati, e mori flinë e vet, (f.234) çka nënkupton se ai kishte dijeni për dokumenta të rëndësishme që lidheshin me gjuhën shqipe dhe historinë e shqiptarëve.

Kapitulli “E dielë, dita e tetë, e vjeshtës së tretë” i rikthehet vështrimit gjuhësor me ngritjen në normë të alfabetit latin duke i bërë lëshim alfabetit të Stambollit te shkronjë “ç” dhe një nderim arbëreshëve te shkronjën “ë”. (f.325) Intriga e vrasjes dyshohet se i ishte besuar një shqiptari pa atdhe nga Janina, për t’i qëndruar idesë se kombit shqiptar shumë të këqia i kanë ardhur nga brenda. (f.326)

Romani ul siparin me versionin përfundimtar të vizitës së Robertit. “Kish erdhur atyre anëvet i nxiturë nga një tekë në një moment të pikëlluarë, dhe e gjitha i ishte kthyejturë në një rysni të madhe.” Pastaj, me të vënë këmbë në dheun e Arbrit, vetëm në harkun kohor të një jave, bën deklarinimin prekës që vazhdojmë ta dëgjojmë edhe sot nga sa e sa udhëtarë të huaj: “Unë kurrë nuk do ta harronj këtë udhëtim, është më i bukur i jetës sime.” (f.331)

Durrës, 8 – 12 qershor 2023



1

Jo një vend për idealistë

Ndodhi që, ndonëse e kapluar nga paqja e një mëngjesi të diele, e përpara kekut të mamit, mendimi i një shkrimi të pambaruar si një insekt ma pickoi trurin aq shumë, saqë fundshpina ime, së bashku me gjymtyrët e poshtme, u hodhën përpjetë.

Marr pjatën e kekut në dorë dhe fluturoj drejt tryezës së punës. Hap kompjuterin ndërsa ngul pirunin në kekun me mjaltë, aroma e të cilit të çante hundën më shumë se zakonisht. Ekrani i kompjuterit përndizet duke hapur një dokument në Word të cilin kisha nisur ta shkruaj para disa ditësh dhe që, me sa duket, nuk paskam mundur ta mbaroj – ndoshta sepse titulli qe “Jo një vend për idealistë”.

Ngul sytë mendueshëm në ekran ndërsa përtyp me ëndje një llokmë të madhe keku, që sot ishte tepër, po tepër, e mjaltosur. Sido që të jetë, unë do ta haja me shumë dëshirë, sot e përgjithmonë, sepse është keku i mamit.

E vetëdijshme se ai nuk është keku më i mirë në botë dhe se verdikti im është turbulluar prej relativizmit subjektiv, nisa të shkruaj e velur në mjaltë se sa shpesh, të ndodhur në pragu e brishtë të relativizmit subjektiv, kemi belbëzuar në një gjuhë të paqartë mendime për njerëz idealë, për historira dhe vende të përkryera.

Sa e sa herë kemi gënjer për kujtimet tona, edhe pse dhembjen ua ndiejmë akoma.

Vazhdoja të haja kekun e mjaltosur të mamit, duke besuar fort se, ndërsa realiteti ka mënyrat e veta për të na shkundur, ne duhet të kapemi fort te relativizmi subjektiv, si i vetmi mekanizëm shpëtimi në një botë joideale.

Edhe të gjithë ata, të tjerët, që besojnë në botën ideale, thellë-thellë e dinë që çka

SË SHPEJTI NGA ONUFRI

SHËNIME MINIMALE

nga MERI DISHNICA

është ideale në letër, shpesh nuk është më e mira në praktikë; nga ana tjetër, ajo që thjesht funksionon në praktikë, nuk do të thotë se është ideale, madje as e justifikueshme.

Madje mund të thuhet se janë sistemet e idealistëve ato që kanë shkaktuar shumë nga problemet më të mëdha të njerëzimit, jo sepse këto të fundit janë më pak virtuozë, por sepse perspektiva bardhezi e absolutizmit nuk di të luajë mirë me zonat gri të natyrës njerëzore.

Edhe më virtuozët ndër virtuozë, kanë një histori gri gjatë karrierës së tyre.

2

A është inteligjenca një mallkim?

Ndoshta ky titull ngjan i çuditshëm, po naq sa e çuditshme dhe e pakuptimtë u duket kjo botë njerëzve të zgjuar – e thënë ndryshe, “Të kesh dy pare mend” je i damkosur të mos jesh kurrë i lumtur.

Sa herë mes nesh kemi thënë se ai që nuk e vë trurin në punë fle i qetë si qengj, ndërsa ai “inteligjenti” përpëlitet netëve, i pagjumë, sepse shpata e tij e analizës vendos në dyshim gjithçka – për këtë arsye shumë shpesh humb në skuta konkluzionesh shpirtshteruese.

Sa më i zgjuar të jesh, aq më shumë “antena” do të ngresh dhe sa më shumë

*antena të mbash ngritur,
aq më shumë sinjale do të kapësh.
Më shumë sinjale do të thotë më shumë të
panjohura,
më shumë të panjohura do të thotë më
shumë nxitje që t'i zgjidhësh e meqë zgjidhja
nuk është gjithmonë në dorën tonë, ajo që
na mbetet është thjesht vuajtja!*

Njerëzit mendimtarë vuajnë më shumë sesa të tjerët, sepse ata nuk dinë të mos mendojnë – shumë shpesh ata mbyten në pellgjet e pambyllura të së shkuarës, janë tepër të ashpër me veten apo më keq, e kanë të vështirë të falin. Standardet e tyre të larta ua bëjnë tepër të vështirë marrjen e kënaqësive në rrugëtimin e tyre melodramatik drejt idealeve.

Mendimtarët e kanë të vështirë të marrin vendime, sepse shpresojnë si idiotë te perfeksioni që nuk ekziston.

Duke qenë se kanë pak linja kuptueshmërie me të tjerët, ata ndiejnë mungesën e një komunikimi të thellë dhe për këtë arsye gjenden mjaftueshëmrisht të keqkuptuar sa për të mbetur vetëm. Pothuajse si personazhi alegorik i “Mitit të shpellës së Platonit” i marrë, i pavend dhe i përbuzur.

Por a ka shpresë për mendimtarët?!

Duke qenë se bota është krijuar me mekanizma të nivelit mesatar, çelësi gjendet te hedonizmi magjik i përshtatjes. Njerëzit mendimtarë duhet të ushtrohen

(më shumë) që të njohin çastet kur u lejohet të luajnë “rolin e budallait”.

P. S: Edhe bukuria është një mallkim, thotë Theodor W. Adorno.

3

Përfitimet e të qenit fleksibël

Disa njerëz janë fleksibël, sepse ndryshojnë planet e darkës sa hap e mbyll sytë. Të tjerë shprehin fleksibilitet ndërsa bëjnë sparkatën dhe akrobaci të tjera. Disa janë fleksibël kur arrijnë të ndryshojnë bisedën në kohën e duhur. Disa ndërrojnë bisedë, pa ndryshuar mendim. Të tjerë nuk ndërrojnë as mendim dhe as bisedë. Dreq! Këta të fundit janë tmerrësisht të mërzitshëm.

Mund ta dallojmë një njeri jofleksibël që përtej, vetëm prej fytyrës së tij të ngrysur dhe gjithë tension. Ngaqë është i përqendruar më shumë në mbrojtje sesa në lojë, ai humb shumë prej magjive që sjell momenti.

Një njeri jofleksibël vetëkonsumohet sa herë që përballet me stimujt e rinj, sepse truri i tij i ngurtë i percepton këta stimuj si pengesa dhe jo si shtysë. Të paaftë për të pikasur dhe për të vjelë nga stimujt e rinj pjalmin motivues që do t'i bënte të përballeshin me të panjohurat në rrugë fisnike dhe kreative, shumica ikin të trembur.

Jeta është plot me ndryshime dhe ndonjëherë të duhet të ndalosh çfarë po bëje dhe të nisësh diçka tjetër – të duhet të ndryshosh kurs, ndoshta edhe mjetet. Të kesh aftësinë të jesh fleksibël edhe në kohët më të vështira është *crème de la crème* e qëndresës humane. Madje ka të dhëna shkencore që tregojnë se fleksibiliteti emocional ndihmon edhe shëndetin mendor, por pak rëndësi ka kjo tani – dëmi mund të jetë bërë.






Aleksandër Xhuvani
Konferenca I e LSH, Tiranë, 1945



Vangjush Mio, 1957



Muslim Mulliqi, Prishtinë 1971



Vaçe Zela, 1980

DHIMITËR S. SHUTERIQI: PORTRETE NË VITE

nga Feride Pappleka

Duke u njohur me portretet e Shuteriqit, e kupton se je duke hyrë në një tjetër univers të krijimtarisë së tij, të duket sikur ajri që të rrethon ka tjetër tejdukshmëri, se zhurmat për gjëra të kota pushojnë, se jeta ka aso përmasash që herë-herë kërkojnë përqendrim të thellë. Ato mbi të gjitha të kujtojnë se dashuria për njerëzit ishte gdhendur fort në mendjen dhe shpirtin e tij.

Unë pata fatin t'i gjeja këto portrete në gjallje të Shuteriqit, rastësisht duke kontrolluar dosjet e një rafti, kur isha duke mbledhur materiale për jetëshkrimin që po përgatisja. Atëherë njoftova drejtorin e atëhershëm të Galerisë së Arteve, zotin Dilo që kishte dijeni për këto vizatime, por nuk pati kushtet e duhura të kryente ndonjë veprimtari. Këtë gjë e realizoi pak më vonë zoti Qendro. U hap një ekspozitë, u bë edhe një fletëpalosje me një koment domethënës nga Dilo. Shuteriqi vetë as që i pati përmendur ndonjëherë në bisedat e tij vizatimet, sepse punët e tjera ishin aq të mëdha, sa hija e tyre mbulonte gjithçka që kishte karakter minor. Sidoqoftë unë kisha parë dytri punë me bojëra vaji, kujtim i kohës kur ishte në Rubik me qarkullim dhe e dija që në liceun francez të Korçës kishte qenë nxënës i Vangjush Mios. Por përballja me vizatimet më befasoi në kuptimin se ku e kishte gjetur kohën ai kolos i kulturës shqipe të krijonte edhe atë raport aq jetësor me artin e vizatimit.

Ka njëloj muzike të gëzuar që transmetohet, një histori që rrëfëhet në një mënyrë elegante duke i parë këto portrete. Është si një shëtitje e mrekullueshme mes qetësisë që i flet botës në heshtje dhe ushqen besimin se e bukura e ka tërhequr njeriun në të gjitha kohërat. Çdo portret është polisemik, i prekshëm, i hapur për ta interpretuar. Mbi të gjitha, portretet janë



të frymëzuara nga misteri i çastit. Ato arrijnë të futen në karakter, të shprehin identitetin dhe të transmetojnë te shikuesi disa cilësi bashkudhëtare të njeriut si : forca, zgjuarsia, dashuria për jetën, për natyrën, për punën, për dijen... Ato përbëjnë edhe një dokument të rëndësishëm për kohën kur janë krijuar.

Shuteriqi i ka dhënë disa përmasa veprës së tij që e ka lejuar të ndihet disa herë në jetë duke i zgjeruar kufijtë e ekzistencës me përkushtimin ndaj krijimtarisë letrare, shkencore, historike. Portreti është një kërkim i brendshëm, një frymë lirie për të ndërtuar një hapësirë të kulluar, një humanizëm për të cilin sot kemi nevojë më shumë se kurrë.

Portretet me laps, stilolaps, rapidograf, apo edhe me ndonjë mjet tjetër rrethor që pranon vizatimi, të realizuara shpejt e shpejt në pushime mbledhjesh a festivalesh si dhe në takime të thjeshta miqësore janë emocionuese, sepse në to mbizotëron në radhë të parë puna me dashuri, ndjenja e miqësisë. Duke qenë portrete të çastit, që vetëm artistët e vërtetë mund t'i realizojnë në një kohë tepër të shkurtër, ato janë shumë koherente në qasje, herë realiste dhe herë surrealist, me magjinë sublime që i rrethon krijimet origjinale.

Ai paraqet figura me të cilat, si të thuash « është mësuar », u ka zbuluar elementin e veçantë të shprehjes, u njeh përgjithësisht karakterin, por këtë gjë e ka arritur edhe me njerëz që nuk i ka « studiuar » ose njohur kurrë më parë.

Portretet e Shuteriqit, krijime të drejtpërdrejta, pa skica paraprake, të realizuara nganjëherë me një vijë eterike, janë dëshmi e talentit të tij dhe dëshmojnë edhe për një anë tjetër me dritë të personalitetit të tij të shumëfishtë.




Libri i Sefedin Çelës “Ku shkon pa dashuri”, tek ia ke Lthithur dhe avullin e germës së fundit, të duket si të jetë BOTA. Bota e vogël (apo mikrokozmosi) në botën e madhe (apo makrokozmosi), dhe e kundërta. Një botë që frymon diku, fillimisht në një fshat të quajtur Polenë, me 13 shtëpi gjithsej, rrokullisur fatit, luftërave dhe shekujve, “aq i vogël sa nuk e gjeje në asnjë hartë”, ku “sa shtohet një shtëpi shuhej një tjetër”, por ku, megjithatë, mishi i jetës ish i pnellshëm, i mbushur dëng me bëma e gjëma. Niset kjo “botë” nga ajo pikëz Shqipërie, tek ai fshat, në atë humbëtirë, te kërthiza e familjes, te njerëzit e shtrenjtë dhe më pas hapet e hapet... Prej atij fshati të vogël kacavjerrë bokërimave e maleve, me njerëzit e butë e të rreptë njëherazi, epik nga natyra, libri shkon më tutje në të tjera vise e njerëz, anë e mbanë Shqipërisë. Rrathë jete që vetëmbyllen dhe rrathë jete që hapen, shndërrohen në shenja epoke. Ashtu pabëzaj, nga punët e vogla, imtësitë, rëndomtësitë dhe gjëzat që mbushin orët, ditët, rrëfimet e Sefedin Çelës shkojmë tek e madhja, te politika, te shteti, te vetë epoka dhe puna e brezave për ta bërë Shqipërinë, paçka se e varfër, paçka se e ngjuar dhe në një kohë të rreptë plot kufizime. Pena e tij rrjedh, lë mbi letër “mellandin” e kujtesës së fshatit, të familjes; lë fatin e çuditshëm të njerëzve, ku krejt një jetë përmbledhet në pak fjalë e fjali, por ku drita që del syresh të godet, ndonjëherë, aq fort sa sikur të verbon. Sepse rrëfimi i gazetarit dhe shkrimtarit është sa karakterizues për njerëz të veçantë, aq dhe përvijues për krejt një jetë, një përvojë, një histori.

Është letërsi apo gazetari? Është libër me kujtime, memorialistikë apo libër me rrëfime? E ç’rëndësi ka kjo. Rëndësi ka shpirti që lëviz aty. Bukuria e tij. Thjeshtësia. Dhe mendimi. Idetë. Rrekja drejt filozofimit. Të kuptosh: çfarë, si, pse? Më duhet ta them se Sefedini ka një penë që pikturon mbi cohën e jetës, si të thuash, si me penelin surrealist, ku e besueshmja dhe e pabesueshmja, huqi dhe virtyti, paradoksalja dhe e njëmendëta bëhen një, bëhen karakter e bulb, bëhen fantazi e realitet. Gishta të një grushti. Në fakt ato që thuhën nuk janë fantazi, por të vërteta. Kjo dallon enkas në kapitullin e parë “Gurët e shtëpisë”, ku muguje të fëmijërisë kanë sipër një ylber, si te çdo fëmijëri. Mjeshtëria është ta thuash bukur. Dhe Sefedini e thotë bukur. Te fshati i vockël ku ai lindi, mbetur jetim në bark të nënës, me babanë që kish dalë partizan e ish ligështuar nga shëndeti befas, mbeti si ajo guacka e kërmillit bartur mbi kurriz e vite, me bëma e njerëz, me histori mallëngjyese e të jashtëzakonshme, sa groteske aq dhe tragjike. Mall e dashuri për ta. Për vetveten. Po, libri i Sefedinit është mall e dashuri për të tjerët, për njerëzit e tij, gjirinë, njerëz të tjerë përbri, miq e shokë të shumtë. Mall e dashuri për “Babain e shtëpisë”, Qamilin, me huqet e tij sa dhe me mendjemprehtësinë e ngjashmërinë e habitshme me bëmat e plakut Melehev te romani “Doni i qetë” i Shollohovit, tek u bie gardheve me sëpatë. Dhe pastaj përshkrimi mallëngjyes i mushkës së shtëpisë, si të ishte një “frymë” prej atyre mureve, e urtë dhe e palodhur në punë e mundime, dhe për ta shpëtuar nga mjerimi, ku e kishin katandisur “ata të shtetit”, plaku i shtëpisë e vrau me dorën e vet për ta shpëtuar dhe e varrosi diku, ku asnjëri nuk e mori vesh. Po qeni i shtëpisë, “Buzoja”, me gjithë historinë e tij, a nuk është një portret mallëngjyes fantast, si imazhet e surrealistëve?! Prandaj them se pena e Sefedinit, sidomos tek kapitulli i parë, ka diçka nga surrealistët, a proza e Turgenievit, e Çehovit, e Markesit, a s’e di kujt tjetri! Por, ama, të thith!...

Dua t’ju kujtoj pakëz “Nëna ime. Babai im. Vetmohimi”. Është e gjitha një elegji dashurie. Dashuri e burrit për gruan dhe e gruas për burrin, e nënës për birin dhe e birit për nënën. Dashuri për jetën, që edhe pse fryn, shkundullon e zezona sjell, e bukur mbetet gjithsesi. Si një lot i madh, si breshër e plumb i shkrirë mbi cep të syrit, tek rrëshqet hullive të faqeve, dhe përvëlimin e shpirtit nga hallet dhe qëndresa, na rrëfen. Ja, fjalë të tilla “poetike” unë do doja të thoshja për gjithë atë elegji, të shkruar me aq përmallje nga një penë që di se si ta grumbullojë në një pikë loti krejt një jetë - jetën e nënës dhe babait të vet, dashurinë e tyre të heshtur e të madhe, thjeshtësinë dhe trimërinë prej njerëzish, që të prekin për fatin e tyre gjer në kockë. Teksa e lexoja këtë rrëfim, aq shumë u preka sa e pashë syrin tim të mbushur njësoj si nëna e Sefedinit për të shoqin fisnik e fatkeq. Sepse nënat dhe baballarët tanë kanë qenë vërtet të madhërishtëm në stërmundimin e tyre për të mbajtur fort e drejt “kulmin e shtëpisë”.


S. Çela, në rrëfimet e tij më të ndjera, i mbledh ngjarjet dhe i ngjesh fort, aty ku fati, fatkeqësia dhe mirësia bëhen bashkë si në një trekëndësh, ku shpirti i njeriut lëshon dritë në të vërtetat dhe thjeshtësinë e tij. Nusja, që pasi i shoqi i heq duvakun, e sheh atë në sy duke e “thyer zakonin”; nusja që qan fshehurazi sepse ndjen dorën dhe shpirtin e tij të butë që “kujdesej për të”; vjehrra që i thotë nuses “bir”, sepse i vetmi bir i saj iu shua; djali që mban emrin e babait (Sefedin Sefedin Çela), si ringjallja e gjakut të shtëpisë, që e ëma kërkon ta bëjë me shkollë të “shikojë e të kuptojë”; një thelë mishi e hequr nga goja e nënës dhe si “tinëz” e hedhur



në pjatën e birit apo nipave, që ata të kenë jetë e shëndet - gjest dashurie që vetëm nënat dinë ta bëjnë; dhe ai rrëfim i mrekullueshëm i nënës te djali i vogël në klasë të parë, që t’i ngulet në mendje fytyra e të atit, të cilin ai nuk e kishte parë se ishte ende në bark të saj. Një rrëfim i shkurtër sa një roman, sa një jetë...

Në kapitujt e tjerë të librit proza e Sefedinit bëhet më e menduar, diku ka qejf edhe të filozofojë për kohën para viteve '90, duke ia hequr nga fytyra baltën e hedhur pa të keq, me cinizëm, nga mendjefyll e bastardë kapadainj që koha e re solli, sharlatanë e sarhosh të shumtë politikë. “Ne ishim një brez që nuk u bëmë bisht detyrave. Vumë nga një tullë e nuk hoqëm tulla. Atdheu nuk është ideologji, nuk është fe, është besim: të punosh për të është besim e akt moral, është dhe mison.” Dhe më tej ai sjell një tjetër të vërtetë, jo vetëm e tij: “Jeta të çon të vraposh pas erës. Si në një maratonë, si të ecësh në shi, të marrësh pjesë, të lagesh e të mbrohesh, të mbërrish në fund. Edhe nëse nuk mbërrin i pari, s’ke pse qahesh, mjafton të marrësh pjesë...”

Dhe kur retë mblidhen, qielli nxihet krejt dhe rrebeshi të bie shpinës, të qull e të ngrin, si dikur Mbreti Lir i Shekspir, ti ulërin si një bishë: “Zot, ku je?”; ose si një njeri i humbur përfare: “Jetë, ç’më bëre?” Por ti duhet të mbahesh, mos e humb pusullën, o njeri! Rrebeshi do të pushojë dhe qielli i mendjes do të hapet. Atëherë thirrre vetveten brenda vetes, thirrre besimin, shpresën. Ja, një mori rrëfimesh të tilla vijnë e mblidhen në kapitullin “Majtas, lart, ku kam zemrën”, për t’ia lënë vendin kapitullit pasues “Të shohësh brenda vetes”, ku tanimë lexuesi përthithet nga përsiatjet për jetën dhe vdekjen, njeriun, kohën, sistemin shoqëror, të djeshmen dhe të sotmen, rininë dhe pleqërinë. Sepse: “Të duash është besim, është guxim, është sakrificë... Duhej ajo dorë miku për t’u ringritur! Jeta nuk është një vijë lineare, një tërësi pikash. Shpesh është një përrua i rrëmbyer me kthesa e gjeratore...” Ja, kështu! Në rrëfimin “Ku po shkon pa dashuri” pika e Arkimedit në jetë është pikërisht dashuria. Dashuria e tjetrit për ty dhe dashuria e jotja për tjetrin. Dashuria që ngjall. Dashuria që mund vetminë, mërzinë, dëshpërimin. Dashuria që i thotë dhe rithotë zemrës së munduar: Jeto! I lodhur, i kapitur, i përhumur nga vdekja e të shoqes, si një sonambul në hapësirat e zbrazta të mureve të shtëpisë,



atje në katin e gjashtë, njeriu-Sefedin ndonjëherë e humbet edhe vetë sensin e hapësirës, kohës, të vetë qenësisë, dhe në zbrazti kërkon një dorë që t’i zgjatet, ta nxjerrë nga përhumbla, terri, siç qe për të dora e mikut të shtrenjtë, gazetarit të njohur, Arshin Xhezos, apo e njeriut të thjeshtë Behar. Zemrat e lakuara, siç thoshte Kamy apo zemrat e thyera, siç thotë Sefedin Çela, them se njësoj janë, zemra që dashurojnë, që vuajnë, që durojnë dhimbjet e fatit, siç me aq vërtetësi na rrëfen dhe ai te ky libër-historizë e jetës së vet, sa dhe e brezit të tij...

“Gjërat e vogla” ku jeta frymon, mëvetësohet, thotë se “thelbi im është ky përjetim, i sotmi, i këtij çasti, i kësaj gjëzës në dukje pa rëndësi, por ku je fshehur ti e ti shfaqesh, vetjakësohesh”. Te gjërat e vogla është njeriu, jo te kapardisja, mburrjet, fryrjet prej gjeli; është edhe te raportimi me një maçok, si esetë e mrekullueshme të Çapajev Gjokutës, ku përtej tij ti sheh rrathë të tjerë, si rrathët sokratianë; është dhe te thyerja e një pjate apo djegia e gjellës, është te një këmishë e varur harruar pa u hekurosur. Është te shpirti. Te përditësia. Te heshtja. Te e zakonta. Është te aventura studentore pyjeve të Pukës me Moikom Zeqon, këtë mik të shtrenjtë timin, të Sefedinit e të mijëra të tjerëve, që ia lexuam mendjen. Është te një trumb djelmoshash që pasi mbaronin universitetin, shkonin e derdhnin mund fshatrave, larg shtëpive të tyre, dashuruar pas punës; është te një histori arxhinjsh, ku jeta e shpenguar sa dhe dashuria krijojnë thuajse një poemë njerëzore, si te tregimi i mrekullueshëm “Një arixhi, një arixhofkë dhe kali i vrarë”. Ata, njerëzit e thjeshtë në librin e Sefedinit, “nuk kanë zënë topin nga gryka si Mic Sokoli, nuk kanë vlarë bimbashin si Çerçiz Topulli, nuk kanë hedhur gunën mbi tela si Selam Musai e për ta nuk ka këngë”. Por ata janë vetë “kënga e jetës”, kapedanët e saj, siç qe mësuese Ksanthipi, me shpirtin prej nëne; ose Ahmet Osja, Todo Gjermani, Bashkim Koçi, që dinin të “bisedonin” me dheun dhe pemët. Një grua e rëndomtë ishte Qamile Dervishi, daktilografistja e gazetës “Bashkimi”, e quajtur me shaka “Dy-pëllëbë-grua-një-mbi-një”, vjehrra e këngëtares së njohur të operës Mariana Leka dhe motra e mjekut Isuf Kalo, por nga pena e autorit kullon gjithkund simpatia e dashuria.

E pra, ky zbulim i bukur i shpirtit njerëzor në prozën e Sefedinit shpreh e buron jetë. Por dhe filozofi. Një filozofi jo përmes termash, nocionesh, abstraksionesh e akrobacish mendore që lakmon paradokset e çudat, përkundrazi që na çon pa zhurmë tek ajo që e kemi çdo ditë nëpër këmbë, në ajër, në heshtjet dhe vetminë tonë, në ekzistencën tonë, te njerëzit bri nesh, në bisedën me vetveten dhe te mënyra se si ne jetojmë e frymojmë. Epo kjo do të thotë të ndjesh e të kuptosh të vërtetën, të zbulosh qenien njerëzore përmes qenies tënde, sado e “vockël” dhe e “parëndësishme” të të duket së jashtmi. Prozat e personalizuara të Sefedinit të çojnë si pa kuptuar pikërisht në burimet e mëdha të kuptimit të jetës. Dhe këtë ai e bën shumëkrah e në shumëçka, e bën me marrëdhëniet me babanë, nënën, djemtë, nuset, motrën, mbesat, nipin, shokët, miqtë...

Sefedin Çela, përherë kam pasur respekt për mendjen dhe karakterin tënd! Por tani që ta lexova më thellë shpirtin, m’u bëre më tepër mik. M’u duk sikur te libri yt hapa një shpirt. E lexova atë. U mallëngjeva. Sikur isha dhe unë aty. Me ty bashkë. Dhe kur lexuesi është “aty”, te gerrat e tua, dije prej meje se letërsia fluturon si ajo mëllenja ullinjve, por dhe si grifsha e bukur, siç thua ti, edhe pse zërin e ka të shpifur dhe mishi nuk i ahahet. Se e bukura dhe e shëmtuara bashkë janë në këtë jallane jetë. Libri yt, Sefedin, është si një fletore kujtimesh të ëmbla e të trishta njëherit, fletore loti e malli për njerëzit e ikur, që ti i ke dashur sa vetë shpirti i njeriut do: njerëz të familjes, miq për kokë, fytyra të ardhura nga kohët e mëparshme, emra që kanë bërë ferk në jetë. Pena jote i ka ngjyer portretet dhe bëmat njerëzore edhe me ndoca akuarele të shndritshme, që mendja e gjorë në vitet e mbrame ka qejf t’i qëndisë e, diku-diku, edhe ndonjë pikëz loti ta derdh në heshtje. Këtë mbresë ta japin edhe ato çka ti na rrëfen për njerëz që ne i kemi njohur a kemi dëgjuar për ta, si soprania jonë e famshme, Ermonela Jaho, e lindur tok me këngën si gjinkallat. Dhe në kapitullin e fundit, nga tregimet e “jetës” tënde, kalohet ne tregimet letrare të mirëfillta. Edhe pse fiction, ato po njësoj duken si ato çka ke treguar me ndjenjë gjithandej. Përpos tregimit për arixhiun Harram, mua më la shijen e një letërsie që e mban fshehtësinë e një jete, dashurinë, si molusku rubinin, posaçërisht te tregimi “Siera”.

“Dëgjo mirë kur kuptoj mirë, - thua ti. - dëgjo edhe më mirë, kur ndjej mirë...”

Po, miku ynë Sefedin, ti “ndjen mirë”. Ky mendim i yti është për mua si pjalmi luleve, që mbars e pllenon frytin e ideve të shpërndara tej e tej rrëfimeve të librit tënd. Autori aty dëgjon, kupton dhe ndjen frymën e njerëzve me të cilët u rrit, të kohës dhe “shtëpisë së tij”, të Shqipërisë sonë ku ai ka jetuar, të vendit dhe kombit të cilit i përket.

Sefedin Çela, pash jetën time në jetën tënde. Të përshëndes!

LUMTURIA

Tregime nga Ylli Pango



LUMTURIA - HOVET E ZEMRËS

(Tregim cinik, mbase i ngjarë)

Ajo ishte nga ato, që siç thoshte shoqja e saj e ngushtë, (vetëm ajo ia “vidhte”, të gjitha sekretet), “as vetes nuk ia tregonte tradhtitë që i bënte të shoqit”...Të shoqit i pat thënë se nja tri-katër orë do të bënte flokët...do të qe tek parukierja... Kish radhë... Ndërkohë e kish fiksuar më parë orarin. Shkoi e filloi menjëherë...Mbaroi me flokët e mori kohën që teproi... Shkoi tek i dashuri...

...Kreu me shije adulterin dhe po kthehej kur...rrugës i filloi zemra. Ishte kardiake. Itinerari i kthimit që po përshkonte s’qe ai parukieri-shtëpi. Po të rrëzohej (...vdiste...?) papritur nga ataku kardiak, i shoqi ndoshta do të dyshonte. Kur t’i thoshin ku e gjetën...

...Me zor arriti deri te fund-kryqëzimi i dy rrugëve. Po i quajmë, njërën “rruga e parukieres” dhe tjetrën ajo “e dashnorit”. Së andejmi vazhdohej për në shtëpi. Tamam aty edhe u rrëzua. Po i merrej fryma. Krah u mpi. Njerëzit-kalimtarë iu grumbulluan mbi kokë, për ta ndihmuar. Ishte vonë...

...Ia kish dalë. I shoqi nuk mund të dyshonte tashmë. Vdiq relativisht e lumtur. I ndodhi tamam aty ku duhej...në kreun e rrugës së shtëpisë. Kur t’i thoshin ku e gjetën, i shoqi përsëri, edhe këtë radhë, nuk do të merrte vesh gjë.

...Askush nuk e mori vesh pse i pushoi zemra. Nga nxitimi apo nga gëzimi se ia doli mbanë. Ritmi a hovet e zemrës, në këso rastesh, janë pothuaj të njëjta.

I PANGOPURI

Eveshi rrobën e politikanit dhe nuk e hoqi më kurrë. Kaloi rininë, pjekurinë, u bë me nipër e mbesa, kaloi moshën e pensionit por rrobën nuk e hoqi. Rroba u bë pis, u zhubravit, u vjetrua, u hollua, u konsumua, u rreckos. Nuk mbulonte më gjë. Tani të gjithë, edhe të verbrit e shihnin. Mes rreckave filloi të dukej mishi i rrudhur, i zbehtë, anemik i trupit të një njeriu që kish vite që nuk shihte më dritë të vërtetë. Pastaj trupi u squll, u flashk, pastaj u tha

si mëlçi pijaneci, derisa mbeti vetëm lëkura, lëvozhga, pa asgjë brenda. Se shpirti kish kohë që kishte fluturuar.

Fytyra ishte e vetmja që ende shihte njerëz, diell. Në pamundësi për ta mbuluar, veshur, fshehur për të mos ia vrarë drita, ai vuri maskë. Maskë mimike, maskë plastike. Mimika-plastika. Aktori më i madh i vendit e mësoi ta përdorte. Fliste, qeshte, qante, shprehej, mbante fjalime, qante halle me maskë. Maskë-mimikë. Së fundmi dhe maska u drobit. U rrudh, u zhubravit, u tëhollua, u tha. U bë PERGAMENË. Kur vdiq e zhveshën. Hoxha u vu ta lajë. Nuk mundi. Lëvozhga e pergamena u kthyen në fije. U shkërmoqën, u bënë thërrime, grimca. Pastaj u bënë pluhur. Pluhuri u shpërnda. Fluturoi. Të afërmit tentuan ta kapin në ajër, ta mbledhin (t’ia fusnin në kuti) por pluhuri u dredhoi. Iu shkau ndër duar, u shmang, prapë dredhoi e së fundmi shkoi e u tret në vrimën e lavamanit.

Kështu iu plotësua dëshira e jetës. Dhe amaneti i fundit: Të shkrihej për popullin...

DILEMAT E ELISABETËS

(Ngjarje të vërteta)

Shofer mikrobusi qe. Por ishte italian. Italion. Dhe të ta luante një italian-italion aso kohe...

...Jemi akoma në fillimvitet 90. Kush iku, iku. Të parët me ambasada. Pastaj të tjerët... Me anije kapicë... që sa nuk mbyteshin... Po ikën në kohë. Për ca vjet, ia hodhën. U bënë italianë me dokumente.

Kush mbeti në këtë anë të bregut, mbeti. O ishte i vonuar, o nuk pati guxim in e duhur. Ose pastaj, si shumica, ndihej rutinor. Nuk dilte dot nga rrjedha e monotonisë, jeta e mërzitshme po njëlloj. Gjithsesi, i sigurt, në shpi t’vet. Në guaskë t’vet, domethënë.

...Ajo, së paku deri në jetën e atyre ditëve të konferencës në Itali, ishte bashkëshorte shembullore, me një burrë për së mbari e me një gocë të vogël si kukull. Nga pamja do ishte më mirë ta kishin quajtur Përkora. Quhej Elisabeta.

...Shoferi italion i mikrobuzit që i shpinte çdo ditë nga hoteli në konferencë apo i gjezdiste pasdite për të parë qytetin, s’ia ndante sytë. I kishin rënë në kokë ato tiparet e saj prej madone province. Trupi e gjithçka e mbledhur. Jo shpërthyes, por pa defekte. Bukuri e fshehtë. Sa duhej e si duhej. Përsosmëri nëpër masa të vogla ku as amësia, as mosha, s’kishin daluar dot vraga. “N’trup (a n’mish), t’vet” thonë shkodrënt. Kishte hyrë në të dyzetat.

...Kaluan tre ditët e po afrohej kthimi ke burri. Ke shpia...

...Ai shoferi, nuk po i ndahej. I tregoi si rastësisht, se kishte dhe një si punë shtëpize të vogël trashëguar nga gjyshja në breg të detit. “Non è un granché... però...” (Jo ndonjë kushedi...megjithatë...)

...Nuk ish se e kish burrin të keq, Elisabeta. Veçë disi gri, monoton. Nuk ia nxinte goja e brendshme t’i thoshte vetes “i mërzitshëm”. Bir ish-partiak PP. Prapë partiak - PD. Dredharak me masë. Serioz. Me shkollë të lartë, me biografi stabël. I përmbajtur e fjalë pak. Aq sa kish për të thënë. Mediokër ke Zoti. Me punë të mirë.

...Ai shoferi, që nuk duhet ta harroni, ishte dhe italian, i propozoi ta merrte një ditë për një drekë në Luka...

...Vetëm atë ditë Elisabeta u kujtua për dy shoqet e tjera të grup-delegacionit “Gratë me iniciativë”. Për ato me veshët bigë. Ato nuk dinin italisht sa ajo. Po thithnin çdo fjale njëjër, edhe kur nuk merrnin vesh. Me vesh truni. Se gratë janë për t’u nxjerrë sytë. Sidomos me sho-shoqen, nuk u shpëton gjë...

“Shko” i tha e para.

-Uaaa. Po ça thua mi. Po Sotirin ku ta le?... Po gocën? Pse mi ça jam unë?..”

“Mos shko” i tha e dyta, Xhevita Pullumi, që kish ngrejtë n’Shijak një biznes me një punishte pastash, “ti e di si jon’ kto pune...ku i zehet bes’ taljonit”

Kësaj, të dytës, Elisabeta, nuk ju përgjigj...

...Në fakt Elisabeta u lidh me shoferin dhe përfundoi në një qytezë të largët të Basilicata-s. Dikush, një emigrant i hershëm nga Çaja e Kukësit, i kishte parë vjet, me shoferin italjon, tashmë të plakur, në një kafe të sheshit të vogël të qytetit. Një tip kafe, veç era thashetheme e provincializëm, nga ato të filmave të Tornatore-s. Mërzi e gjallë...

...Ia fusni kot. E vërteta është se ajo e përdori shoferin sa për të marrë pasaportën. Më pas e la dhe tërhoqi Sotirin dhe vajzën ne Itali. Variantin me Sotirin nuk e kam t’sigurt (e pse do t’i duhej më Sotiri, tani që ia mbushi mendjen edhe vetes sa e zonja ishte për çfarëdo lloj burri në botë... Ndofta tërhoqi vetëm vajzën... më vonë... nuk e di mirë...)

...Në fakt e vërteta tamam nuk është as kjo. E vërteta është se ajo e flaku shoferin shpejt e shpejt, kapi një bos dhe e rregulloi jetën e vet për bukuri... Goca pastaj kur u rrit e u zbukuru, e gjeti vetë mamin e vet n’Itali. Rrugët të hapme ishin...

...Edhe ju mo, kot folni, të gjithë. Se ajo shoqja, Xhevita Pullumi, i ka pa me ato dy sy, Elisabetën me Sotirin përkrahu te pedonalja. Nja 30 vjet më vonë. Ai i gërmuqur. Ajo edhe pse, mbi të 60-at, n’mish t’vet, siç thonë shkodrënt...

VAJTIMI

Kur e sollën tim atë të vrarë në shtëpinë tonë, nëna u shkreh në vaj dhe për një kohë qau me zë të ulët, ashtu siç qanin zakonisht gratë në anët tona. Ajo uli degërminë mbi sy dhe për disa orë i qëndroi te koka tim et, por kur e morën të vdekurin ta shtrinin në tabut, nëna sa bëhej kruspull, sa vinte duart mbi kokë dhe sa ulërinte e qante me ngashërime. Katër burra të gjatë dhe të zbehtë e morën tabutin që ta nxirrnin nga shtëpia. Nëna iu doli përpara dhe nuk i la të ecnin. Ata e mbajtën hapin dhe e ulën tabutin te shkallët e oborrit, nëna nisi një gjëmë që dukej sikur vinte nga thellësia e erret e tokës, dikush nga burrat e zuri nënën nga llërat dhe u përpoq ta largonte nga tabuti, por ajo kërkoi që ta linin aty vetëm për një çast, në mënyrë që t'ia thoshte burrit të saj dy-tri fjalë te koka. Ajo e vajtoi burrin e saj me një zë të thekshëm, që ta ngjethte mishin dhe të shkaktonte mornica.

Nuk e mbaj mend se çfarë i tha tamam tim et, por më kujtohet se në fund e qortoi për një palë çorape të reja, të cilat ia kishte lënë pa i veshur në sëndukun e pajës, dhe për një unuer me pak duhan dhe me kaf që e kishte lënë në qoshe të oxhakut. Zëri i nënës e çante në copa ajrin e lagësht të vjeshtës, ishte një klithje dhe një hije klithjeje që shkonte pas saj. Nëna njehte si me tahmin hapat e një burri që kishte ikur pa kthyer kokën prapa, hija e tij e gjatë kalonte bregoret dhe humbte në mjegullën dendur matanë liqenit. Nuk ishte vetëm hija e tim et që përfizonte nëpër atë vajtim, ishte një radhë e pakëputur burrash që ktheheshin nga një mort dhe shkonin në një mort tjetër. Zëri i nënës i thërriste dikujt që kishte ikur larg në atë radhë, pas pak i përgjigjej po dikujt që e thërriste nga larg. Nëna vajtonte dhe njehte tim atë sikur numëronte një radhë të moçme të burrave të vdekur. Ajo dukej sikur nuk qante vetë, ishte zëri i saj që pikte lot dhe nxirrte gjëmë. Ishte një zë i errët dhe i ftohtë, që i mbështillej vjeshtës nëpër gjymtyrët e mpirë.

Fytyrat e grave u zbardhen si qefin. Sekush nga burrat ktheu kokën anash, që të fshinte sytë me shpinën e dorës. Nga qafa e Rumisë, atëherë, fryu një erë e hollë, e cila solli mbi oborrin e shtëpisë sonë ca pika të largëta shiu. Unë kisha zënë vend nën strehën e shtëpisë dhe shikoja qiellin bosh, mjegullën bosh, erën bosh. Një hop bëra siç pash të bënin disa burra në atë rast: e ktheva kokën anash dhe fshiva sytë me shpinën e dorës. Por gënjeva, sepse nuk më rrodhi asnjë pikë loti.

Pas pak shiu nisi të binte më me nxitim, sikur ngutej të shkonte diku. Nëna u bë kruspull dhe zuri vend në cep të shkallëve të oborrit. Nuk vajtoi më, vetëm qau në heshtje, teksa burrat e ngritën tabutin dhe u nisën për në varreza. Pas tabutit u renditën më pleqtë. Rruga ishte e shkurtër deri te varrezat e katundit tonë dhe ata nuk ftilluan ndonjë bisedë. Mua nuk më lënë të ecja në fund të radhës, ashtu siç mendoja se duhej të bëja, sepse aty nuk do të më pengonte njeri të mendoja për vdekjen e tim et. Në përgjithësi, unë mendoja se im atë nuk kishte pasur ndonjë arsye të kërkonte një botë tjetër më të errët dhe më të frikshme nga kjo që shihnim ne. Pasi na erdh lajmi se e kishin vrarë tim atë, ushtarët na e rrethuan shtëpinë dy net radhazi, nuk kuptohej përse e bënin këtë, sikur kishin frikë se im atë do të kthehej nga të vdekurit dhe do të vinte të takoj me nënën. Një herë madje e përfytyrova një gjë të tillë dhe më lëvizi nga vendi kupa e kresë. Natën e rrethimit të dytë nuk më lënë të dilja të bëja shurrën nën strehë, ashtu siç bëja rëndom para se të flija, prandaj atë natë pash ëndrra të këqija. Më bëhej gjithnjë sikur hyja në një shpellë të errët dhe prapa meje mbyllej gryka e shpellës me një gur të madh, ndërsa unë mbetja ta bëja në errësirë pjesën tjetër të jetës.

DY TREGIME NGA
MEHMET KRAJA

Tabuti më në fund arriti te varrezat dhe mua më shtynë përpara që të zija vend te varri i hapur. Një rrebesh shiu zbriti nga retë dhe mbuloi tokën me zhurmërimën e rrëkeve. Ajri u bë i zi, si i lyster me blozë. Gropa e varrit, të cilin e kishin hapur tre-katër kushërinjtë tanë, u mbush me ujë dhe dy burra zbritën që të hiqnin ujin me teneqe të vjetra. Uji ishte i turbullt dhe i kuqërremët, dy burrat nuk e mbanin dot ujin jashtë gropës së varrit. Dikur ata i hodhën teneqetë tej dhe në fund të gropës shtruan ca dërrasa të vjetra, mbi to shtrinë tim atë të mbështjellë me qefin të bardhë, qefini ishte i lagur dhe tim et iu ngjit pas fytyrës dhe trupit, burrat vunë me nxitim edhe dërrasa të tjera, dërrasat i vendosën pjerrtas, në mënyrë që ta mbronin të vdekurin nga dheu që do të hidhnin sipër tij. Unë vazhdova të rrija pranë gropës së varrit dhe shikoja asagjënë e trishtë që më rrinte përpara. Ndërkohë, uji filloi të mbushte gropën dhe mua m'u duk sikur im atë lëvizti pak. Mbase desh të ngrihej, sepse në fund të asaj grope uji filloi të rritej dhe atë çast nga qafa e Rumisë zu të frynte një erë pa kuptim.

Në fund të pranverës tjetër ndodhi që ushtarët e kufirit vranë një djalë të ri, i cili zinte peshk afër Ujdhesës së Plakut. Ai ishte i vetmi djalë i Tahir Hysit nga Veleliajt. Rojat e hodhën të vrrarin në kënetën e Vaut të Fikut dhe ikën me nxitim me një barkë me motor, barka bënte shumë zhurmë dhe nxirrte tym të zi, djalin e ri e kishte marrë plumbi mbi vetullën e majtë dhe ai ngjante si të ishte kredhur në një gjumë pa ëndrra. Njerëzit u mblodhën te Vau i Fikut dhe qëndruan të heshtur buzë kënetës gjysmën tjetër të asaj dite. Mbay mend se nga fundi i pranverës liqeni ynë bëhej shumë i kaltër, edhe qielli mbi liqen vinte i kaltër, edhe hijet e ullinjve në atë lugajë bëheshin të kaltra. Nëna atë stinë kishte veshur këmbishën e bardhë, degërminë e bardhë, xhamadanin e bardhë, bohçen e bardhë dhe kishte shkuar të vajtonte djalin e ri në atë katundin afër liqenit.

Kur u kthye, unë pash se nëna i kishte sytë të mbushur me hije të errëta, dhe ajo bardhësia e veshjes së saj dukej e vjetër dhe e përdorur, sikur vinte nga një vajtim që kishte zgjatur tërë jetën. Po me atë radhë nëna u mbyll në odën e saj dhe vajtoi gjithë atë ditë pranvere dhe të nesërmen deri në mbrëmje. Unë qëndrova pas derës

dhe mbajta vesh fjalët që thoshte. Ajo nuk vajtoi një njeri të caktuar, vajtoi të gjithë të vdekurit dhe gjëra të tjera që zakonisht nuk vajtoheshin te ne. Ajo vajtonte pranverën që ikte dhe nuk kthehej më, vajtonte nënën e saj që e kishte lënë fëmijë dhe nuk kishte ardhur asnjëherë që ta shihte. Ku i ke tash sytë e zi, o e mjera unë, o, pse nuk erdhe një herë me m'pa, o e mjera unë, o! Vajtonte për një zog mali që diku larg e kishin mbyllur në kafaz, pastaj iu kthehej sërishmi të vdekurve, ndonjërin e thërriste me emër dhe e pyeste për të vdekurit e tjerë, një herë e përmendi babanë dhe e qortoi pse e kishte lënë vetëm, foli përsëri me zogjtë e malit dhe e përmendi disa herë qyqen që këndonte në rrem të thatë. Zëri i saj dikur u mek, u bë i vrimëzuar nga thirrjet dhe rënkimet. Kisha përshtypjen se nëna vajtonte diçka krejt abstrakte, vetëm që nuk gjente fjalë për ta shprehur atë. Pse nuk e shoh atë që nuk shihet, o e mjera unë, o! Pse nuk di atë që nuk dihet, o e mjera unë, o!

Pas kësaj stine, nëna u bë disi e largët, sikur rrinte mbas hijes së zërit të saj të trishtuar, ishte një si perde e endur me rënkimet dhe gjëmat e saj, që e mbante botën të mbyllur në një dhembje pa shpjegim. Nëna vishej me të bardha dhe shkonte të vajtonte vdekjen kudo që të ishte ajo, pastaj ajo kthehej me një pamje të qetë, por disi të mërguar dhe të braktisur. Dukej sikur në ato vdekje të panjohura linte nga një pjesë të brengës së vet, më pastaj dukej sikur bota këndeje vdekjes nuk ishte botë e njëmendët, këndeje vdekjes ajo donte të mos i mbetej asgjë, asnjë peng, asnjë mall, të gjitha t'i merrte me vete në një ecje të largët. Kjo ndjesi më mbushte mllëf, sepse nëna e donte vdekjen dhe ajo ishte ngushëllimi i saj i vetëm. Kudo që vdiste dikush ndër ato anë, nëna mbështillte një bohçe me gjërat e saj të nevojshme dhe ngarendte të bënte vajtimin. Asnjëherë nuk mora vesh se çfarë mbante në atë bohçe. Ajo nuk ndalej të pyeste njeri se kush ishte i vdekuri, burrat i hapnin rrugë që të hynte e papenguar në shtëpinë e mortit, ndërsa gratë i bënin vend te koka e dritëshumit, që të niste vajtimin me zë të thekshëm. Nuk kuptohej nga e merrte vesh ajo se kush ishte i vdekuri dhe si e kishte emrin, ishte sekret i saj. Po të ndodhte të arrinte me vonesë, tabuti ndalej në derë të oborrit, ose në rrugë për në varreza, nëna e bënte vajtimin pak si me nxitim, por në

ajrin e heshtur, në jeshilin e maleve dhe në liqenzën e prajshme ndihej një lehtësim, sikur vdekja e sflitur më në fund të gjente prehjen e amshuar.

Ndonjëherë nëna fliste me vete, në fillim ajo vetëm luante buzët, nuk nxirrte as zë dhe as pëshpërimë, madje unë besoja se ajo nuk thoshte një gjë të caktuar, thjeshtë i linte buzët t'i pëshpëritnin fjalët ashtu siç i vinin, por unë i thash motrës një gjë tjetër, se nëna fliste me të vdekurit, motrës iu zmadhuan sytë dhe për pak ia nisi vajit. Më vonë u bë kureshtarë të dinte se çfarë mund të fliste nëna me të vdekurit e saj, mua m'u desh të rrija pothuajse një natë të tërë pa gjumë, që t'i mendoja gjërat që mund t'i fliste nëna me shpirtrat e atyre që nuk ishin më. Një radhë u bëra keq, sepse nëpër terrin e natës krijova pamje që më lemerisnin. Edhe për punën e shpirtrave m'u desh të gjeja një shpjegim, sepse motra kërkonte të dinte se ku rrinin shpirtrat e atyre që vdisnin dhe në përgjithësi çfarë ndodhte me të vdekurit kur shkonin në botën tjetër. Unë jepja ca shpjegime kuturo, motra më shikonte me dyshim, pastaj rrinim një kohë të gjatë pa folur, atë e brente dyshimi se unë i sajoja shpjegimet për enigmat e botës, por nuk kishte guxim të ma thoshte. Një herë më pyeti për hijet, se ku shkonin ato, kur nuk i shihnim më, unë bëra sikur u mendova gjatë, ajo më tha se nuk dija gjë për këtë punë, se doja ta gënjeja, së fundi ia vura gishtin mbi ballë dhe ia mbajta në mes të vetullave një grimë herë, i thash t'i mbyllte sytë, pastaj i pëshpërita te veshi, se hijet që iknin nga bota, futeshin në mendjen e saj dhe që andej nuk dilnin kurrë më. Ndoshta kjo ka qenë arsyeja pse motra atë verë u bë shumë e zbehtë dhe asnjëherë nuk pranoi të dilte vetë dhe bënte shurrën nën strehën e shtëpisë.

Në të vërtetë, unë një herë e kisha dëgjuar nënën në dhomën e saj të bënte një vajtim që nuk ishte i ngjashëm me asnjë vajtim tjetër. Mbay mend se zëri i saj vinte disi i butë, si push kadifeje, si zë që zbret nga ëndrra, ajo qante dhe këndonte, unë rrija mbas dëre dhe përpiquesha t'i mbaja mend fjalët që i thoshte ajo. Sado që më vonë jam përpjekur të rrëmoj në kujtesë, nuk kam arritur t'i gjej të njëjtat fjalë që i thoshte nëna. Ajo vajtonte një dashuri të munguar, nuk ishte dashuri e humbur, ishte dashuri që nuk kishte ndodhur kurrë, një dashuri që ajo nuk e kishte gjetur askund, nëna nuk vajtonte jetën e saj, as fatin e vet, ajo vajtonte dashurinë e cila përjetësisht kishte mbetur e zbrazët, prandaj në botë vinte nata dhe prandaj dritën e dëbonte terri; prandaj shiu binte nga retë dhe prandaj dielli ikte në perëndim; prandaj yjet rrinin aq lart në qiell dhe prandaj retë shkrepnin në hava; prandaj korbati ishin të zinj dhe prandaj kishte helm në gojën e gjarpinjve. Nëna i kishte gjetur fjalët që i duheshin, kishte bërë me to një si këngë vajtimi dhe pastaj fjalët i kishte lënë të iknin pa shenjë, siç ikë rrjedha e ujit ose fishkëllima e erës, teksa unë kisha mbetur përgjithmonë jashtë dhomës së saj.

PIANISTJA

Mbrëmja letrare u mbajt në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, kështu ishte pagëzuar së fundi. Amfiteatri ishte veshur me dru dhe ngjante me një zbritje e shkallëzuar për në askund. Njerëzit e paktë ishin ulur në dy-tri radhë e mesit; vendet e tjera ishin të zbrazëta. Në hyrje të sallës një llambë elektrike fikej dhe ndizej pareshtur. Në tregimin tim qeni dhe njeriu ishin shtrirë nën hijen e hurmave dhe shihnin të njëjtën ëndërr. Pranë podiumit ishte vendosur një pianino e vjetër. Zbrita deri në gjysmë të sallës dhe aty u ndala i hutuar. Nuk dija pse isha aty dhe çfarë duhej të bëja. Isha gati të dilja që andej duke rendur dhe, po me atë vrap, të ikja pa kthyer kokën. Por një zonjë e bëshme, që udhëhiqte mbrëmjen më

mbajti nga krah u dhe më çoi te pianistja. Ma prezantoi pianisten dhe tha se e kishte emrin Teuta. Si mbretëresha ilire! Zonja e bëshme qeshi me një sërë dhëmbësh prej protezash. Teuta nuk qeshi. Ajo kishte fytyrë të zbehtë dhe shikim pak melankolik. Nuk bënte për piano, më shumë mund t'i shkonte violina. A mund ta di, çfarë do të lexoni? Diçka që mund shoqërohet me Moxartin. Por unë do të luaj Shopenin. Ma mori mendja.

Në përgjithësi, mbrëmja letrare m'u duk qesharake dhe atë çast e urreja veten, pse nuk isha në gjendje të thosha asgjë lidhur me këtë. Pianistja Teutë vazhdoi edhe një kohë t'i binte pianos, duke u luhatur mbi tastierë dhe duke u përpjekur të krijonte një harmoni të paarrtshme midis tingujve dhe ëndërrimeve të saj. Në të vërtetë, kur luante Shopenin gjithmonë i dukej vetja sikur vraponte lakuriq nëpër një fushë të gjerë, ndërsa puhiza e lehtë e pranverës e ngrinte në ajër dhe e shëtiste mbi botë. Mirëpo, kësaj radhe ëndrra nuk bënte. Tingujt e Shopenit ngjanin me ca zogj të lodhur, që binin përtokë në fluturim e sipër. Pianistja mbaroi lojën, pa e çuar në fund frazën që e kishte nisur, u mbështet me bërnyla në tastierë dhe qau. Askush nuk e vërejti. Ishte kohë pas luftës dhe njerëzit mund të qanin pa ndonjë arsye.

Zbrita nga podiumi bashkë me të tjerët dhe anash ulëseve ngjita shkallët e amfiteatrit, duke mbajtur sytë te shtroja e kuqe e rrjepur nëpër cepa. Nuk kisha dëshirë të flisja me askënd. Pas meje vinte pianistja. U ktheva dhe i buzëqesha, pa e ditur përse, ndoshta vetëm për ta ngushëlluar në atë pikëllimin e saj të verdhë. Më falni, nuk ju njoha që parë, nuk e dija kush ishit. Por unë kam menduar se ju jeni i vdekur shumë kohë përpara. Sa përpara? Nuk e di, nijzet-tridhjetë vjet. Unë e kam lexu romanin tuaj të parë, besoj të ketë qenë i pari, nuk e di...

Zëri i saj tani ishte i butë, si kadife e qëndisur me push ëndrrash. Pianistja u largua me hapa të shpejtë, pa e kthyer kokën prapa. Imazhi i mumies së nxjerrë nga thellësitë e shkretëtirës m'u duk për të qeshur, dhe unë qesha, sigurisht pa ndonjë arsye.

Më vonë mësova se zonja Teutë, një grua e hajthme dhe hirshme rreth të dyzetave, kishte mësuar t'i binte pianos që në fëmijëri, por pakkush e dinte se ajo e urren atë instrument, pranë të cilit e kishte kaluar shumicën e jetës. Ajo ishte e bindur se tingujt e krijuar nga Zoti dhe të shpërndarë nëpër kozmos në një harmoni të përsosur, pianoja e saj i mbledh një nga një dhe i detyron të marrin formë të gënjeshtërt. Në rininë e hershme e ëma i kishte vënë një regjim të tmerrshëm mësimesh dhe ushtrimesh, sepse, sipas bindjes së saj, fëmijët e plebenjve, siç e quante ajo shtresën punëtore dhe fshatare të shoqërisë, nuk mund të bëheshin pianiste më të mira se ajo.

(Ndërkohë, derisa Teuta vazhdonte ta urrente pianon, ai instrument-monstër u bë mundësia e saj e vetme për të hyrë në shoqëri. Duke qenë e bindur se magjia e muzikës është e lidhur ngushtë me praninë e një gruaje, ajo e përdori pianon e saj në mënyrat më të pabesueshme: bëri dashuri mbi të, urinoi mbi tastierë kur ishte e dehur, foli me të në çastet e rënda të depresionit, por nuk arriti kurrë ta hiqte nga vetja një urrejtje sflitëse, e cila ia kishte mbufatur damarët me mllëfin e zhgënjimit. Pianoja ia kishte nxirë jetën!)

Rreth dy muaj më vonë, një pasdite maji, në banesën time ra telefoni, për herë të parë pas shumë kohësh që kishte qëndruar i shurdhër në një qoshe të korridorit. Numri ishte ai që kishte qenë, edhe aparati ishte po ai. Telefoni nuk cingëroi, por zukati me një zhaurimë të mbytur, që të krijonte ndjesinë e gërricjes në muret e plasaritura të një kujtese gati të zhbërë. Ngrita receptorin dhe thashë fjalët e zakonshme. Nga matanë vinte një heshtje e gropëzuar, e përbërë nga mungesa e fjalëve dhe e zërave që ishin

tretur pa gjurmë. E ula receptorin.

Pak më vonë telefoni ra sërish, tani duke krijuar një të çarë të egërsuar mbi idenë e heshtjes dhe të vetmisë. Aparati im i telefonit kishte një dritarez, ku shfaqej numri që thërriste. Aty vëreja se ishte një numër lokal, por krejtësisht i panjohur. Prapë thashë fjalët e zakonshme dhe e shtrëngova kufjen pas veshit, në mënyrë që zërin e matanshëm ta perceptoja sa më të qartë. Alo? Asgjë. Se nga dyndej një fëshfërimë, si erë shkretëtire, që të mbushte me thërrime tonike gropëzimin e heshtjes. Përreth ca sinjale të largëta, si gjilpëra me vezullim të mprehtë, shponin muret e padepërtueshme të një mase të shurdhër. Ishte një heshtje e kthyer mbrapsht, kuptimin e së cilës nuk e kapje dot. Pastaj se nga erdhën ca tinguj pianoje, që hynë ngadalë në orbitën akustike, si një vërshimë jonesh të dritësua që dynden ngadalë drejt një horizonti të mbushur tej anës me ngjyrë purpuri.

Një çast më vonë tingujt u shtuan, u bënë më të qashtë, më depërtues, duke u futur midis heshtjes, pak me drojë dhe pak me hamendje, herë me një nanurisje të ëndërrt e herë me pulitje qepallash në një pikëllim drite, si era që përkëdhel ujin, si rrezet që shëtisin mbi bar, si pikat e vesës që spërkasin pulpat e një vajze tek ngarend livadheve, pastaj një fluturim mbi re, pastaj një valëvitje tjetër e ëndërrt mbi ngjyrat e ylberit, pastaj një aterrim i puhizës mbi petalet e luleve, pastaj një dremitje mbi një varkë në mes të liqenit, e rrethuar me diej të vegjël që kërcëjnë nga një valëz në tjetrën, pastaj një dalje nga ëndrra, pastaj një asgjë e trishtë që fillon nga pragu i ëndrrës dhe shkon nderi në amshim.

Telefoni u mbyll. Nuk mund ta them sa zgjati. Arrita të identifikoja një nokturno të Shopenit dhe të përfytyroja gishtërinjtë e hajthëm që shëtisnin mbi tastierë. Pianistes nuk ia dola t'i jepja një pamje reale: ngjante më shumë me një imazh, i cili shpërbëhet sapo heq mjegullën prej tij. Ajo nuk donte të zinte një vend në hapësirë, donte të mbetej matanë, atje ku nuk arrinte asgjë tjetër, përveç përfytyrimeve: mund ta mendoja profilin e saj, me një qafë të gjatë dhe me flokët e lidhur në maje të kresë, e veshur me një rrobë të bardhë, të nëpërdukshme dhe me gishtërinjtë që lëviznin mbi tastierë gati vetvetishëm, si të shtyrë nga puhiza.

Ishte një mbrëmje vere, kur telefoni i

zi ra disa herë. Kishte ditë që banesa ime ishte mbërthyer nga një heshtje e amullt, e cila nuk lëvizte nga vendi. Tani që krisma e telefonit ia dha me ulërime të ngjirura e banale, m'u duk vetja qesharak dhe i cektë, që për më shumë se dy muaj e prisja pikërisht këtë cingërimë telefoni. Në thellësi të vetes unë e ndjeja kotësinë e mjerë të situatës, por e kisha më të lehtë t'u bëja ballë shkarjeve të mia emocionale përmes një inercie të shkujdesur, sesa të kridhesha në shestime të gjata, të cilat sërish do të përfundonin në një tautologji cinike: i gëzohem gëzimit, pikëllohem nga pikëllimi, kuptimin e jetës e gjej duke kërkuar pikërisht kuptimin e jetës etj. Ç'situatë muti! Përfundimisht e kisha zhgënjyer vetminë.

Më në fund e vura receptorin te veshi dhe prita në heshtje, më gjatë se zakonisht. Nga errësira përtej, nga askund, vinte një heshtje e zgavruar, e mbushur me ca gropa të zeza, të cilat thëthinin përfytyrimet e mia. Në të vërtetë, nuk kishte asgjë që mund të sillja në kujtesë, përveçse ta krijoja vetë një pamje imagjinare: një grua që mund të ishte ulur pranë pianos, e mbështjellë me një pëlthurë të bardhë, pak më andej një perde dhe një dritare e hapur, profili i saj që nuk arrinte të merrte një trajtë, që mjegullohej sapo përpiquesha ta ravijëzoja në pamje pak më reale. Pamja ishte si një kartolinë amatore, e nxjerrë nga kujtesa dhe e ngjitur në përfytyrim. Për një çast m'u dridh dora që mbante telefonin. Po nëse ajo pianiste nuk ekzistonte fare, nëse ishte një realitet i sendërgjuar, një imazh që vetë e kisha krijuar? Matanë receptorit tani kishte zënë vend një heshtje e ngurtë, e padepërtueshme. Ndonjëherë më dukej sikur me atë grua po riktheja në jetë një dashuri të vjetër, të harruar dhe të lodhur, të përdorur gjatë, si partiturat e asaj muzikës që ajo e luante prej shumë kohësh.

Mbajta vesh edhe një copë herë, por heshtja e matanshme e kishte mbërthyer kohën që tashmë nuk matej. Dikur u dëgjua një tingull, si një pikë loti që shkëputet nga qepalla dhe bie mbi qëndismën e ëndrrës. Një tingull tjetër u shfaq më pas, i bardhë, i tejdukshëm, i qelqtë, i sedeftë, gati që të thyhej. Tingujt e tjerë, që shkëlqenin si perla, erdhën më të shpeshtë, me një renditje abstrakte, përmes vlerave të përbashkëta të intervaleve të heshtjes, si të ishin elementë kimikë, që plotësonin vendet e zbrazëta në tabelën periodike. Së fundi tingujt u rralluan,

qëndruan pezull mbi masën e heshtjes dhe dikur u zhdukën njëri pas tjetrit. Në receptor u dëgjua një frymëmarrje e ngadalshme, një dyndje e ajrit, sikur pulsonte nata. Alo! Pse nuk flet? E çka me thanë? Asgja, vetëm thuaj se je aty. Këtu jam, e çka masandej? Muzika jote më pëlqen, dua të them... Unë ndihesha ma mirë, kur më ishte mbushë mendja se askush nuk e pëlqente muzikën time. Tash më duket sikur kam humbë një pjesë të zhgënjimit tim dhe kjo më dëshpëron.

Heshtje. Prit, mos e mbyll, të flasim për diçka tjetër. Për çfarë? Për lirinë? I shoh që njerëzit gëzojnë, por mua më duket sikur nuk kuptoj asgja, sikur krejt kjo ndodh diku tjetër. Askush nuk kupton. Nëpër banesën time edhe për një kohë u enden tingujt e ikur nga muzika matanë telefonit, derisa më në fund heshtja e gjatë dhe e shurdhër ndryshoi rendin e gjërave. Në orët e gjata të pagjumësisë mendova për jetën që kisha bërë, gjithkrah shihja mbeturinat e saj, askund nuk kishte mbetur diçka e tërë, vetëm copa që nuk ngjiteshin dot më.

Të nesërmen telefoni ra sërish. Duke u endur nëpër masën e shurdhër që prodhonte prania e saj në linjën e heshtur të telefonit, unë arrita të sjell në kujtesë përfytyrimin e hershëm të pianistes, gishtërinjtë e gjatë e të zbehtë, profilin e saj të krijuar nga sinestezia e tingujve ëndërrimtarë, sfondin e ajërt të prapavijës, sikur tërë pamja pluskonte në etër. Më pas heshtjen e matanshme e mbuluan tinguj të nëpërdukshëm, tinguj të butë e të valëzuar, si mëndafsh i tjerë në ëndërr, një si ende që riniste gjithmonë nga e para: ishte e njëjta muzikë, e cila duhej të më bezdiste me përsëritjen e saj këmbëngulëse, por nuk ndodhte ashtu.

Pas pak muzika pushoi dhe në telefon u mpiks heshtja. Ajo e mori receptorin dhe në kufjen e errët u dëgjua frymëmarrja e saj e nxituar. Ngjante të kishte vrapuar gjatë nëpër një peizazh të mbuluar nga muzgu i dimrit. Tani fryma e saj vinte si një erë e ngrohtë, që shkrinte krahnezat e borës. Kam dashtë me t'pyetë, por kam frikë. Nga se ke frikë? Nuk e di... se mos tallesh me mue. Të gjithë mendojnë se gjithmonë flas gjana që nuk duhet. Nuk e kuptoj. As unë. Për shembull, unë due që njerëzit që ndigjojnë muzikën time, ta kuptojnë se nuk i prodhoj unë këta tinguj, as pianoja ime, por ato janë diku në gjithësi. Janë tinguj të përjetshëm. Unë vetëm i kërkoj dhe i gjej, ashtu siç i ka lanë Shopeni. Ai duhet të ketë qenë i lumtur, që ka arritur t'i mbledhë këta tinguj nëpër një gjithësi të paanë. Të duket se flas si e çmendur? Jo, pse? Nuk e di, besoj se kështu mendojnë njerëzit, vetëm se mue nuk ma thonë. Jo, unë nuk mendoj... Edhe diçka due me dijtë për ata që ndigjojnë muzikën time: due me dijtë a besojnë te lumturia. Çka mendon se duhet me t'thanë? Jo, asgja. Ndoshta nuk asht dashtë me e ba këtë bisedë. Nuk kuptoj pse, këtu nuk po ndodh asgja, asnjë sakrilegj. Në përgjithësi, unë nuk flas me njerëz, as njerëzit nuk flasin me mue. Ndigjojnë muzikën time që nuk e kuptojnë dhe kaq ju mjafton. Kurse unë me nokturnet e mia bredh nëpër një natë që nuk mbaron kurrë. Prapë mendoj se nuk asht dashtë me folë me ty. Due një gja prej teje: të lutem, mos e duej muzikën time, sepse ky fakt më tmerron. Çdo gjë ishte shumë më mirë kur nuk njiheshim. Ne nuk njihemi dhe nuk e kuptoj... Po pse? Sepse ti nuk ekziston, unë vetëm e gënjej veten.

Ajo heshti, por nuk e mbylli telefonin, e la diku, sepse u dëgjua një rrapëllimë e shkurtër. Ma mori mendja se ajo tani ishte ulur pranë pianos, shikonte tastierën dhe gishtat e vet të hollë e të zbehtë, ose shikonte diku matanë dritares, një dru vjeshtor që kishte filluar të rrëzonte fletët. Pas pak u dëgjuan ca tinguj të rrallë, me një kadencë që përmbyllte një frazë muzikore. Pastaj ra një heshtje e gjatë. Ajo qante. Diku në sfond u dëgjua të hapej një derë. Ajo e mbylli telefonin dhe prapa asaj heshtjeje nuk mbeti asgjë.



1 -Bie shi i kuqërremtë në Pompej.

Bie shi i kuqërremtë mbi statujat seksuale në Pompej.
Dashnorët e vjetër ua bëjnë me sy vizitorëve
që besojnë se misteri i krijimit të botës,
fillon me nxehtësinë dhe takimin.

CNN thotë se diga Dniper hidhet në erë,
ndërsa ujërat përmytin Ukrainën,
Papa Françesku i dërgon letër Zelenskyt.

Mbi dilema spjegimi, larg, larg luftës e tmerrit,
Heshtur - heshtja e grave indiferente, pyet përse,
Pompeun - qytetin e qejfit,
Vezuvi e dogji me llavën e nxehtë të vullkanit?

Buzëve të kraterit inkadeshent, ende të paqetë,
Ciceroni harron të thotë se hakmarrja është gabimi dymijëvjeçar,
I rrëzimit të statujave me defektin e tyre, vesin.

Bie shi i kuqërremtë mbi statujat seksuale në Pompej.
Zogj të çuditshëm shtegëtojnë qiejve të vjeshtës ...

2-Veten mos e humb!

Me duf fëmije, me të qara
Për ego botën mos e tund.
Gjej një motiv e bëj përpara,
Veten mos e humb!

Në kohë të çmendur, të tërbuar,
Në turp mëkati a në kurth.
Ti mos u ndje i mënjanuar,
Veten mos e humb!

Kur gjen të lodhur, zemërthyer,
Të japësh shpirt, ti mund.
Në dallgë fati, lumërrëmbyer,
Veten mos e humb!

Një ftesë njeriu të kesh rrugën,
Se e vërteta djeg e shkurmb.
Ti me revoltën ndaje bukën,
Veten mos e humb!

Ti kurrë mos hesht, profet i ri,
Mërzinë nga rrënjët shkund.
Dënuar je, veç me liri,
Veten mos e humb!

Rrebel i kotë e me të qara
Për ego botën mos e tund.
Gjej një motiv e bëj përpara,
Veten mos e humb!

3 -Frederik Rreshpja, koha e dytë.

Si rrëkeza e pafajshme poshtë dherave
përpëlitej fjala,
Pa mundur të dilte sipër, ecte rrugës së vet.
Nënë, çfarë bote qënka kështu?

Vitet e gjata në fshehtësi i kthyen fytyrat në maska.
Nëse hesht tani, tradhëton vetveten duke përqeshur skenat e çuditshme kuturu!

Prej asaj dite në dallgë të Bunës
çdo çurg i vogel uji,
djeg si qymyr i ndezur.

Zëri i tij u bë tingull i vetëm,
Të tjerët në breg heshtën.

E ç'ka fitove me mbrojtjen e lirise?
Nuk humba kurrëgjaj!

HIJA E FSHEHUR
E BURRIT

Poezi nga Odise Kote



Gjeta zogun e lirikës dhe hapësirat elegjiake.
Vetminë që fluturon lehtësisht nëpër fusha,
Kapërcen malet.
Dhe më sjell vetedijën e skllaverisë vetjake.

4- Shtatë male, shtatë fusha.

Në Kështjellën e vogël Loreto¹
mbi përrenjtë e thepisur të Papatit,
Mijëra vizitorë nga bota magjepsen,
hutohen,
blejnë syvenire, mbështillen me mistikë.

Ngjan çdo gjë është bulb e palcë,
asht antropologjik,
ndonëse shekujt s'ikën kurrë paqësisht.

Inkuzicioni dhe vdekja ende fryjnë si erë e marrë,
për të shpallur ndjesinë e betejës me vetveten,
ku humbja dhe fitorja fqinjërojnë,
sublimohen.

Dhimbja bëhet tjetërfarë, e jotja dhe e tjetërkujt,
dhimbje që përbuz të përzishmen, të voglën,
përpëlitet në shqyrtim, vetëflijohe,
kërkon të harrohet.

Matanë kështjellës Loreto, matanë detit,
është Atdheu im, plot diell, i qeshur,
grotesk, çudan, tinzar, i ngrysur,
me njolla të mbetura stepash ruse,
orizore kineze, gjëmbaçë Anadolli.

Kalit të hazdisur të vetëdijës,
i duhet të kalërojnë pa ndalim.

Në shtatë male e shtatë fusha
ku vigjëlojnë rojet e moskuptimit,
për të mbërritur.

Në Kështjellën e vogël Loreto,
mbi përrenjtë e thepisur të Papatit,
vizitorët e botës magjepsen, hutohen,
blejnë syvenire, mbështillen me mistikë ...

5- Hija e fshehur e burrit...

Hypur mbi kulm të shtëpisë,
Shkul me tërbim tjegullat një nga një.
E çfarë bën ashtu or plak?
I shkul nuk e sheh?
Dua t'i shes,
atje në qytet,
një tregëtar shëtitës i blen me çmim të mirë.

Ti s'mund të shesësh gjënë e tjetrit,
atë që s'të përket,
i tha një zog resh të zeza
që ngjau soj sorre,
duke fluturuar ulët sa e çiku në sup.

Ka trembëdhjetë vjet që ka vdekur,
E varrosa me duart e mia, i vetëm,
pasi në fshat këmbë njeriu s'ka mbetur.

U shfajësua hija e fshehur e burrit,
Që ra si thes me relike të shpërdoruara,
nga maja e vetmisë.

6- Vetëm ti ...

Vetëm ti ma ke rrëmbyer kujtesën.
Ç'ti them erës që gërvishet me thonj në qelqe?
A e kam humbur atë flakëzën e shpresës,
pyes gërmat që nga pemë e durimit varen...

Vetëm ti ma ke rrëmbyer kujtesën.

Ëndrrat dhe udhëtimet pa ty i refuzoj.,
bashkë me çmenduritë e fotot e kujtiesës.

Gjethe pengjesh të këputura,
rënë me ngut natën,
shkrime shiu në erën e çmendur,
tani kushedi ku bredhin të trishtuara.

Vetëm ti ma ke rrëmbyer kujtesën ...

7- Kjo botë që prej fillimit ...

Dëgjo! - thosh' mëmëzonja kur isha fëmijë:
Njëherë të jesh dele, dritë, me sytë nga zoti,
Herën tjetër ujk, flakë, rrufe që të djeg.

Kjo botë e kokolepsur që prej fillimit,
Kështu vete - vjen ...

8- E humbëm librin, mikja ime ...

Gjithë jetën, mike, midis librash,
Do ta bitis, nuk ka dyshim.
Gërma paskësh qënë drita,
Fole e ëndrrës, kopshti im.

Kur s'dija ende të lexoja,
Në ngasje frike dhe hutim.
Nuk di si tempuj i nderoja,
Apo si gurë kilometrikë?

Afër dritares, barkas shtrirë,
Ç'parajsë më fshihej përmatanë?
Një botë e mbyllur në pasqyrë,
Libri, zogu im shtegtar.

Dhe universin e ngatërruar,
Shpesh e kam pyetur me dyshim.
Ç'fuqi mister që paska libri,
Kur çel një shteg a një mendim.

Erdh' kohë e rëndë, o moj mike,
Braktisje libri - lëngatë e flamës.
Self dhe qeshja çuçuritëse,
U bë çuditshëm fe e famës.

Gjithë jetën mike, midis librash,
Do ta bitis, nuk ka dyshim.
Dija paskësh qënë drita,
Fole e ëndrrës, kopshti im.

9 - KOBLARA²

Koblara përveç fantazmave nuk dëgjon askënd,
e qara tringëllin në një guaskë të zbrazur,
muret e kishave sigurisht kanë rënë,
bredhat shekullorë ftohen të tregojnë plagët
të cilat duhet t'i fshehin.

Nuk gjen dot asnjë jastëk të butë,
gjaku im ankon pritjen, pikë mëshire kërkund,
heshtja ecën nëpër udhët e veta dhe gjunjëzohet,
të na turpërojë me gjunjëzimin e saj,
historia e kurajës ndihet fare e lehtë, e pafjalë,
si fluturimi gurgujve dhe pëllumbave të egër.

Do të bjerë shi lajmëron toka e thatë e malit dhe nata,
do të bjerë shi, mban aromë shiu, mizat pickojnë.
Koha këtu nuk vdes kurrë e fati këtu nuk ka fat,
siç nuk ka qumësht një tigër mashkull,
megjithatë kjo bukuri qiellore zmadhohet,
zmadhohet përnatë duke parë ëndrra ...

Koblara përveç fantazmave nuk dëgjon askënd ...

10 - Asnjëherë Orfeu nuk zbriti në Had...

Asnjëherë Orfeu nuk zbriti në Had,
dëshmuan rojet,
është çmitizuar loja kukafshehti mes kuptimit e formës.
Dhe nuk ishte Euridika që kishte vdekur,
por vetë dashuria,
në zemër të saj qënkish hedhur fara e rrënimit.

Qindra vjet udhëtoi miti nëpër dete e oqeane,
si pasqyra e brengës së Orfeut dhe konsumimit,
sepse dashuria është një energji e parikthyeshme,
dhe ringjallja është përtej të mundshmes.

1 Kështjella Loreto, në Itali, vend i shenjtë pelegrinazhi ku shkojnë besimtarë nga e gjithë bota.

2 Koblara - fshat malor i braktisur, bosh, me pisha e bredha afër Frashërit, Përmet.

Shkallëve tani zbresin turmat biblike që
lëvizin,
si të zëna në kurth, duke thurur në vegjë të
madhe,
fytyrën e ndërlikuar të dashurisë midis
burrit e gruas,
si pasurim ku secili zgjeron veten përmes
tjetrit.

Cili Helen duhet pyetur, për harmoninë
kundërthënëse
midis shfaqjes së ngrirë dhe thelbit të
fshehur.
Pesha e mitit është e rëndë, nganjëherë e
padurueshme,
skenografi plot tension e dyshime,
trumbeta e çarturi pafund?

Asnjëherë Orfeu nuk zbriti në Had,
dëshmuar rojet,
nëse s’ka rënë zjarr në hambarët e kujtesës
...

11 - Pas beteje, njeriu ...

Në fund të betejës njeriu kërkoi lumin që
ikte në vorbulla,
lumin që hapte shtegun e ngushtë në
shpat të malit,
sepse ishte i drejtë dhe më i keqkuptuari.

Kërkoi lumin që ikte revan,
duke rrahur me ujërat e veta vidhërat e
shelgjet,
duke shtyrë në heshtje tallaz - tallaz rymat
e tij të fuqishme.

Njeriu kërkoi lumin që rrëshkiste si
nepërkë e trembur,
duke çikur lehtas vesën mbi fijet e barit të
blertë,
pa bërë fare zhurmë.

E morri malli njeriun të dallojë vijën e
lumit,
nga ngjyra e zverdhur e gjetheve dhe
myshkut
që shkon e përdridhet poshtë hijeve.

Mbrëmjen e kaluar kur priste vdekjen, një
tuftë çafkash,
fluturuan drejt perëndimit duke ndjekur
dritën e diellit.

Tani që dielli doli përsëri çafkat u rikthyen,
pasi qetësia është ulur në rërën e lumit,
ulur dhe pa lëvizur fare, në pritje të
shpërndahen retë.

Në fund të jetës njeriu e kërkoi lumin që
ikte në vorbulla,
se frymëmarrja e lumit nuk dëgjohet ...

12 - Zbrit andeja ...

Zbrit andeja çirret frika, nuk sheh që bën
veri.
Hyp në barkë, shko mbaro punë, kthehu në
shtëpi.

Ki kujdes flijohej dallga, tretur në stuhi.
Hyp në barkë, shko mbaro punë, kthehu në
shtëpi.

I vetmuar je pa shans, s’bën dot histori.
Hyp në barkë, shko mbaro punë, kthehu në
shtëpi.

Ç’zemërim që paska zoti, bubullimë e shi.
Hyp në barkë, shko mbaro punë, kthehu në
shtëpi.

Fati - toka e askujt, nuk vjen përsëri.
Hyp në barkë, shko mbaro punë, kthehu në
shtëpi.

I përpiu qiejt deti, i futi në gji.
Hyp në barkë, shko mbaro punë, kthehu në
shtëpi.

IBRAHIM
KODRA,
piktori që edhe firma
i mbetet vepër arti

Nga Jurgis Çyrbja
(Deputet i PS i qarkut të Durrësit)



“Incluso su firma es una obra de arte.” (Edhe firma e tij është vepër arti.) tha Pablo Picasso për Ibrahim Kodrën, piktorin më të rëndësishëm shqiptar të njohur ndërkombëtarisht.

Ibrahim Kodra lindi më 22 prill, 1918, në Ishëm, qarkun e Durrësit, ku sot është edhe vendi i tij i prehjes. Artisti me famë botërore, krenaria e kombit tonë na la pas rreth 6 mijë vepra si një trashëgimi e jashtëzakonshme jo vetëm për artin shqiptar por edhe artin botëror, pasi figura e tij emblematike konsiderohet ndër më të rëndësishmit në artin e shekullit të 20-të.

Ibrahim Kodra ekspozoi veprat e tij anëmbanë botës, në galeritë më prestigjoze, përkrah gjigantëve të artit, si Pablo Picasso, Henri Mattise, Marc Chagall, Amedeo Modigliani, Salvador Dali, Georges Braque, e shumë kolosë të tjerë të artit, me të cilët nuk ishte vetëm bashkudhëtar në rrugëtimin artistik por kishte edhe miqësi të ngushtë dhe me ndikim.

Ibrahim Kodra ishte një post-kubist, në formimin artistik të së cilit, pati shumë ndikim kubizmi i Pablo Picasso, sidomos pas miqësisë së ngushtë që lindi mes tyre në Romë në vitin 1948. Gazeta të kohës shkruanin për Picasso bashkë me Kodrën, duke e konsideruar shqiptarin si “postkubisti i fundit në Evropë.”

Por, arti i Kodrës ndryshonte në natyrë dhe emocion nga kubizmi tipik i figurave që e themeluan këtë stil arti, të cilët fokusoheshin më shumë në tre dimensionalën dhe thellimin e perspektivës lineare e atmosferike dhe natyrën e brendshme njerëzore. Kodra e përdori kubizmin si stil bashkëkohor të ndërthurur me natyrën, traditën, ngjyrat dhe emocionet shqiptare.

Te veprat e tij dallohen qartë kostumet dhe veshjet shqiptare, natyra karakterizuese e popullit të tij, e madje edhe peizazhet, qoftë tablo të tëra apo edhe në sfond ngjasojnë me vendlindjen e tij, Ishmin, bregun tjetër të Adriatikut, nga Italia ku ai jetonte.

Ndaj edhe Picasso e quante ushqim për shpirtin miqësinë që ai kishte me Kodrën. “Shqiptari im” i referohej Picasso gjatë bisedave të tyre të gjata. Të gjithë artistët e mëdhej të kohës, gjatë bisedave me Kodrën përpiqeshin ta njihnin e ta imagjinonin Shqipërinë e tij, përmes bisedave të Kodrës, e padyshim përmes elementëve folklorik që gjendeshin në telajot e Kodrës, të cilat ishin edhe ilustrime të kujtimeve të fëmijërisë në Ishëm dhe mallit për Shqipërinë e tij.

Përmes artit të tij, Ibrahim Kodra u bë ambasadori i denjë

i Shqipërisë në botë, pasi tablotë e tij gjenden në dhomat e Vatikanit, në Dhomën e Deputetëve (Parlamenti Italian) në galeri e muze të njohur, dhe koleksione private në të gjithë skajet e botës.

Poeti i madh francez, Paul Eluard, në faqet e “Unité” në vitin 1946 e quajti Kodrën “primitivi i një civilizimi të ri,” dhe me primitiv nënkuptonte art të kulluar në një botë të re e moderne. Primitivizmi që ai pikasi herët përmes stilit modern, apo mënyrën ekspresioniste të të menduarit dhe të jetuarit, nuk ishte gjë tjetër veç një primitivizëm që vinte nga rrënjët e tij, nga vendlindja e tij Ishmi.

Origjina nga një vend mesdhetar, me bregdet e terren pors i një taverne e Adriatikut, por me kulturë unike, thua jse një botë e re në vetvete, ishte shtysa dhe burimi nga ku rridhte një element i ri artistik që manifestohej një formë e re krijuese, ndaj edhe Eluard e vlerësoi duke shtuar se “Ibrahim Kodra është babai i një qytetërimi të ri botëror.”

Kodra arriti ta vizitonte Shqipërinë në vitin 1973 e më pas në vitin 1996, 1997, 2003, e për t’u kthyer përgjithmonë, sipas amanetit që la, për t’u prehur në varrin tij, në Ishëm, në vendin që e deshi aq shumë.

Sot njësia Administrative e Ishmit, përveçse një mrekulli natyrore e historike, me peizazhe dhe plazhe përrallore, me vlera të jashtëzakonshme historike dhe shpirtërore, si Bazilika dhe Kalaja e Gjuricaj, Kepi i Rodonit, etj, është edhe vendi i prehjes së artistit tonë të madh, i cili edhe sot thërret për një pelegrinazh artistik e frymëzues artistë bashkëkohorë të huaj e shqiptarë.

Pak kohë më parë u takova me artistin bashkëkohor, Agron Hoti, i konfirmuar ndërkombëtarisht në qarqet krijuese me ekspozita në Nju Jork, Paris, Shangai, Kazablanca dhe Tel Aviv, me të cilin, teksa vizituam varrin e mjeshtrit të madh Ibrahim Kodra, diskutuam mbi idenë e realizimit të një ekspozitë me veprat e Kodrës, pranë vendit ku prehet në paqen e përjetshme.

Kjo do t’i jepte edhe më shumë vlera zonës përse i përket njohjes së Kodrës nga brezat e ri, por edhe vetë Ishmit atë vend që meriton në histori e art, duke lartësuar veprat e figurave që bënë historinë, e në veçanti Ibrahim Kodrës, figurës madhështore të artit botërore i cili vazhdon dhe na bën krenar si komb e si shqiptarë përmes emrit dhe veprave të tij që na la si trashëgimi.



Singerisht. Nuk do të ndryshoja asgjë sepse dashuria jonë ishte gjëja më e bukur që kam përjetuar ndonjëherë dhe nuk ka asgjë për të cilën pendothem. E dëgjon? Të betohem se gjithçka ishte perfekte. Ne të dy ishim si ajo dashuria që të gjithë e presin, e di, dashuri që nuk arrijnë ta rrëfejnë as të gjithë librat, filmat dhe këngët. Nëse do të detyrohesh? Nëse dikush do të më vinte armën në kokë dhe të më detyronte që vërtet të ndryshoja diçka, kështu në retrospektivë, mbase do ta ndryshoja takimin tonë të parë. Epo, jo sepse kishte ndonjë gjë të keqe me të, por singerisht, sa romantike është të takohesh në një dhomë pritjeje spitali? Ose spitali është në rregull. Është pak më dramatike kështu. Mund ta lëmë spitalin aty. Por nëse do të detyrohesh ta ndryshoja diçka, ndoshta do të qëndronim ulur në një dhomë tjetër pritjeje. Në vend që të pikasim njëri-tjetrin atje në Klinikën e Venereologjisë, sytë tanë do të mund të takoheshin në ... Nuk e di ... Në Repartin e Kancerit. Ka ndonjë të tillë në spitalin Södersjukhuset? Po e vendosim kështu. Jemi ulur atje në Repartin e Kancerit, sytë tanë takohen, koha ndalon dhe ti je jashtëzakonisht e bukur sa nuk mund të përqendrohem në gazetën time. Të kujtohet kjo? Kur thjesht qëndroja aty dhe bëja sikur lexoja faqet e thashethemeve për disa minuta vetëm ngaqë nuk guxoja të takoja shikimin tënd. Dhe meqë jemi këtu, do të doja ta ndërroja atë gazetë m diçka që është pak më shumë unë. Më lejo të qëndroj ulur atje në dhomën e pritjes duke lexuar Anna Kareninën. Dhe në vend që të përkulesh përpara meje dhe të thuash atë që the (dreq sa mirë që njeriu nuk është i vetëm në ankthin e akteve seksuale gjatë pushimeve), ti përkulesh dhe thua diçka për mendjemprehtësinë e Tolstoit për të portretizuar gratë ose kafshët ose shoqërinë klasore. Ky le të jetë takimi ynë i parë. Dhe në vend që të takohemi përsëri në stacionin e autobusit dhe të fillojmë të bisedojmë për atë se sa e turpshme është të urinosh në atë filxhanin plastik dhe sa e vështirë të ndalosh urinimin në mes, ne takohemi në stacionin e autobusit dhe fillojmë të flasim për atë se sa e vështirë është të kesh një të afërm të sëmurë me kancer. Po, mund të shkoj kështu, apo jo? Dhe tani jemi duke qëndruar atje në stacionin e autobusit, ti më kërkon një cigare dhe unë të komplimentoj për tatuazhin, ti më tregon historinë qesharake se si kishe vendosur ta bëje atë në Tajlandë kur ishte në pikë të qejfit dhe më pas ishte zgjuar, ishte kthjellur dhe për javë të tëra kishe shpresuar se ishte thjesht një tatuazh këna. E lëmë kështu – mu ashtu siç ishte. Por të lutem, a mund ta heqim atë pyetjen time pasuese krejtësisht idiote? (A është tatuazh këna atëherë?) Më vjen ende turp për këtë. Përveç kësaj, nuk ka asgjë që dua të ndryshoj.

Asgjë.

Mirë, ndoshta motin, meqë ra fjala.

Po e heqim atë shiun e turbullt të vjeshtës dhe po e zëvendësojmë me rrezet e diellit. Ose edhe më mirë. Po themi se do të shihemi për herë të parë pikërisht kur pranvera fillon të marrë jetë. Erërat mbushin qytetin, të gjithë janë relativisht të papërgatitur për vapën dhe shndërrohen në peshq të artë, pajtohen se nuk ka qenë kurrë kaq nxehtë më parë. Le të na shkëlqejë një diell i tillë derisa qëndrojmë atje në stacionin e autobusit dhe në vend që të marrim autobusin fillojmë të ecim përgjatë Rugës së Unazës. Pemët shkëlqejnë jeshile, dhëmbët e tu shkëlqejnë të verdhë dhe këpucët na ngjiten asfaltit të nxehtë veror, sepse për dreq, nuk është më pranverë, befaz është bërë verë, vera më e bukur në botë. Tinguj të largët të fëmijëve që luajnë basketboll , diell flakërues , ne bëjmë shëtitje dhe shijojmë e flasim pikërisht për gjërat për të cilat kemi folur në autobus atë ditë vjeshte me shi. Të kujtohet apo jo?

Vazhdojmë me tatuazhet dhe unë të tregoj për atë djalë në punën time që arsyetoni vizatimin e krejt pjesës së sipërme të trupit të tij me tatuazhe duke thënë se e njihje një mik që ishte artist tatuazhesh dhe



PAFUNDËSISHT E PANDRYSHUESHME

Tregim nga
Jonas Hassen Khemiri

Përktheu nga origjinali suedisht: Qerim Raqi

ia bëri me një çmim shumë të volitshëm. Tani kishte bërë të gjitha motivet që kishte dëshiruar, por nëse do të bënte një tatuazh tjetër do të donte diçka klasike, që do të binte vërtet në sy.

Çfarë? pyet ti dhe këtë pyetje e bënë mu si atëherë në autobus sepse nuk ka njeri që mund te pyes me një kureshtje më të sinqertë se ti.

E di, Derrkucin tek Arushi Puh? Ai dëshiron të bëjë tatuazh një astot Derrkuc me kapelë kauboji si kjo në vesh , pufla dhe një yll sherifi në gjoks. Dhe këtu ti ia kris një të qeshure të pakontrolluar ashtu si di vetëm ti dhe ti qesh e gajasesh duke goditur me grusht shtyllën e autobusit sa burrat-ombrellë të inatosur gërryejnë fytin kurse gratë e moshuara gërhasin dhe shkëmbyjnë shikime kuptimplote, por ty thjesht aq të bën për ta, duke e lënë të qeshurën tënde vullkanike të shpoj një vrimë në çatinë e autobusit dhe më kujtohet se tashmë unë, që nga ai çast, në atë autobus me shi, në atë trotuar të ngrohtë me diell, e kuptova se të doja. Se unë dhe ti ishim përgjithmonë. Kjo është me të vërtetë e vetmja gjë që do të doja të ndryshoja.

Gjithçka tjetër ishte perfekte. Si u takuam herën e dytë, si qëndruam ulur në batanije duke folur e folur pambarimisht, derisa mollëzat tona morën ngjyrë kafe dhe pasditja u kthye në muzg. Si u ktheva në shtëpi në mbrëmje dhe nga qejfi aq i madh nuk më zuri gjumi derisa zbardhi dita. Si u takuam pastaj për herë të tretë në atë lokal, herën e katërt në banesën tënde, si nuk patëm kohë të thonim të gjitha ato që donim të thoshim para se të vinte koha për t'u përshëndetur. Si u puthëm në korridor. Si buzët tona ishin njësoj. Gjuhët. Kyçet. Ngjyrat tona. Afrimi ynë i bukur si më bëri të përqafoja gjithë botën dhe si u zmbraps djali me tatuazh në punën time kur desha ta përqafoja të nesërmen. Si më dukej se gjithçka përshtatej

në bisedat tona. Si bëheshin vetëm tituj bosh të gjithë filmat që shikonim në fillim , kujtimet e frymëmarrjeve të ngjitura, duarve të djersitura e të ngrohta dhe majat e gjuhëve tona që lëviznin dhëmbëve.

Si shumë prej atyre filmave që tani në retrospektivë ende na duken filma të preferuar. Si gjithçka tek ne ishte ne. Si për herë të parë në gjithë jetën time ndalova së shikuari të tjerët. Si zgjohesha natën dhe shtrihesha pranë teje në errësirë dhe të nuhasja klavikulat, të dëgjoja frymëmarrjen dhe mendoja se çarçafët tanë ishim ne , të gjitha këngët ishim ne, të gjitha fjalët ishim ne dhe gjithçka në botë ishte aq shumë ne sa ndonjëherë më përfshinte paniku dhe pyesja veten se kush isha.

Çfarë mjaftë?

Çdo fjalë që thash është e vërtetë. Pikërisht kështu ishte. Sikur të gjesh reflektimin tënd për herë të parë, personin që mahnitshëm përputhet me gjithçka që.

Si?

Epo, sepse.

Gjërat marrin fund.

Gjërat ndryshojnë.

Por unë.

Nuk pendothem për asgjë.

Të paktën jo në mënyrën që.

Ndoshta disa gjëra të vogla.

Për shembull, do të kujdesesha që të mos ngatërroja Sophie Calle-n e t'i thoja Frida Kahlo atëherë kur qëndronim shtrirë në batanije duke folur për artin. Dhe pendothem që ngatërrova “faire la cuisine” me “faire l'amour” kur doja t'u thoja të afërmve tuaj francezë se janë jashtëzakonisht të mirë në gatim. Ishte paksa e turpshme.

Tek ti?

Jo.

Absolutisht jo.

Ndoshta ca gjëra të vogla. Zgjedhjen e fjalëve dhe ca gjëra të tjera.

Përshembull kur ankoheshe gjithmonë se

fatura e celularit ishte e madhe, të kujtohet? Kjo më shqetësonte paksa. Asgjë tjetër.

Dhe se ishte mjaft e kujdesshme për të qenë gjithmonë në qendër të vëmendjes.

Dhe se ishte aq çmendurisht kurioze për gjithçka e për këdo dhe vetëm pyesje e pyesje, ndonëse ishin gjëra që nuk kishin të bënin me ty. Pastaj do ta ulja volumin e të qeshurës sate, sigurisht që ajo është e bukur dhe vullkanike por ndonjeherë, për dreq, vinte duke u ekzagjeruar sa njerëzit ndalonin në rrugë dhe bënin me gisht kur ishim në Greqi, e mban mend?

Por gjitha këto janë vetëm gjëra të vogla dhe kjo nuk ka të bëjë fare me arsyen e vërtetë pse u desh të...

Dua të them.

Ishte faji i të dyve.

Jo vetëm yti.

Ndonëse.

Po.

Ndonëse.

Ndonjëherë mendoj se...

Jo s'dua të fillojmë përsëri. Nëse do të isha i detyruar të ndryshoja diçka në fund?

Po.

Ndoshta ka disa gjëra të cilat do t' i përmirësoja.

Me fjalë të tjera.

Nuk do të ketë qenë aq argëtuese për ty që t'i lexoje ato mesazhe të cilat siç e kuptoj mund të... Keqinterpretohen.

Por e gjithë kjo ishte vetëm një shaka, e di. Ne kishim një zhargon që ishte paksa në stilin nëse marr një mesazh ku shkruan “i mungon shtratit tim” ose “a zgjohemi dhe flasim lakuriq”, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që unë isha...

Pra.

Po e kupton.

Edhe ti ishte paksa paranojake. Përveç kësaj, ti nuk kishe të drejtë të lexoje mesazhet e mia.

Epo.

Kjo ishte.

Pastaj ndodhën disa gjëra që absolutisht nuk ishin për fajin tim dhe të cilat është e vështirë për mua që t' i

Ndryshojë.

Kur tashmë kanë ndodhur.

Por kuptohet, unë do të doja që ti kurrë të mos

Tentoje.

Por ne të gjetëm me kohë dhe, sipas rrethanave, megjithatë ishte

Fat

Të kujtohet ndonjë gjë nga ajo natë?

Ishte mbrëmja më e bukur verore në botë me çiftet e mbrëmjes që ecnin dorë për dorë dhe më kujtohet se unë isha ulur në pjesën e pasme të ambulancës , sirenat dëgjoheshin dhe lagja ishte kthyer në blu, unë të mbajta dorën të ngërthyer duke menduar se ishte mot i gabuar përsëri, se për një natë si kjo duhet të ishte stuhi dhe breshër dhe jo perëndim dielli, jo aroma e jargovanëve. Pastaj mendova se ambulanca mund të kishte shkuar në dhomën e urgjencës në spitalin Södersjukhuset në vend të S:t Göran sepse ...

Si?

Jo!

Ulu!

Lëre mënjane shandanin! Qetësohu.

Pra jo kështu.

Unë thjesht mendova Atëherë.

Historia jonë do të kishte përfunduar bukur sepse.

Do të ishte si një rreth, e di. Dhe.

Është kjo një gjë kaq e çuditshme për ta thënë? Çfarë do të thuash me këtë? Nuk jam i ftohtë.

Është vetëm kjo që

Unë nuk di si të

Dhe do të kishte qenë kaq perfekte nëse do të ishim takuar në Södersjukhuset nën rrezet e diellit flakërues dhe t'i kishim thënë lamtumirën njëri-tjetrit në Södersjukhuset në motin e ligë me breshër e stuhi dhe është e qartë se pendothem për shumë gjëra, pendothem dhe dua të ndryshoj shumë më tepër gjëra nga sa mund t'i pranoj dhe uroj që një ditë thjeshtë të mund të më falësh, se asgjë asgjë nuk ka qenë si ne.

Duke ngrënë reçel manaferrash

Kur dëgjova se Zoti është i njëjtë si ekzistenca
Rashë në heshtje, por sytë i ktheva
Mbi krijesat e vogla të mosekzistencës.
Disa besojnë se peshku-persian përparon identikisht
Duke e bërë rolin e peshkaqenit zero. Por duke jetuar
Nuk nënkuptohet se është i lirë nga mosekzistenca.
Cicërimat vocërrake të zogthit që rritet me shpejtësi si era
Foleja me baltë e dallëndyshes, që qëndron nën trarë
Më bënë ta dashuroj zogun e strehës së mosekzistencës.
Taoistët me mjekrat e rritura, duke peshkuar gjithë ditën
e ditës
Me grepat në kallamin e drejtë, na dëftojnë se kanë
mësuar
Të mos presin gjëra madhore nga tërësia e
mosekzistencës.
Manaferrat kanë kaq shumë fytyra aq sa reçelosen
Diçka e përafërt midis trashjes së asgjësë. Gjithkush nga
ne
Dëshiron të mbllaçitë të trashin reçel të mosekzistencës.
Kur çdo strofë mbyllet me të njëjtën fjalë, i kënaqur jam,
Ndaj dhe miqtë e mi, më thotë: “Po qe se je krenar për këtë
fakt,
Mundet të bëhesh njëri nga sekretarët e mosekzistencës!”

Ciganët e Granadës

Zemra asnjëherë nuk ndalon së protestuari kundër shiut.
Të dashuruarit nuk ndalojnë të qahen kundrejt detit.
Mijra gjethe lisash vjeshtorë bien mbi varret e
përvetësuesve.
Sa herë këngëtari fillon t’i këndojë, thirrjeve të dhimbjes.
Në Maqedonitë e të cilave bijtë dhe bijat,
Vdiqën përgjatë natës kur Zoti sapo lindi.
Kopshti i Edenit derdh mbi ta ujin e Eufratit.
Plagët në trup i mbajnë njëtrajtësisht që nga koha e Noes.
Janë duart tona Babilonase që duartrokasin këtë natë.
Dua xhenazen e të korruptuarit të pasur të vidhiset!
Dua thithëlopën të kacavirret në muret e kishës ndajnatë!
Dua insektin ta thithë sheqerin e zeherosur teposhtë!
Në qoftëse je akoma në jetë, na thuaj këngëtar se si Krishti
E fali Judën, dhe si Juda i proposi të hollat e fituara
Në plevicën që drithërohet nën kurban bagëtish.
Po qe se këngëtari qahet për pleqtë e fisit, më mirë mos
flasë
Ai nuk e ka vendin në ison tonë. Bash stërgjyshërit tanë
Mbetën armiqtë më të mëdhenj, që vdekja përherë ka pas.

Nata kur Abrahami yjet thërriste

Të kujtohet nata kur Abrahami për të parën herë pa
Yjet? I thirri Saturnit : “Ti je prijësi im!”
Sa i lumtur ishte! Kur pa Yllin e Mëngjesit,
Thërriti : “ Ti je udhërrëfyesi im!” Sa shkatërrimtar ishte
Ndërsa i shihte yjet të fiksuar. O miq, ky yll është si ne :
Ne marim nga qielli ynë, yjet që rrëzohen mbi dhé.

Ne jemi shoqërues besnik të yjeve të arratisur.
Ne jemi kërkues, si bletët, e dashurojmë ndijimin.
Fluturimin kërkues arratisës nëpërmjet antenave tona.
Dhe askush nuk mund të na bind që shurdhëria
Bukuroshe nuk është. Shpirti ynë prej blete beson.
Që jemi të gatshëm të tresim aty jetët tona.

Duke ecur me këpucë të shurdhëta mbi ndjenja të lagura,
Ngjasojmë si të arratisur nga mbretëria e gjarprit.
Palëvizur nën ndjesi qepujke shohim sipër qiellin.
Zemra ime është patate e fjetur gjatë ditës dhe
Grua e shkrifët e braktisur ndajnatës. Më thoni ç’të bëj?
Përgjersa jam një burrë i rënë në dashuri me yjet.

Treni i varrosur

Tregomë mbi trenin që njerëzit thonë se u varros
Nga orteku ... ishte kohë dëbore? Ishte
Në Kolorado, dhe askush nuk e pa ndodhinë
As tymin e motorit kacavjerrur përpjetë
Shpërthim ciflash zjarri dhe zhurmë motori
Atje ishin të gjithë ata që patën lexuar diçka
Nga Thoreau, apo Henry Ward Beecher.
Dhe inxhinierët tymojnë, trutë të hedhin në erë.
Pyes veten kur ndodhi kjo? Ishte pas
Jetës studentore, apo ndër vitet kur ishim, ku?
Të gozhduar në cep e dëgjuam zhurmën që ndërsillte
Poshtë nesh treni lëvizte me shpejtësi të përbindshme.
Ishte e paqartë se ç’ndodhi më pas. Ti dhe unë



DUKE ECUR MBRAPSHT

Poezi nga Robert Bly

Përktheu Flurans Ilia

Jemi ende pasagjerë në atë tren. Duke pritur për dritën
E nisjes? Apo treni me t’ vërtet u varros nën dëborë?
Netëve të mia një tren fantazmë vjen dhe ikën...

Në botën e trazuar, ne ecim të gjithë mbrapsht
Çdo kurorëzim i patates të drejton drejt gropës.
Nata e pabesisë dhe dëshirave të zjarrta rrugëton.

Një javë në Firenze

Gomari na ka lënë si trashëgim shumë kultura!
Version pas versioni ka lindur! Zëri i Fra Lipit
Në rrezen e dritës që zbret përpos vuajtjes.
Midhjet mbijetojnë për kaq e kaq net në vetmi
Xhioto qëndron në atelie për kaq orë. Si ka mundësi?
Hajde, shpejt nëpër natë, qaj në të prajshmin ag.
Lumi Arno jeshil mban gjakun e vjetër të insekteve.
I revoltuari përpara pagëzimit ka thekur çdo njërin
Shumë përpara se Danteja udhëtoi në ngashërim.
Fytyra e Shën Mërisë ëmbëlsisht shkëlqen. Pse?
Era e elefantëve paleontolik shtresohet vetëm një herë
Në sytë vajzëror, përpara se t’i hyjnë territ të përjetësisë.
Murgeshat studiojnë dhe falen nëpër qela
Hapur nën qiellin e Toskanës. Por krahët engjëllorë
Nuk ka dhomë dhe qelë që t’i nxënë.
Robert, a e ke parë ndonjë vesh gomari ngjyrë bërsie?
Xhioto i ka pikturuar, kjo mjafton, nuk ke pse i shikon
Përtej dritares janë mbjellë fushat, për Hyjnorin të shohë.

Duke ecur mbrapsht

Miqtë, janë vetëm një gëzim dhe qindra brenga
Jetojmë poshtë Nënshtrimit të Kockave të Kalbura
Hapësirës së portës, jeton vëllai i vonuar i Uitmanit.
Megjithëse mendoj se ag ka mbi çati, mbetet natë
Këtu, midis plehrave dhe dosës, midis-midis
Pasqyrimet krahësh, shikime-minjsh, kukuvajkat.
Të rriturit janë akoma më të çuditshëm. Savana
Të parehatshme ndër mballosje luleshtrydhes,
Aristoteli është nervoz midis detit zemërgjerë.
Diçka në qumështin e nënës i lebetiti njësoj
Si Romakë edhe Helenë. Një gllënjëkë qumësht.
Krijoi pushtetin që nduket pas, po në qumësht.
Sumerianët shtypin elbin në baltën e lagur
Duke shtruar udhën e qytetërimeve të mëdha
Të bardhat-mure të qytetërimeve aromë-qumështi.

Lëvizje e brendshme së fundmi

Duke vdekur demi i përgjakur është në mal!
Por nga brenda mali, i paprekur është
nga gjaku,
Gjenden atje brirët, goditje në lëvozhgën e lisit,
Zjarr, barëra të shkukur.
Kur tymi tavanin e shpellës ledhaton,
Gjethet jeshile shpërthejnë me dashuri
Era e natës shndërrohet në ujë zezonë,
Malet ndryshojnë dhe bëhen detësi.
Vrunduj bore në veri të shtëpisë
Vrunduj bore shtrihen dhe ndalen papritur
gjashtë këmbë larg shtëpisë...
Mendova se shtegtojnë më larg.
Maturanti del nga gjimnazi dhe nuk lexon më libra;
bijtë kanë ndalur t’i telefonojnë familjes.
Nëna e ka hedhur poshtë pecin-rrotullues
dhe nuk gatuan më bukë.
Gruaja sheh burrin në natën e festës së hasdisur
dhe kupton se nuk e do më.
Energjia ka mbrujtur verën, dhe rënia e ministrit
tempullin ka zbrujtur.
Nuk ka për t’u afruar, jo
një pjesë e brendshme luan nga vendi,
duart prekin asgjënë, dhe janë të sigurt.
Babai i brengosur për të birin, nuk e lëshon
dhomën ku qefini i shtrirë është përdhe
I kthen shpinën së shoqes në shtrat,
ndërsa ajo e vetme fle.
Dhe deti ngrihet, dhe zbret çdo natë, hëna e vetme
shtegton ndër vise të pashkelura.
Maja e këpucës rrotullohet
në pluhur...
Dhe njeriu i veshur me të zeza kthehet,
tatëpjetën merr përposhtë.
Asnjë nuk e di se si erdhi, u kthye, si?
Nuk u ngjit në pjerrësi.

Psikanaliza moderne fillon me punën e jashtëzakonshme të Sigmund Frojdit, i cili konsiderohet edhe si nismëtar i aplikimit të metodës psikanalitike nëpër tekstet letrare.

Siç thekson edhe studiuesi i mirënjohur Tomas Shmitz, nga psikanaliza frojdiane del një ndër hipotezat më të njohura që ndërlidhet me interpretimin e një teksti të lashtë, sigurisht, teorinë e tij mbi kompleksin e Edipit.

Sipas Frojdit, njerëzit fillojnë jetën pa asnjë ide për subjektivitetin e tyre; për një fëmijë nuk ka kufij të qartë midis “unë” dhe “jo unë”. Në veçanti, në këtë fazë të hershme të jetës së tij ai jeton në një marrëdhënie simbiotike me nënën. Derisa të bëhet i vetëdijshëm që ai dhe nëna janë dy njerëz të ndryshëm, ai e drejton dëshirën e tij drejt saj. Por vendi i të dashurit të nënës është zënë tashmë, nga babai i tij, i cili kërcënon fëmijën me kastrimin (imagjinari). Prandaj, fëmija duhet të braktisë dëshirën e tij erotike për nënën dhe ta shtypë këtë impuls.¹

Të tjerat dhe këto konstatime nga shumë studiues të kohës u konsideruan kontroverse dhe nuk gëzuan aplikim të gjerë, por më vonë psikanaliza e Frojdit ndikoi ndjeshëm edhe në studimet letrare.

“Hoteli i bardhë” i D. M. Thomas, publikuar më 1981, është një vepër letrare komplekse me ndërtim shumëstresor që shtrihet para lexuesit përmes një qasjeje psikoanalitike ngjarje historike, luhate psikike, dëshirat seksuale të njeriut, traumat e kështu me radhë.

Romani është i ndarë në shtatë pjesë të ndryshme të emërtuara tematikisht. Si fillim kemi “Prologun”, që ka karakter epistolar, pastaj kalohet te “Don Zhuani”, “Frau Ana G.”, “Qendra e kurimit”, “Vagoni i fjetjes” dhe romani mbyllet me pjesën “Kampi”.

Siç theksuam më lart romani nis me “Prologun” në të cilin kemi të bëjmë me shkëmbime letrash mes Sandor Ferencit, Hans Sachsit dhe Sigmund Frojdit - tre psikanalistëve të mirënjohur në botën reale. Letrat në theks të veçantë kanë “Hotelin e bardhë”, gjegjësisht historinë e pacientes së Frojdit, Elizabeta Erdmanin. “Prologu” mbyllet me letrën e Frojdit drejtuar Sekretarit të Komitetit të 100-vjetorit të Gëtes dhe Këshillit të qytetit të Frankfurtit, ku ndër të tjerash, kërkon që të botohen krijimet e pacientes në fjalë, me miratimin e saj, dhe një pjesë e punës së tij të inkuadruar brenda:

Pacientja ime e dikurshme nuk ka ndonjë kundërshtim që ju të botoni krijimet e saj së bashku me punimin që kam futur brenda. Shpresoj që të mos alarmohesh nga shprehjet e pahijshme që janë përhapur gjatë gjithë vargjeve të mjera si edhe nga ato pjesë që janë më pak fyese, por ende pornografike, në shtjellën e fantazisë së saj. Duhet të kihet parasysh që (1) autorja vuante nga një histori e rëndë seksuale dhe (2) krijimet i përkasin fushës së shkencës ku parimi nihil humanum është pranuar edhe zbatuar universalisht dhe jo më pak nga poeti që i këshillon lexuesit të mos frikësohen e të mos largohen nga “ajo që është e panjohur apo e shpërfillur nga njerëzia, pasi gjatë natës ajo depërton përmes labirintit të zemrës.”²

Prandaj, prej kësaj letrë e tutje, romani paraqet historinë e Liza Erdmanit, hebreje ukrainase, që trajtohet psikikisht nga Frojdi. Nga seancat e shumta klinike lexuesi njoftohet me fantazinë, ëndrrat, kujtimet e pacientes. Përmes një loje narrative (modeluese) dhe diskursive gjurmohet jeta reale dhe imagjinare e Lizës.

Romani “Hoteli i bardhë” i D. M. Thomas

EKZAMINIMI PSIKANALITIK I INDIVIDIT

nga Fatlum Mehulli

Një ndër karakteristikat kryesore që na dalin në roman, sa i përket personazhit të Lizës, është shqyrtimi i libidos, që në psikanalitikë ka të bëjë me epshin seksual, ose me instinktin e jetës. Lexis-i i Lizës është i mbushur me shprehje që shpërfaqin skena erotike, me anë të së cilave forcohet ngjizja mes dëshirës së zjarrtë për marrëdhënie seksuale dhe vdekjes.

Meqë romani gërsheton personazhe reale dhe fiksioanle, atëherë kjo kushtëzon analizën përmes një qasjeje kontekstuale/kohore. Pra, ndonëse jo linear, modelimi temporal përfshin distancën mes vitit 1909 e deri më 1939-1945 - periudhë që brenda vetes ka Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, dhe një sërë ngjarjesh të tjera të rënduara socio-politike dhe socio-ekonomike.

Këtë fakt e theksuam për shkak se një tjetër veçori e romanit është edhe trajtimi i traumës, e cila si një efekt i fituar ndikon në dekompozimin e sistemit psikologjik të individit/njeriut. Pikërisht një efekt të tillë përjeton Liza. Gjendja e rënduar shoqërore, luftërat e shpeshta, Holokausti, mbijetesa etj., janë eksperiencat reale popullore që D. M. Thomas arrin t'i shpërfaq si përjetime karakterologjike. Me fjalë të tjera në mënyrë të përthyer gërshetohet fakti/realiteti dhe fiksioni. Madje, duke u ndalur në traumat e përjetuara nga individi (Liza), Thomas synon që të analizojë pasojat e ngjarjeve në shoqëri si një tërësi.

Shkrimet me nuanca pornografike të pacientes Liza, që Frojdi dëshiron t'i botojë, janë “Don Zhuani” dhe “Ditari i Gastainit”.

I pari ndërtohet në frymën e poemës me vargje narrative. Rrëfëhet para profesorit (Frojdit) ngjarja e një gruaje (Lizës) që



takon një oficer të ri në tren. Ata menjëherë rrëshqasin në çaste erotike përgjatë udhëtimit për te hoteli i bardhë, i cili në roman na shfaqet si një vend onirik përtej kufijve real. Veçantia e pjesës, ndër tjerash, qëndron në identitetin e oficerit riosh. Ai paraqitet si djali i Frojdit, me emrin Martin.

Te “Don Zhuani”, dhe jo vetëm, hapësira dhe koha janë krejt universale që shfaqen përmes impulseve të brendshme, duke i dhënë diskursit një karakter onirik të përzier mes sekuencave empirike përpunuar në laboratorin imagjinari të individit.

Gjersa këngëtarja vagneriane dhe djali i Frojdit kryejnë marrëdhënie seksuale, më vonë nga larg vështrojnë që në hotelin e bardhë ndodhin fatkeqësi të mëdha që sjellin vdekje të shumta.

Pra, nga kjo që thamë deri tani hetohet se si simultanisht/paralelisht zhvillohen dy kategori: seksi dhe vdekja (Erosi dhe Tanatosi); njëra si dëshirë e ngulitur

në instinktin njerëzor, dhe e dyta si një determinim natyror.

Nga ajo çka dëgjon Frojdi te “Don Zhuani” mbetet i shtangur, pastaj kërkon nga Liza ta analizojë këtë pjesë poetike. Dhe nga kjo kalohet te pjesa tjetër, pra te “Ditari i Gastainit” që dallon krejtësisht nga i pari strukturalisht, por jo aq përmbajtësisht. Themi kështu sepse “Ditari...” mund të merret si një variant në prozë i “Don Zhuanit”. Tashmë rrëfëhet nga një pozicion tjetër narrativ, ka zgjerim ngjarjesh e kështu me radhë, duke u përgjigjur veçorive prozaikë. Por, vlen të ritheksohet që te “Ditari i Gastainit” kemi të bëjmë me historinë e njëjtë, që ndërlidhet me takimin e Lizës me djalin e Frojdit, bisedat e tyre për të ardhmen, çastet erotike, arritja në hotelin e bardhë e kështu me radhë.

Pjesa tjetër e romanit vjen pas dy shkrimeve të Lizës, dhe tutje kemi të bëjmë me interpretimin që Frojdi i bën të kaluarës së saj në përputhje me rastet e mëhershme të trajtuara. “Frau Ana G.” nis me rrëfimin e personazhit-karakter, Frojdit, që përshkruan takimin e parë me pacienten Liza:

Në vjeshtën e 1919-ës një mjek që njihja më kërkoi të vizitoja një grua të re që kishte katër vjet që vuante nga një dhimbje e madhe në sisën e majtë dhe në zonën e legenit, si edhe nga një gjendje kronike në sistemin e frymëmarrjes. Kur bëri kërkesën, ai shtoi së ndoshta kishin të bënin me një gjendje hysterike, megjithëse kishte disa shenja të kundërta që e kishin detyruar ta kontrollonte me shumë kujdes me qëllim që të përjashtonte mundësinë e ndonjë organi të sëmurë. Gruaja e re ishte e martuar, por jetonte në shtëpinë e tezes larg nga i shoqi. Ajo kishte pasur një karrierë muzikore shumë premtuese, por të ndërprerë nga sëmundja. (f.107.)

Nën emrin e fshehur Frau Ana G. (Zonja Ana G.), Frojdi rrëfen biografemat jetësore të Lizës, duke filluar nga mosha e hershme, vështirësitë familjare e kështu me radhë. E lindur në Odesa të Ukrainës, nga një baba hebre dhe nënë katolike, ajo përjeton gjëra tejet të rënda. Fillimisht i vdes nëna në një zjarr të madh brenda hotelit, pastaj raportet e ftohta me babanë, martesat e dështuar e më vonë sëmundja, bëjnë që Frau Ana G. të ketë çrregullime mendore; Ajo gjithnjë sheh përmblytje, zjarr, vdekje, që reflektohen edhe në rrëfimet e saj nëpër seancat klinike.

Siç tregon narratori-karakter, gjegjësisht Frojdi, Frau Ana G. (Liza) ishte 17-vjeç kur braktis shtëpinë në Odesa për të vijuar shkollimin për balet në Shën Petersburg, ku lidhet dhe mbetet shtatzënë me Aleksin. Por, kjo lidhje konsiston të jetë e dështuar, me ç'rast Liza aborton fëmijun dhe pas një kohe të shkurtër shpërngulet në Vjenë.


Qëndrimi i Lizës në Vjenë mund të konsiderohet si periudha më e suksesshme e karrierës së saj, sepse arrin të bëhet këngëtare e famshme operistike, por gjithashtu martohet me një avokat po ashtu të suksesshëm. Vjena bëhet vend shumë i përshtatshëm për Anën, për shkak se aty jetonte edhe motra e nënës së saj, Tezja Magda. Ajo çka e mundonte më së shumti Lizën, ishte vdekja e dyshimtë e burrit të tezes. Siç thekson Frojdi, ajo ngulte këmbë që burri i tezes nuk kishte vdekur nga ndonjë krizë zemre, por në të njëjtin zjarr në hotel së bashku me nënën e saj. Andaj, Frojdi në fund të kësaj pjese, pra “Frau Ana G.”, thekson:

Ka ardhur koha që të përmbledhim çfarë dimë për këtë paciente fatkeqe. Rrethanat nga vitet e hershme kishin bërë që ajo të ngarkohej me një barrë të rëndë faji. Çdo vajzë e re, kur arrin fazën e Edipit, fillon të ushqejë impulse

1 Thomas Schmitz: *Teoria moderne letrare dhe tekstet antike*, Sh. b. Albas, Tiranë, 2019, f. 252.

2 D. M. Thomas: *Hoteli i bardhë*, OMBRA GVG, Tiranë, 2013, f. 23. (Përkth. Pirro Dollani.)





shkatërruese ndaj nënës së saj. Ana nuk bënte përjashtim. Ajo e dëshironte të ëmën të “vdekur” dhe, sikur të kishte fërkuar llambën magjike, nëna e saj vdiq. Në sajë të gjarprit-penisit të burrit të tezes - në parajsën e saj, fusha ishte e lirë për Anën, dhe ajo mund të bënte atë që dëshiron çdo vajzë e vogël, të lindte një fëmijë me të atin. (f. 158.)

Frojdi konstaton që ndër simptomat kryesore të sëmundjes së Anës janë stërmundimet përsiatëse sa i përket çështjes së nënës dhe vdekjes së saj, duke përmendur gjithnjë hotelin, zjarrin, varrimin, burrin e tezes e kështu me radhë.

Për të mos rrëshqitur në përshkrime përmbajtjesore, po përmendim shkurtimisht që pas “Frau Ana G.”, te “Qendra e Kurimit” Liza i kthehet karrierës si këngëtare në Milano të Italisë. Bën miq të ri si Viktorin, Verën, mentorin Kedrova. Por, kur këta dy të fundit vdesin, Liza prapë përjeton dhimbje të madhe. Më vonë ajo merr një letër nga Viktori i cili kërkon të martohet me të. Ashtu ndodhë. Liza martohet me bashkëshortin e Verës, Viktorin, dhe së bashku me djalin e tyre të parë Koljën, jetojnë në Kiev të Ukrainës. Raportet e njerkës Liza me Koljën ishin relativisht të mira, dhe gjithçka shkonte në rrugën e duhur.

Por, te pjesa e parafundit, gjegjësisht te “Vagoni i fjetjes” kemi të bëjmë me kthesën tragjike të Lizës dhe familjes së saj te re. Ngjarjet vendosen dhjetë vjet më vonë - atëherë kur Liza përjeton një krizë financiare, Viktori zhduket si pasojë e qeverisjes sovjetike. Ajo së bashku me Koljën tentojnë mbijetesën nga vrasjet e shumta të hebrenjve, por nuk shpëtojnë dot, sepse ata së bashku me mijëra të tjerë ekzekutohen në Babi Yar nga forcat SS.

Pjesa e fundit “Kampi” ka një diskursurrealist që ndërlidhet me botën e përtëjme. Ambienti konsiston të jetë Hoteli

i bardhë, sikur një kamp për të pastrehët që kërkonin Tokën e Premtuar. Aty Liza së bashku me Koljën, takojnë nënën e saj, pastaj Aleksin (ose A-në) gjithashtu Verën.

Në romanin “Hoteli i bardhë” të D. M. Thomas, konsiderojmë që psikanaliza luan një rol kyç, sidomos përmes Frojdit si personazh me funksion të veçantë. Gjithashtu përfshirja e koncepteve dhe ideve frojdiane, si kompleksi i Edipit e interpretimi i ëndrrave, na thellojnë në botën e brendshme të Lizës, e cila nëpërmjet terapisë gjurmon kompleksitetin e psikikës humane dhe na bën me dije rolin e psikanalizës për shërim emocional.

Për fund, ndalemi shkurtimisht edhe te figura e Sigmund Frojdit, që në roman na del si një personazh fiksional i ndërtuar në fakte reale, roli i së cilit është shumështrësor. Ai është kyç për zbulimin e thellësive psikike të Lizës duke e ndihmuar atë të përballët me të kaluarën e saj të rëndë. Përveç si terapist i Lizës, Frojdi në roman përfaqëson edhe psikanalizën si fushë e veçantë dhe teoritë e saj. Dy prej teorive kryesore, siç janë kompleksi i Edipit dhe interpretimi i ëndrrave janë të ndërthurura në tekstin romanesh - i pari, siç kemi theksuar sipër, ndërlidhet me raportin e saj me nënën/babanë, pastaj i dyti ndër tjerash lidhet me shkrimet erotike të Lizës e kështu me radhë.

Gjithashtu, jo më kot, D. M. Thomas ngjarjet e romanit i vendos në fillimet e shek. XX, atëherë kur Frojdi zbatonte në mënyrë rapide fushën e psikanalizës, përmes së cilës kërkohej kuptimi i mendjes njerëzore dhe gjurmimi i të pavetëdijshmes. Andaj, romani ka edhe veçori historike.

Literatura
D. M. Thomas: *Hoteli i bardhë*, OMBRA GVG, Tiranë, 2013;
Thomas Schmitz: *Teoria moderne letrare dhe tekstet antike*, Sh. b. Albas, Tiranë, 2019.

ILIRIAN ZHUPA, KY MAGELAN I SHPIRTIT NJERËZOR

Nga Luan Rama

Si në të gjithë krijimtarinë e vet Spoetike, edhe me poemën “Qielli im” të botuar sëfundmi, Ilirian Zhupa na sjell tre dëshmi fundamentale, e po aq ekzistenciale për poezinë shqipe.

E para është vazhdimësia kualitative e një standardi poetik të prekur më parë prej De Radës, Migjenit, Dritëroit, Kadaresë dhe Fatos Arapit, dhe e sjellë më tëhu nga Xhavadir Spahiu, Ndoc Gjetja e Bardhyl Londo.

Ilirian Zhupa jo vetëm i del për zot asaj si një misionar i vëmendshëm e po aq largpamës, por edhe e ripërmason atë me shumë sqimë, me elegancë e përkujdesje prej mjeshtri, duke e vendosur çdo fjalë në mozaikun e krijimtarisë së vet, me dashuri e me respekt të veçantë, duke qëmtuar e na ofruar me shumë klas e po aq, me thjeshtësi, natyrshëm e me spontaneitet për t’u patur zili, një gjuhë poetike e figuracion modern, që do t’i bënte nder çdo letërsie.

E dyta është perspektiva.

Ilirian Zhupa na jep mundësinë që përmes krijimtarisë së tij, të shohim horizontin ku mund të mbërrijë poezia shqipe me një punëtor të palodhur të fjalës si ai, i denjë e i vetëdijshëm për barrën që ka marrë përsipër, sepse ka ditur të hyjë në ashtin e saj e të na mundësojë ta ndjejmë qiellin e tij edhe tonin, e duke ecur bashkë me të, t’ja prekim shpirtin e të shpirtëzohemi në të.

Dhe e treta, është përmasa universale.

Poezia e Ilirian Zhupës, duke qënë jo vetëm mishërimi më i mirë i kohezionit poetik kombëtar në gradën më të lartë të cilësisë së vet, bëhet njëherësh edhe pika lidhëse e saj me universin poetik. Aty, ajo, pra poezia shqipe, rri natyrshën gjithë dinjitet e hijeshi, në sintoni të plotë me frekuencën e një universi ku jo çdo poezi mund të jetë pjesë, edhe



sepse Ilirian Zhupa, me talentin e vet aq përveçues dhe imponues, ka ditur të bëhet bardi i një poezie, e cila jo vetëm na ka munguar prej kohësh, por edhe na bën të ndjehemi krenarë e të besojmë në ardhmërinë e saj. Me një poet si ai, ajo është në dorë të sigurtë!

Poezia e I. Zhupës lindi si poezi metafizike, brendashpirtërore, dhe mbetet e tillë deri më sot. Ai është poeti që udhëton brenda vetes, për të zbuluar botën e madhe si një Magelan i shpirtit njerëzor.

Poeti e ka përsosur qenien poetike brenda vetes. Parimi i tij krijues është ai i skulptorit: hiq të tepërtën.

Por, në poezinë e Ilirian Zhupës shfaqet me shumë ngjyra edhe një frymë metropolitane, në stilin e poezisë moderne frënge të gjysmës së dytë të shekullit XX, gjithaq dhe në stilin e poetëve të mëdhenj të gjuhës greke: Ritsos, Kavafis, Elitis, Seferis. Ndaj mund të them pa mëdyshje, Ilirian Zhupa nuk është më një zë poetik. Ai është kontribues me një rol të veçantë, të spikatur dhe ndikues në historinë e poezisë shqiptare. Madje ai është sot kontribues i radhës së parë, me misionin për ta përsosur e pasuruar atë më tej.



RREZIQET E TYMOSJES NË SHTRAT



MARIANA ENRIQUEZ

OnufriTregime

“Bota e bukur dhe e tmerrshme e Mariana Enriquez-it, siç shfaqet në librin *Rreziqet e tymosjes në shtrat*, me adoleshentët e trazuar, fantazmat, demonët e kalbur, të pastrehët e trishtuar e të tërbuar të Argjentinës moderne, është zbulimi më entuziazmues që kam bërë prej kohësh në letërsi”.

—Kazuo Ishiguro, *The Guardian*

Përktheu nga origjinali Erion Karabolli